
edicion i botuar / viti i parë / nr: 3

botues: ALBISLAM

kryeredaktor: Ramadan Ramadani

redaksia: Bekir Halimi, Talha Kurtishi, Alajdin Idriz

redaktor teknik: Azem Zaimi

www.albislam.com

albislam@albislam.com

str: 386 no: 11 lokal: 44

1000 Shkup

fax: +389 2 3290 408

Terrorizmi dhe siguria nacionale-nënçmim i drejtave të njeriut

Gjatë vitit 2002 aktiviteti kryesor i shumë shteteve të botës rotullohej rreth luftës kundër "terrorizmit" dhe sigurimit të "sigurisë nacionale".

Si rezultat i drejtpërdrejt ishte shtimi i sulmeve në më shumë se 151 shtete dhe rajone kundër të drejtave të njeriut dhe atyre që i mbrojnë të njejtat.

Në një shoqëri pas 11 shtatorit të vitit 2001 ku "përdorimi i forcës paraqitet si mjet për ta bërë botën më të sigurt", raportet e organizatës "amnesti internacional" për vitin 2003 zbulojnë se përgjegjësit politik i japin të drejtë vetvetes që të marrin masa sigurie katotike disa herë duke mos përfill konventat ndërkombëtare. Psh, që nga ndërhyrja amerikane në Afganistan edhe më tej mbeten të burgosur 600 të burgosur pa akuzë ose gjykim në bazën detare kubaneze të Guatanamos dhe refuzon Washingtoni që të "pranojë për ta statusin e të burgosurve të luftës, sipas konventës së Gjenevës ose tu jep të drejta tjera, për të cilat flasin kriteret ndërkombëtare që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut".

Vetëm në shtetet e bashkuara të Amerikës ka "më shumë se 1200 të huaj, shumica me origjinë arabe dhe jugoaziatike që janë marur në pyetje informative të hapura në lidhje me sulmet e 11 shtatorit".

Ky ambient që përputhet me tejkalmimet dhe diskriminimin e llojllojshëm e forcon acarimin e marëdhënieve mes popujve, saqë disa organizata anësore paraqiten si të

dyshimta ose ngërthejnë terrorist të mundshëm sipas opinionit publik.

Në Indi, në krahinën Goxharat muslimanët u flijuan në masakra që u organizuan sipas "amnesti internacional" nga organizata nacionaliste në bashkëpunim me pushtetin. Tejkalime të cilat i sulmon edhe Irin Kahin, sekretare gjenerale e organizatës duke thënë:

"Nuk i takon qeverive që t'i përgjigjen terrorizmit me terrorizëm".

Nga ndodhitë e Njujorkut kanë përfituar shumë shtete të ndryshme, siç janë Uzbekistani, Egjipti, Malezia, për të legjitimuar politikën represioniste dhe për të zgjeruar domethënien e terrorizmit. Psh, Rusia në qershor të vitit 2002 nxjeri ligjin për "ekstremizmin politik", që i lejon çdo institucioni gjykatës që "të mbyll ose pezullon aktivitetin e çdo organizate ose sindikate ose grupit fetar që dyshohet se mbështet ekstremizmin".

Që nga vjeshta e vitit 2001 është formuar një komision kundër terrorizmit në Kombet e Bashkuara, kurse një vit pas themelimit kanë marur më shumë se 207 raporte nga më shumë se 163 shtete. Kurse gjendja e brendshme e këtyre shteteve nuk është përmirësuar edhe pse janë caktuar buxhete të mëdha financiare, që u janë ofruar aparateve të ndryshme të sigurimit. Siç është rasti i Afganistanit, ku institucionet janë akoma të dobëta, kurse pakicat kanë nevojë për mbrojtje ose në lindjen e mesme ku "numri i viktimave nga palestinezët dhe izraelitet

është shtuar në vitin 2002 në mënyrë të pakrahasueshme me një vit më herët”.

Gjithashtu edhe raporti i “mbikqyrësit të mbrojtësve të të drejtave të njeriut”, program i unionit ndërkombëtar i kontakteve të të drejtave të njeriut, një organizatë ndërkombëtare për mbrojtje nga tortura, nuk regjistron rezultate të ndershme. (1)

Ata mes tjerash thonë:

“Formimi i ndonjë organizate ose sindikate... ose vërtetimi i çdo forme të thyerjes së të drejtave të njeriut paraqet rrezik në më shumë se 80 shtete të botës”.

Ka shumë vështirësi në realizimin e verifikimeve për shkak të llojloj presioneve që bëhen (duke filluar nga sulmet në zyra e deri te shkatërrimi i aparaturës) kundër mbrojtësve të të drejtave të njeriut, të cilët janë shndëruar në “kriminel të rinjë” për shumë shtete.

Edhe pse dy raporte konfirmojnë një përparim gjatë këtij viti, siç është rasti me pajtimin rreth përkufizimit të mobilizimit ushtarak të fëmijëve dhe përvetësimi i protokoleve që lejojnë ligjin ndërkombëtar për vizita të organizuara në burgjet e ndryshme.

Kjo organizatë ndalet edhe te “ngadhnjimi historik” që personifikohet në hyrjen e gjykatës ndërkombëtare në praktik që të gjykojë të akuzuarit për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Kjo është ngadhnjim të cilin e ka zbehur refuzimi i Sh.B.A-ve bashkëpunimin me këtë gjykatë në kornizat e hulumtimeve ose akuzave penale që mund ta kaplojnë qytetarin amerikan.

(1) Observatoire pour la protection des défenseurs des droits de l'homme, FIDH et OMCT, Les défenseurs des droits de l'homme en première ligne, rapport annuel 2002, Editions de l'Aube, La Tour d'Aigues, 2003.

Ariane IOANNIDES

Marrë nga: “Le Mond Diplomatic” - versioni arabisht.

Përktheu: Bekir Halimi

3.10.2003

Një qasje tjetër për "Izraelin"

Sot duke e vozitur makinën u ndala rastësisht pas një mini furgoni në të cilin ishte ngjitur një afishë me flamurin e Izraelit nën të cilin ishte shkruar një citat i Biblës: Dhe unë do të bekoj të gjithë ata që do të të bekojnë... Zanafilla 12:3.

Pasi që lexova këtë tekst fillova të mendoj për listën e shkaqeve se pse duhet që të bekoj dhe falënderoj Izraelin, të vetmin aleat tainin në Lindjen e Mesme. Për shkak të asaj që e kanë bërë mendoj se shumica e Amerikaneve nuk e dijnë se çfarë mik e kemi Izraelin.

O Izrael, ty të bekojmë për \$ 4,000,000,000.00 që për çdo vit, brenda katërdhjetë viteve të fundit, i grabit nga unë dhe bashkatdhetarëve të mi Amerikan.

O Izrael, ty të bekojmë për shfrytëzimin dhe vjedhjen e armëve më të sofistikuar që i prodhon Amerika pa paguar asgjë për patentuesit e tyre.

O Izrael, ty të bekojmë për marrjen e teknologjisë ushtarake të sofistikuar dhe shitjen e saj armiqve tanë Rus dhe Kinez që të na rrezikojnë më tutje.

O Izrael, ty të bekojmë për shfrytëzimin e armëve tona të sofistikuar kundër anive tona si për shembull sulmi mbi USS Liberty (1967), për parandalimin e përhapjes së lajmeve për krimet e luftës që i keni bërë kundër ushtarëve egjiptjan në shkretëtirën e Sinai-it gjatë luftës që zgjati 6 ditë.

O Izrael, ty të bekojmë për vrasjen e 34 ushtarëve amerikan dhe lëndimin e 170 ushtarëve që ishin mbi aninë USS Liberty.

O Izrael, ty të bekojmë për mitosjen (korruptimin) e qeverisë Amerikane dhe parandalimin e drejtësisë që duhej të del në shesh për hir të familjeve që humbën të afërmit e tyre në këtë sulm.

O Izrael, ty të bekojmë për dërgimin e spiunave tuaj në Egjipt që të shkatërrojnë ndërtesa amerikane me qëllim të akuzimit të arabëve në rastin e njohur si "Lavon Affair".

O Izrael, ty të bekojmë për dërgimin e spiunave tuaj në Libi gjatë administratës së Reagan-it që të emitojnë mesazhe në gjuhën arabe që dukeshin si planifikime të celulave terroriste. Këto emitime inicuan sulmet e Amerikës mbi Gaddafin.

O Izrael, ty të bekojmë për fshehjen e informatave për sulmet e planifikuara mbi kazermën ku ishin të stacionuar marinarët amerikan (US Marines) në Liban gjë për të cilën keni qenë të informuar por me qëllim nuk na keni njoftuar sepse ky konflikt (mes Sh.B.A-së dhe Arabët) u shërbente interesave tuaja.

O Izrael, ty të bekojmë për angazhimin e Jonathan Pollard-it ushtar amerikan i cili spiononte në favor të Izraelit. Kështu arritët që të përdorni sekretet e Sigurimit Shtetëror Amerikan për qëllimet e juaja parazite.

O Izrael, ty të bekojmë për shantazhimin e kryetarit Clinton nëpërmjet sayanimit (vullnetar në shërbim të cionizmit) Monica Levinsky me qëllim që të parandaloni realizimin e pro-

gramit të paqës mes juve dhe popullit palestinez, popull të cilin e keni terrorizuar dhe vrasë 50 vitet e fundit.

O Izrael, ty të bekojmë për thyerjen e çdo marrëveshje që keni nënshkruar me fqinjët arab, për grabitjen e tokës së tyre, për eksodin e popullit palestinez, për vrasjen e tyre dhe sjellen shtazore ndaj tyre.

O Izrael, ty të bekojmë për nxitjen e luftës së parë të Gjirit nëpërmes agjunkturës së juaj në administratën e Bush sr. e cila shkaktoi vdekjen e shumë ushtarëve amerikan dhe Sindromin e Gjirit nga i cili vuajnë shumë veteranë të luftës shkaku i të cilit ka qenë ekspozimi i tyre ndikimit të armëve biokimike që ju i testuat në atë luftë.

O Izrael, ty të bekojmë për rolin e juaj në sulmet e 11 shtatorit dhe për shantazhimin dhe mitosjen e qeverisë amerikane që të deporton në Izrael 100 punonjës të shërbimit sekret çifut (që "punonin" në Sh.B.A.) që ishin të arrestuar pas sulmeve.

O Izrael, ty të bekojmë për fshehjen e informatave për pjesëmarrjen e juaj në këto sulme që shkaktuan kërkimin e përgjegjeve në anën e kundërt.

O Izrael, ty të bekojmë për shfrytëzimin e agjunkturës tënde për vjedhjen e virusit të anthrax-it nga laboratorët e ushtrisë amerikane që më vonë e distribuat përmes sistemit postal duke shkaktuar vdekjen e disa qytetarëve të pafajshëm. E gjithë kjo me qëllim që të akuzohen arabët.

O Izrael, ty të bekojmë për përdorimin e agjunkturës tënde gjegjësisht Rumsfeld-in, Wolfowitz-in, Perle-in dhe Abrams-in që të fillojn luftën e re në Lindjen e Mesme me qëllim të shkatërrimit të armiqve që i krijuat gjatë 50 viteve të fundit.

O Izrael, ty të bekojmë për përdorimin e agjunkturës tënde në mediumet të cilat me raportet e tyre na gënjejnë për lutën

e drejtë që e bëjmë dhe duke i fshehur shkaqet e vërteta të luftës.

O Izrael, ty të bekojmë për përdorimin e agjenturës tënde në bashkësinë krishtere ungjillore (Christian Evangelical community) gjegjësisht Falëell-in, Graham-in, Swaggert-in dhe të tjerët që ju lavdërojnë si populli i zgjedhur prej Zotit, që e lëjnë në terr popullin amerikan duke mos ua treguar realitetin faktik mbi juve.

O Izrael, ty të bekojmë për përdorimin e idio-tëve si Limbaugh, Liddy, Hannity, Beck, O'Reilly dhe Savage si ballë dhe gënjeshtarë të paguar që mëturje nxisin devijimin e popullit amerikan.

O Izrael, ty të bekojmë për përdorimin e Amerikës si qen për sulm dhe popullin amerikan si ushtarë që shërbejnë interesat e juaj në luftërat që do t'i shkaktoni në ardhmëri.

O Izrael, ty të bekojmë për përdorimin e ndikimit t'uaj në media për fshehjen e fakteve dhe statistikave reale për viktimat e luftës.

O Izrael, ty të bekojmë për nxitjen e urrejtjes e botës arabe kundër neve dhe për shkaktimin e armiqësisë mes neve dhe popujt që i kemi pasur miq shekuj të tërë.

Në fund të bekojmë ty për përdorim e ndikimit që e keni në media dhe në qarqet akademike që të vërshoni trurin tonë me pornografi, gënjeshtër, duke na nxitur të urrejmë historinë tonë, religjionin dhe kulturën tonë. Duke shkaktuar ndarje në baza racore dhe gjinore, duke e shndërruar një popull, që dikur ishte madhështorë, në kufomë.

O Izrael miku ynë, ty të bekojmë.

Mark Glenn

Përktheu: Talha Kurtishi

10.10.2003

Veprimtaria humanitare dhe agresioni

Prej efekteve të ndodhive të 11 shtatorit dhe asaj që ka pasuar, është edhe fushata e egër e perëndimit kundër veprimtarisë humanitare. Në këtë fushat morën pjesë edhe shumica e vendimmarrësve në vendet muslimane, me ose pa vullnet.

Aktivistët e organizatave humanitare e gjetën vehten para një gjendje të re, e cila ju pengon në shumë aktivitete dhe veprime, u ndërlikon atyre shumë projekte dhe aspirata.

Duke qëndruar para kësaj fushate zullum-qare, kemi nevojë për dy gjëra:

Një: Besimi i madh në All-llahun, se Ai do ta ndihmojë fenë e Tij dhe do ta lartësojë Fjalën e Tij. Bindja se kjo thirrje është shumë më e madhe se sa të kenë mundësi ta ndalin një grusht njerëzish të humbur.

“Ai (All-llahu) është që e dërgoi të dërguarin e Tij me udhëzim të drejtë e fe të vërtetë, e për ta bërë që të dominojë mbi të gjitha fetë, edhe pse e urrejtën idhujtarët”. (Et-Teube: 33).

Nëse e pengon ose e godet diçka aktivitetin humanitar, duhet ditur se këtu bëhet fjalë për një kohë të caktuar. Nëse dëmtohet ndonjë institucion ose rrënohet një tjetër, duhet ditur se në ummetin islam ka shumë mirësi, kurse aktiviteti islam nuk është peng i një grupi, pale ose individi.

Gjithashtu edhe veprimtarët në këtë drejtim nuk duhet të dobësohen ose të ndihen të nënçmuara:

“E mos u dobësoni (fizikisht) dhe mos u dëshpëroni (shpirtërisht) derisa ju jeni më

të lartit, po qe se jeni besimtarë të sinqertë”. (Ali Imran: 139).

Ata nuk kanë bërë gabim, e as që kanë bërë ndonjë krim. Ata nuk kanë bërë zullum, as që kanë bërë armiqësi. Ajo që i godet ata është lartësim i gradave të tyre, me lejen e All-llahut, subhanehu ve teala.

Dy: Doemos duhet pasur parasysh shkaqet materiale, duhet dhënë tërë mundin tonë, e pastaj t’ia dorëzojmë gjërat All-llahut, subhanehu ve teala. Atëherë e mirë është ajo që ka zgjedhur All-llahu. Në këtë hyn:

1- Dhënia e mundit nënkupton çdo gjë që ka mundësi njeriu ta bëjë, nuk është e kufizuar vetëm në mundin fizik, por gjëja më e rëndësishme në këtë rrafsh është mendimi, planifikimi dhe studimi. Nuk duhet të kemi dilema në derdhjen e pasurisë në këtë drejtim, sepse rezultatet do të jenë shumëfish më shumë se ajo që e shpenzojmë.

2- Muslimani obligohet të jetë i kujdeshëm dhe i përgatitur. Besimi i tij në All-llahun dhe bindja e tij në Te asesi nuk e kundërshton veprimin për shkaqet. Sepse edhe Musai [alehis-selam], peygamberi i Zotit, thoshte:

“Andaj edhe ika prej jush kur u frikësova nga ju, e Zoti im më dhuroi urtësi dhe më bëri nga të dërguarit”. (Esh-Shuara: 21).

Dhe tregon për te duke thënë:

“E ai doli prej aty i frikësuar e duke pritur (se ç’po ndodh) dhe tha: "O Zoti im, më shpëto prej popullit zullumqar". (El-Kasas: 21).

3- Duhet qenë të vetëdëshëm për logjikën e armikut dhe mënyrën se si mendon ai. Veprat nuk duhet peshuar dhe vlerësuar vetëm sipas mendimit tonë. Sepse ate që ne e konsiderojmë aktivitet të daveitit (thirrjes),

ata e konsiderojnë “terrorizëm”, atë që ne e konsiderojmë legjitime, ata nuk e konsiderojnë të tillë. Ka dallim mes nënshtrimit nga mbrenda dhe bashkveprimi tonë me realitetin që e përjetojmë.

4- Medoemos duhet të peshojmë dëmet dhe dobitë, lëshimin e një interesi për t’i ikur një dëmit më të madh se ai, ose për të sjellur një interes më të madh. Kjo është një gjë që gjindet te shumica e thirrësve, natyrisht, në rrafshin ideor, mirëpo zbatimi i kësaj në realitet, është ca ma vështirë, andaj shpesh ndodh që insistojmë në një interes, i cili na e largon një interes më të madh se ai, ose na sjell naj dëm më të madh se ai.

5- Shumë veprime, dëmi i kthehet të gjithëve, e jo vetëm atij që e bën këtë vepër. Andaj ai që bën lëshime, dëmin nuk e përjeton vetëm ai, por edhe të tjerët me te.

6- Krizat në jetën tonë janë mundësi, kurse telashet dhunti. Andaj është shumë me rëndësi që të mundohemi për të zbuluar mundësitë në këto kriza, ndoshta kjo i shpien aktivistët në shtim në rregullimit administrativ, legjislativ dhe financiar të veprimeve të tyre dhe të atyreve me të cilët bashkëpunojnë.

Me përpjekje, kujdes dhe përgaditje, medoemos duhet patur të pranishëm edhe bindjen në All-llahun dhe duhet përkujtuar me këtë element vehten herë pas here.

Kur të dëshirojmë tua bëjmë me dije njerëzve madhësinë e kampanjës kundër daveitit dhe veprimtarisë humanitare, duhet patur kujdes që kjo vepër mos të shndërrohet në element të dëshpërimit dhe depresionit, por duhet të kemi barazpeshë dhe mesatari.

Muhamed ibën Abdull-llah Ed-Dujejsh

Përktheu: Bekir Halimi

17.10.2003

Profil: Alija Izetbegović (1925-2003)

"Kaluum nëpër xhehenem, e mbetëm një-rëz normalë"

Po të mos ishte Alija Izetbegović nuk do të kishte as Bosnjë, tha Riçard Hollbruk kohë më parë kur e vizitoi Izetbegovićin në Sarajevë. Ndërsa vetë Izetbegovići thoshte se para largimit të Sllovenisë dhe Kroacisë nga Jugosllavia lufta mund të shmangej. Pas kësaj: Jo! Alija Izetbegovići, kryetari i parë i Bosnjë Hercegovinës së pavarur, vdiq të dielën në moshën 78-vjeçe.

Izetbegovići, ish-disident gjatë Jugosllavisë së Titos, e braktisi politikën në vitin 2000. Së fundi i sëmurë rëndë, Izetbegovići i porositi kroatët, serbët dhe muslimanët që të shohin nga e ardhmja dhe të mos kërkojnë hakmarrje për të shkuarën e tyre me luftë.

Alija Izetbegovići rridhte nga një familje myslimane, me prejardhje nga Beogradi. Sipas tij, gjyshi i tij Alija, emrin e të cilit e ka trashëguar ai, ka lënë Beogradin në vitin 1868, vit kur të gjithë myslimanët braktisën Beogradin dhe u vendos në Bosanski Shamac, Azizia e dikurshme, sipas Sulltan Azizit, i cili u kishte falë tokat e kësaj krahine.

I ati i tij vendoset në vitet '20 të shekullit XX në Sarajevë dhe Alija, i lindur më 1925 në Bosanski Shamac, fillon jetën e tij të sarajevasit. "Gjithmonë kam pasur dëshirë të bëhem jurist", kujtonte ai.

Më 1946, Izetbegovići burgoset si anëtar i organizatës "Myslimanët e rinj" dhe dënohet me 3 vjet burgim. Më 1956 diplomon në Fakultetin Juridik. Pas burgut boton me pseudonimin LBS një varg artikujsh me tema islame në shtypin vendas dhe të huaj. Ai është autor i "Deklaratës Islame", përmbledhjes "Probleme të Rilindjes Islame", "Islami midis Lindjes dhe Perëndimit", "I kja ime në liri

(shënime nga burgu)", "Vitet e Luftës dhe Paqës", "Mrekullia e Rezistencës Boshnjake".

Më 1983 sërish burgoset dhe në procesin e Sarajevës, si i akuzuari i parë në grupin prej 13 intelektualëve myslimanë u dënua me 14 vjet burgim. U lirua më 1988. Në vitin 1990 formon Partinë e Aksionit Demokratik (SDA), dhe zgjedhet kryetar i saj.

Programi ynë ka qenë ruajtja e Jugosllavisë, se myslimanë kishte edhe jashtë Bosnjë Hercegovinës, në Kroaci, Sanxhak, Kosovë, Maqedoni, thoshte Izetbegovići. Fati i popullit boshnjak shndërrohet në tmerr apokaliptik me shpërbërjen e Jugosllavisë. Bosnja pavarësohet dhe në luftë kundër agresionit serbomadhi, paguan çmimin më të shtrenjtë me mbi 200.000 të rënë.

Izetbegovići atëbotë qe zgjedhur kryetar i kryesisë së Bosnjë Hercegovinës (BeH) deri më 1996. Në bisedimet maratonike për arritjen e paqës në Dayton, Izetbegovići së fundi e lë kryeministrin Haris Sillajxhiq të mundet me Millosheviqin. Është më i ri dhe më energjik, thoshte Izetbegovići.

"Nga ora 4 herët në mëngjes veshja pizhmat dhe rashë të bëj një sy gjumë. Erdhën dhe më thanë se marrëveshja e paqës qe arritur. Vura mbi pizhama diçka dhe u veshja shpejt e shpejt. Kur hyra në sallën ku kremtohej, duket se të gjithë kishin qenë aty dhe vetëm mua më pritnin", shkruan Izetbegovići në memoaret e tij "Kujtimet", botuar pas luftës.

Kur shkrintari, dramaturgu e skenaristi i njohur sarajevas Abdullah Sidran, e pyeti për rastet e revanshizmit ndaj serbëve pas lufte në Sarajevë, Alija Izetbegovići që edhe më herët apelonte që ata që bëjnë incidente të mos thirren në emrin e tij, thotë: "Mos harro Avdo se kaluum nëpër xhehenem, e

përkundër të gjithave kemi mbetur njerëz normalë. Kjo është fitorja jonë".

Izetbegoviçi thotë se ish-të burgosurit politikë shqiptarë i ka takuar në burgjet e Zenicës dhe Foçës. Në burgun e Foçës kishte shumë shqiptarë të dënuar... Ishim miq të mirë, por nuk përziheshim me ta.

"Mendoj se ishim të burgosurit më të respektuar në burgjet e Foçës dhe Zenicës. Të burgosurit na besonin. Kjo ishte arsyeja që shqiptarët nuk na frikësoheshin, në mënyrë që një ditë të na ofronin 'biseda politike' për lëvizjen e tyre politike për 'çlirim kombëtar e social', siç shpreheshin ata", thotë Izetbegoviçi.

Ai kujton se i pranuan këto biseda, jo pa shaka në llogari të dy "palëve negociuese". "Shqiptarët më pyetën se çka mendojmë në për lëvizjen e tyre. Shqiptarët janë popull mysliman dhe kjo është arsyeja që ne përkrahim luftën tuaj për liri", u thashë. Udhëheqësi i delegacionit të tyre ma ktheu se si në fjalën time ka disa përgjigje të gabuara, sepse, sipas mendimit të tij, religjioni ka luajtur rol negativ në historinë e popullit shqiptar dhe ju ka shërbyer okupatorëve. "Religjioni është i tejkalluar dhe i panevoj-


shëm për popullin tonë, në luftën e tij për liri", përfundoi "shoku".

"Atëherë ju jeni populli i vetëm në planet, i cili mund të jetojë pa religjion", u përgjigja unë, "por kemi përshtypjen se shumica e popullit shqiptar nuk mendon kështu".

"Vetëm marksizëm-leninizmi i solli progres popullit tonë",- tha me vetëbesim. "Atëherë mirë, ju shkoni kësaj rruge, kjo është puna juaj, ndërsa sa na përket neve, ne do t'i përkrahim edhe më tutje kërkesat e drejta të popullit shqiptar për barazi e liri, u thashë unë. Me këtë biseda mori fund, por ne edhe më tutje mbetëm miq të mirë, rrëfen Izetbegoviçi.

Izetbegoviçi është fitues i Çmimit për të Drejtat e Njeriut i qytetit të Izmirit (1994), është dekoruar me medaljen kroate "Mbreteresha Katarina" (1995), më 1997, Doktor Nderi i Universitetit Marmara të Stambollit, Doktor Nderi i Universitetit të Riadit, Medaljen e Lirisë e Republikës së Turqisë, më 1998, Medaljen e Pavarësisë të Katarit dhe Kartën e Paqes të Ligës Ndërkombëtare Humaniste, shpërblimin e Foromit "Crans Montana" për promovimin e të drejtave të njeriut (1999).

Lulzim Mjeku,
24.10.2003



Vdekja pas një pendimi

Esselamu alejkum vëllezër në fe.

Ky është një tregim që më ka ndodhur mua personalisht. Para tre javëve më erdhi një email, të cilin ma kishte dërguar një vajzë, e cila jetonte në Australi. Mes tjerave në email qëndronte edhe kjo: “Jam një vajzë libaneze, nga një babë musliman dhe një nënë e krishterë. Kam jetuar në Liban dhjetë vjetët e para, e pastaj kemi migruar me babain dhe nënën time në Australi që të ndërpritet lidhja ime tërësisht me lindjen e mesme që nga kjo datë. Tani kam 22 vjet. Me udhëtimin tim atje kam ndërprerë të gjitha kontaktet me fenë time. Tërë atë që di mbi fenë është vetëdija se unë jam muslimane, nuk e di formën e mus'hafit, nuk e di as fatihanë, nuk di si të falem, kurse feja nuk paraqet asgjë në jetën time. Pastaj u nda babai nga nëna ime dhe secili prej tyre u martua me tjetërkënd, gjersa unë hyra në universitet. Që të dytë e lanë Australinë dhe më lanë mua të vetmuar, pa familje dhe pa vëllezër. Nuk di asgjë për gjyshërit e mi që jetojnë në Liban. Kam jetuar e vetmuar. Më është imponuar që të punoj për të shpenzuar për vetevten. Në mëngjes studioja në universitet, kurse në mbrëmje punoja në Bar. Kisha edhe dashnor (boy friend), në kuptimin perëndimor të fjalisë. Nuk kam lërë gjë të ndaluar pa e bërë, pa turp dhe pa dhimbje. Jam bërë tërësisht perëndimore. Gjuhen arabe e di dobët.

Pasiqë isha shumë e bukur, mora pjesë në mis të bukurisë të Zelandës së Re dhe fitova vendin e parë në qytetin ku u mbajt kjo

garë. Tani përgatitem të hyjë në gara për mis të Zelandës së Re. U bëra fotodomel e gazetave amorale. Ndërkohë vizitoja një familje libaneze që jetonin në Australi. Te ata pashë një seri të programeve të Ramazanit, ku fliteshte për nderin, e atje e pashë këtë adresë. U befasova. Ky program më flet mua. Andaj ju drejtova juve që t’ju pyes: a ka mundësi që të më pranohet All-llahu dhe a ka mundësi të kthehem te Zoti?”.

Më erdhi kjo letër dhe thashë: subhanallah, shpirti njerëzor sado që gjindet në fund të fundit, vazhdimisht mallëngjehet për Zotin dhe ashtu sikurse uritet barku për ushqim, ashtu shpirti i uritet për Zot.

Ja dërgova përgjigjen ku i thash se natyrisht që All-llahu ta pranon pendimin tënd dhe e udhëzova në disa kushte të pendimit.

Mua lajmërua pas dy ditëve duke më thënë: “Jam penduar, kam lënë dashnorin tim dhe nuk do ta shoh më pas sodit”.

Pastaj mu lajmërua pas dy ditëve e më tha: “Dëshiroj të mësoj të falem”.

Pas dy ditëve mu lajmërua duke thënë: “dëshiroj të kem audio kasete me lexime të Kur'anit”.

I dërgova me DHL kasete me lexim të Kur'anit, prej lexuesve të ndryshëm, siç është Axhemiu, Meshari Rashid, nga lexuesit e Medines dhe të gjitha kasetat e mia.

Heshti një javë. Pastaj sërish mu lajmërua duke thënë:

“Kam dhënë dorëheqje nga mis i bukurisë së qytetit”.

E pas katër ditëve më befasoi duke më thënë:

“Jam mbuluar”.

Mirëpo tregimi nuk përfundon këtu.

Pasiqë u mbulua, pas dy ditëve, lajmërohet dhe më tregon se ndien dhimbje të mëdha. Shkoi në mjek dhe më tregoi se mjeku i ka treguar se ka kancer në tru dhe se ditët e jetës i ka të numëruara.

Kjo vajzë do të hyn në operacion në Australi të premtën e ardhshme për të bërë një ndërhyrje emergjente në tru, kurse mundësia e suksesit është 20 %, siç kanë thënë mjekët e atjeshëm.

Këtë e kanë thënë mjekët, kurse ajo më dërgoi një letër ku thoshte atë që s'kanë mundur ta thonë as dijetarët e dalluar në adhurim:

“Unë jam shumë e gëzuar me takimin me Zotin. Jam e gëzuar që jam penduar para se ta dija se jam e sëmurë. Nuk e di se a do ta dij babi dhe nëna ime këtë që më ka ndodhur. Ata shumë rrallë më lajmërohen, mirëpo unë jam penduar që tre javë, kurse 20 vjet kam bëtë mëkate karshi Zotit. All-llahun e lus që të më bëjë nga banorët e xhennetit, e nëse jetoj të jem në shërbim të islamit në këtë faqe tuajën. Kjo faqe ishte dritareja ime drejt Islamit”.

Komenti im: lutjuni All-llahut së bashku me mua që të shëron. Flasi ditën e xhuma, inshaAll-llah.

I lartësuar qoftë All-llahu, i cili i udhëzon robërit e tij, ua pranon pendimin dhe i mëshiron me mëshirën e gjërë.

Rënkimi i mëkatarëve është më i dashur te ne se sa lavdërimi i mburravecave.

Kurse sot shkroi këtë:

In-na lillah ve inna ilejhi raxhiun. Të All-llahut jemi dhe te Ai do të kthehemi. All-llahu ynë na shpërble në këtë fatkeqësi tonën dhe na e kompenzo me diç ma të mirë. Sara 22 vjeçare vdiç dhe u varros sot te varezat e muslimanëve në Zelendë të Re. Ia falën namazin e xhenazës pas namazit të xhumasë, kurse mua më dërgoi një letër të shkurtër para operacionit, ku mes tjerash thoshte:

“Kam jetuar 22 vjet larg Zotit, mirëpo jam penduar që tre javë. Kam dëshmitar All-llahun se jam penduar dhe jam larguar nga dashnori im, nga puna në bar dhe kam lënë mis bukurinë, jam mbuluar dhe falem rregullisht. Zotin e kam dëshmitar se tërë këtë e bëj vetëm për hirë të Zotit tim. Unë nuk njoh musliman përveç teje dhe përveç këtij forumi. Ju lutem, lutuni për mua që të më mëshiroj Zoti, të m'i falë mëkatet. Lutuni të më udhëzojë Zoti nënën time, sepse ajo nuk di asgjë për mua”. Sara.

Ju lutem bëni çdo gjë që keni mundësi, haxh, sadaka dhe lutje për Sarën. A e shihni mëshirën e Zotit ndaj robërve të vet. Zoti ka caktuar të vdes në këtë kohë, mirëpo shikoni mëshirën e Zotit, i Cili ia mundësoi pendimin dhe ikjen nga mëkatete tre javë para se të vdes.

“Në të gjitha këto ka përkujtim, për atë që ka mendje të shëndoshë, që i ka vënë veshin me vëmendje, dhe është i pranishëm”. (Kaff: 37).

Marrë nga: amrkhaled.net

Përshtati: Bekir Halimi

03.10.2003

Kur'ani fisnik si sfidë për pabesimtarët

Kur'ani nuk është unik vetëm përse i përket mënyrës sesi e prezanton subjektin por gjithashtu ne te është vetë mrekullia. Me fjalën "Mrekulli" ne kuptojmë shfaqjen e një ngjarjeje mbinatyrore dhe të jashtzakonshme e cila nuk mund të dublifkohet nga njerëzit.

Është vërtetuar që Pejgamberi Muhammed, salallahu alejhi ve sel-lem, i ka sfiduar arabët për të krijuar një vepër letrare të ngjashme me kalibrin e Kur'anit por ata ishin të paaftë që ta bëjnë një gjë të tillë përkundër fuqisë elokuate dhe letrare që ata posedonin.

Sfida për të bërë diçka si Kur'ani u ishte prezantuar arabëve dhe njerëzve në pergjithësi në tre etapa:

1. Kur'anin e tërë

Në Kur'an Allahu urdhëroi Pejgamberin, salallahu alejhi ve sel-lem, të sfidoj të gjitha krijesat për të krijuar një libër në nivelin e Kur'anit: "Thuaj: Edhe sikur të bashkoheshin njerëzit dhe xhinët për të sjellë një Kur'an të tillë, ata nuk do të mund ta bënin si ky sa do që do ta ndihmonin njëri tjetrin". (17: 88)

2. Dhjet sure

Në tjetrën Allahu bëri sfidën të duket më e lehtë duke i pyetur ata që mohonin origjinën hyjnore të Kur'anit, për të imituar madje edhe 10 sure kur'anore: "Apo pse ata thonë: Ai (Muhammedi) e trilloi atë Kur'anin. Thuaj formuloni pra dhjetë kaptina si ai (Kur'ani) ashtu të trilluara (siç thoni ju) dhe thirrni pos Allahut po qe se jeni të drejtë (sikur që thoni) kë të doni për ndihmë". (11: 13)

3. Sfida finale ishte të krijojnë madje edhe një sure të vetme për ta krahasuar me Kur'anin i cili përmban edhe sure të vogla siç është ajo El-Keuther (Mirësia) me tre vargje: "E nëse jeni në dyshim për atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë, atëherë sillni ju

një kaptinë të ngjashme si ai (Kur'ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotat) pos Allahut nëse jeni të sinqertë (në thëniet tuaja se Kur'ani nuk është prej Zotit)." (2: 23)

Këto sfida nuk ishin vetëm fjalë të pabazura të cilat nuk u provuan nga të gabuar. Pejgamberi Muhammed, salallahu alejhi ve sel-lem, thirri në monoteizëm dhe në zhdukje të idhujtarisë me të gjitha format e saja dhe në barazimin e skllëvërve dhe pronarëve të tyre. Gjëra këto të cilat kërcënonin gjithë strukturën social-ekonomike të shoqërisë Mekase në përgjithësi dhe pozitën e fisit Kurejsh nga i cili ishte Pejgamberi Muhammed, salallahu alejhi ve sel-lem, në veçanti.

Meka qendra tregtare e Arabisë dhe qendër shpirtërore dëshpërimisht donte të ndalte përhapjen e Islamit. Dhe kundërshtarët e Pejgamberit për të shtypur levizjen e tij duhej të bënin një sure të vetme si ato që Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, dhe ndjekësit e tij recitonin njerëzve.

Një numër i oratorëve dhe poetëve kurejshit u përpoqën të imitojnë Kur'anin por ata dështuan në këtë.

Ata pastaj i ofruan atij shumë të madhe pasurie, pozitën e mbretit mbi ata dhe gratë më të ndershme dhe më të bukura që kishin, vetëm për një premtim të tij se do të ndalte të ftuarin e njerëzve në islam.

Ai iu pergjigj atyre duke iu recituar vargun e trembëdhjetë të sures Fussilet deri sa i thanë atij të ndalet. (hadithi i koleksionuar nga El_Hakim, El-Bayhaqee, Abu Ya'laa dhe Ibën Hashim i deklaruar i vërtetë nga Ibrahim al-Alee në Saheeh as-Seerah an-Naba-weeyah, f. 64)

Kurejshitët mandej provuan të torturojnë skllëvërit dhe të afërmit e tyre të cilët përqa-

fonin islamin, një përpjekje e pasukseshme për t'i kthyer ata në paganizëm.

Më vonë ata organizuan një bojkot ekonomik kundër Pejgamberit dhe antarëve të klanit të tij, Beni Hashim në një përpjekje për ti nënshtuar me anë të një praktike makabre duke i lënë të vdesin pa ngrënë. Por ata dështuan madje edhe me këtë plan. Në fund vendosën ta vrasin atë në shtëpinë e tij duke dërguar djemë të rinjë nga çdo klan i kurejshitëve në mënyrë që faji i kësaj vrasjeje të ndahet nga të gjitha klanet, duke e bërë hakmarrjen e klanit të Pejgamberit të pamundur.

Megjithatë Allahu e aftësoi Pejgamberin, salallahu alejhi ve sel-lem, dhe ndjekësit e tij të largohen nga Meka dhe të bashkohen aty me një grup të konvertuarish në islam të cilët u rritën midis fiseve të një qyteti në veri të quajtur Jathrib. Islami u përhapte me shpejtësi përmes klaneve të Jathribit dhe brenda një viti muslimanët u bënë shumicë. Pejgamberi Muhammed, salallahu alejhi ve sel-lem, ishte bërë asokohe qeveritari dhe emri i qytetit ishte ndryshuar në Medina en Nebi (Qyteti i pejgamberit) i cili pastaj u shkurtua në Medina. Në tetë vitet e më vonshme klanet e Mekës dhe fqinjët e vendet fqinje të tyre ndërmorrën një seri të pasukseshme luftërash që përfunduan me pushtimin e vetë Mekës.

E gjithë kjo gjakderdhje mund të ishte evituar nëse vetëm kurejshitët dhe bashkpuntorët e tyre të kishin qenë të aftë të bënin

vetëm tre rreshta poezi ose proza të rrjedhshme të ngjashme me suret e Kur'anit.

Kjo tregon që nuk ka dyshim rreth paimitueshmerisë së stilit të literaturës kur'anore rreth mrekullisë së rimës dhe mrekullisë së ritmit.

Është sugjeruar që paimitueshmërinë e Kur'anit nuk është e vetme për poetet anglez si Shekspiri, Chaucer ose poetet e mëdhenj të çdo gjuhe të cilët pretendohen të dallohen në stilin i cili i vendosë ata përkrah bashkëkohësve të tyre.

Nëse për shembull disa poet të sotëm do të studionin shkrimet e Shekspirit dhe të shkruante një sonnet në stilin e Shekspirit në bojë të vjetër dhe në një leter të vjetër dhe të thoshte që ai ka zbuluar një poemë të humbur të Shekspirit letërsia botërore mund ta pranonte këtë edhe pas një studimi të kujdesshëm. Pra edhe poetët më të mëdhenj mund të imitohen. Në fakt dijetarët anglez e konsiderojnë se shumica e asaj që i është atribuar Shekspirit është shkruar nga bashkëkohësi i tij Christopher Marlowe. Kur'ani megjithatë është shumë lartë mbi këto nivele, përpjekjet për të shpikur disa vargje janë bërë përmes kohërave akoma asnjë nuk i qëndron afër.

Dhe sic është përmendur edhe më përpara, përpjekjet për të imituar Kur'anin ishin shumë më intensive gjatë kohës së shpalljes kur njohuritë letrare ishin të një niveli sesa në një kohë tjetër, ende nuk ishin përpjekje të sukseshme.

Dr. Abu Ameenah Bilal Philips

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

10.10.2003

Stili i flokëve të Profetit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem

Stili i flokëve të Profetit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem është i përmendur në një numër hadithesh të tilla si të mëposhtmet:

1. Flokët e tij nuk ishin as kaçurrela dhe as të drejta.

Është transmetuar që Enes Ibn Melik ka thënë duke përshkruar Profetin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ai ishte në një peshë mesatare as i gjatë dhe as i shkurtë. Ai kishte një ngjyrë të lehtë as shumë të bardhë dhe as shumë të errët dhe flokët nuk ishin as kaçurrela e as të drejta shpallja i erdhi atij kur ai ishte katërdhjetë vjeç.

[Transmetuar nga el-Buhari 3354, Muslimi 2338]

2. Flokët e tij i vinin deri tek bulat e veshëve.

Është transmetuar që el-Bara ibn Azib, radi-all-llahu anhu, ka thënë: "Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte në një peshë mesatare dhe me shpatulla të gjëra. Ai kishte flokë që vinin poshtë deri tek bulat e veshëve. Unë e pashë atë duke veshur një rrobë të kuqe dhe unë kurrë nuk kam parë askënd më të pashëm se ai.

[Transmetuar nga el-Buhari 3358; Muslimi 2337]

3. Flokët e tij ngandonjëherë vinin deri tek shpatullat e tij.

Është transmetuar që Kutadah ka thënë: "Unë e pyeta Enes Ibn Melikun, radi-all-llahu anhu, rreth flokëve të Profetit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Ai më tha: "Flokët e Profetit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem nuk ishin as kaçurrela dhe as të drejta dhe vinin deri tek një pikë midis veshëve të tij dhe shpatullave të tij.

[Transmetuar nga el-Buhari 5565; Muslimi 2337]

Sipas një transmetimi tjetër flokët e tij preknin shpatullat e tij.

[Transmetuar nga el-Buhari 5563; Muslimi 2338]

Ngandonjëherë flokët e tij ishin më të shkurtëra se ato. Të gjitha këto mund të kuptohen duke iu referuar situatave të ndryshme dhe çdo sahabah ka transmetuar çfarë ai ka parë.

4. Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem i ka ngjyrosur ngandonjëherë flokët e tij.

Është transmetuar që Uthman Ibn Abdullah Ibn Muhibi ka thënë: "Unë hyra tek Umm Selemah dhe ajo solli jashtë tek ne një nga flokët e Profetit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i cili ishte i ngjyrosur.

[Transmetuar nga el-Bukhari 5558]

Ahmedi [25328] ka shtuar: të ngjyrosur me këna dhe katam.

[Katam është një bimë që është përdorur për të ngjyrosur flokët. Kur përzihet me kënen i jep flokëve një ngjyrë midis të zezës dhe të kuqes. Shiko Aun el-Mabud komentimi i hadithit nr. 4205]

5. Ai i ka ndarë flokët e tij.

Është transmetuar nga Ibn Abasi radi-allahu anhu që Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka lënë flokët e tij të rëna mbi ballin e tij ndërsa mushrikunët i ndanin flokët e tyre dhe njerëzit e popujve të librit i kanë lënë flokët e tyre të rëna mbi ballin e tyre. I dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka pëlqyer të jetë si popujt e librit në çështje ku nuk ka patur ndonjë urdhër specifik. Atëherë i Dërguari i Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka ndarë flokët e tij.

[Transmetuar nga el-Bukhari 3365; Muslimi 2336]

Disa dijetarë e kanë diskutuar kuptimin e këtij hadithi dhe komentet e tyre janë përmbledhur nga Imam el-Neveviu si më poshtë:

Mendim më i miri janë të dyjat, lëshimi i flokëve mbi ballë dhe ndarja e tyre janë të lejuara por që ndarja është më e mirë.

Sharh Muslim 15/90

6. Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka kryer haxhin kur flokët e tij i kishte të ngjitura.

Kjo do të thotë i ka bërë disa pjesë të flokëve të ngjiten duke përdorur lëng ngjitës ose ndonjë gjë të njëjtë me të kështu që flokët janë grumbulluar bashkë dhe duke iu shmangur pisllekut dhe nuk kishin nevojë të lahen. Kjo është më e lehtë për një person i cili është në ihram veçanërisht në të kaluarën kur personi në ihram ishte përballuar me shumë pisllek dhe pak ujë.

Është transmetuar që Ibn Umar radi all-llahu anhu ka thënë: "Unë e pashë të Dërguarin e Allahut, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke ngritur zërin në Telbijah me flokët e tij të ngjitur.

[Transmetuar nga el-Bukhari 5570; Muslimi 1184]

7. Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem nga ndonjëherë i ka gërshetuar flokët e tij veçanërisht kur udhëtonte për ti mbajtur pastër nga pluhuri. Është transmetuar që Umm Hani ka thënë: "Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka ardhur në Mekë me katër gërsheta".

[Transmetuar nga el-Tirmidhiu 1781, Ebu Daudi 4191, Ibn Maxhah 3631. I klasifikuar si sahih nga el-Hafiz Ibn Haxhër në Fath el Bari 10/360].

Përsa i përket llojeve të stileve të flokëve që janë të ndaluar ata janë të kategorizuar nga të mëposhtmet:

1. el-Kaza është kur një pjesë e flokëve rruhet dhe lihet një pjesë tjetër.

Është transmetuar nga Ibn Umari që Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e ka ndaluar el-Kazan.

[Transmetuar nga el-Bukhari 5466, Muslimi 3959].

Njëri nga transmetuesit e këtij hadithi e përshkruan el-Kazan si rrurja e një pjese të kokës së fëmijës dhe lënia e disa flokëve të tij.

Ibn Kajjimi rahimahullah ka thënë:

"Përsa i përket rruarjes së një pjese të kokës dhe lënies së pjesës tjetër është me grada të ndryshme.

Më e keqja është rruarja e majës së kokës dhe lënia e anëve ashtu si veprojnë murgjit.

Pastaj vjen rruarja e anëve duke lënë mesin siç veprojnë shumë budallenj dhe njerëz të pavlerë.

Pas kësaj vjen rruarja e flokëve përpara dhe lënia e flokëve mbrapa.

Këto tre stile të gjitha biejnë nën përkufizimin e el-Kazas e cila është e ndaluar nga Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, por disa prej tyre janë më të këqia sesa të tjerat".

[Ahkam ehlul el-Dhimmah 3/1294]

2. Imitimi i kuffarve dhe njerëzve imoral.

Ka shumë stile flokësh të tillë të cilët biejnë nën përkufizimin e el-Kazasë - të tilla si stili i flokëve i Marinsave i cili është i ndaluar për dy arsye sepse është një lloj Kazaje dhe sepse është imitim i kuffarve. Disa prej tyre nuk hyjnë në përkufizimin e kazasë por ato janë stile që i përkasin kuffarve të tilla si bërja e disa flokëve për të qëndruar lart dhe lëshimin e disa të tjera si të varura dhe kështu me rradhë.

Kjo gjithashtu përfshinë çdo stil floku që i përket kuffarve ose njerëzve amoral sepse nuk është e lejuar për një musliman t'i ngajjë atyre në të sepse Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kush imiton një popull ai është prej tyre".

[Transmetuar nga Ebu Daudi 4031. I klasifikuar si hasan nga el-Hafiz Ibn Haxhar në Feth el-Bari 10/271. Zingjiri i tij i transmetimit është i klasifikuar si i mirë nga Sheikhul Islam në Iqtida el-Sirat el-Mustekim faqe 82].

Sheikhul Islam ka thënë:

Më e pakta që mund të themi rreth këtij hadithi është që implikon që është haram për t'i imituar ata megjithëse kuptimi i dukshëm është që ai i cili i imiton ata është kafir ashtu si në ajetin "Dhe nëse ndonjë nga ju i merr ata si eulijah atëhere me të vërtetë ai është nga ata".

[el-Maide 5:51]

Iktida el-Sirat el-Mustekim faqe 83.

Ilimitimi i budallejnve.

Këto stile flokësh që bëhen nga budallenj të cilët mund të futen në kategoritë që përmendëm më lart.

Dhe Allahu e di më së miri.

Përktheu: (Ammar) Ardit Kraja,
17.10.2003

Mirë se vjen mysafir i ri

Bota islame këto ditë jeton në pritje të madhe dhe me mallëngjim të madh takimin e të dashurit që mungon, të cilin e presim gjatë kohë, afërsisht një vjet, që të na sjell retë e bereqetit dhe hijen freskuese.

Vjen ky mysafir i çmueshëm që të na i pastron shpirtërat dhe të na i pasuron me besim, devotshmëri dhe nozull për në ahiret.

"...por shpërblimi i tyre në botën tjetër është shumë më i mirë, e sa vend i mirë është ai i të devotshëmve". (En-Nahl: 30).

Vjen që ta mëson shpirtin tonë në durim dhe qëndresë, nënshtrim dhe frikërespekt, e ikje nga mëndjemadhësia.

Vjen që të sjell unitet në ummetin Islam, në një kohë, në një adhurim, në një muaj.

Vjen që ta kthen shpirtin e shkujdesur kah Zoti i vet, që ta kthen njeriun në xhamia, ata që shkujdesen për farefisën që të vazhdojnë marrëdhëniet farefisnore, ata që janë fundosur në epshe, që të frenojnë vehten, përta-cat nga adhurimet e shumta, që të kthehen në adhurime, në namaz nate, në lutje në kohën e syfyrit, kur njerëzit flejnë, ose lozin.

Pra, ky muaj i Ramazanit, është muaj i mëshirës dhe faljes, muaj i bereqetit dhe bamirësisë, muaj i çlirimit nga zjarri, muaj i le-

ximit të Kur'anit me meditim, muaj i agjërit dhe namazit të natës, muaj i bamirësisë ndaj prindërve, kujdesit për farefisën, dhe vizitat mes vëllezërve dhe miqëve.

Muaj ku shtohet falja e All-llahut, hapen dyert e xhennetit, mbyllen dyert e xehene-mit dhe prangosen djajtë e inatosur.

"Muaji i Ramazanit që në te (filloi të) shpallet Kur'ani, që është udhërrëfyes për njerëz dhe sqarues i rrugës së drejtë dhe dallues (i të vërtetës nga gënjeshtra)...". (El-Bekare: 185).

Mirë se vjen mysafir i nderuar, mysafir i Zotit, i dashuri i Tij, mirë se vjen ky muaj i mëshirës, bereqetit dhe faljes.

Të zgjedhurit e këtij ummeti e lutnin Zotin gjashtë muaj që ta arrijnë Ramazanin, e kur u vinte e lusnin Zotin që t'ua pranon veprat që i kanë bërë gjatë këtij muaji, pesë muajt tjera.

Vallë, a do të veprojmë sikur kanë vepruar ata, a do ta pranojmë këtë muaj si e kanë pranuar ata dhe a do të veprojmë mirë sikur kanë vepruar ata?! Ta shpresojmë këtë!

Vëlla i bekuar, të përgadisim vehten, zemrat, mendjet dhe shpirtërat tonë për ta pritur këtë muaj të madh, para se të përgadisim trupin tonë për të blerë gjërat e këndshme, ushqimet dhe pijet e duhura, në këtë muaj,

në të cilin jem, i obliguar të agjërojmë për të pastruar shpirtat, për tu drejtuar nga Zoti dhe për t'ju nënshtuar Atij, me qëllim të fitojmë kënaqësinë e Tij.

Mirëpo si të jemi mikpritës të mirë?

Ndoshta gjërat që duhet t'i bëjë muslimani si përgatitje për mikpritje të mirë të këtij sezoni të adhurimeve janë të shumta, ne shkurtimisht do ti përmendim disa prej tyre:

1- Ta përgatisim vehten për një sezon përplot me vepra të mira, e cila është mundësi shumë e madhe për të mira, për të shtuar adhurimet dhe për të fituar shumë të mira.

2- Gëzimi për ardhjen e këtij muaji, zemërgjërësia se na afrohet ky muaj, lumturia se do ta takojmë këtë muaj, sepse një njeri mund të fitojë mëshirën dhe dhuntitë e All-llahut në një natë të bekuar, e të fitojë lumturinë e dunjasë dhe të ahiretit.

3- Të nxitojmë në pendim të sinqertë nga të gjitha mëkatet dhe gabimet, të bëjmë istigfar për çdo mangësi që kemi karshi Zotit, të ndiejmë keqardhje për çdo gjë që kemi bërë në të kaluarën, qofshin të mëdha ose të vogla. Këtë muaj të fillojmë nga fillimi, që ta mbushim faqen e bardhë me të mira dhe vetëm me të mira, e mos të njollosim me asgjë tjetër.

4- Të jemi të vendosur që ta shfrytëzojmë çdo çast të këtij shansi të madh në gjëra që na afrojnë drejt Zotit, qoftë falja e namazit me xhemat në xhami, plotësimi i agjërimit, falja e namazit të natës pa lodhje dhe pa mërzi, leximi i Kur'anit, kujdesi për prindërit

dhe farefisin, dhënia sadaka, bamirësia, e shumë vepra tjera të mira.

5- Ti lutemi All-llahut para se të hyjë muaji i Ramazanit që të na mundësojë arritjen e këtij muajit, që të na ndihmojë në plotësimin e agjërimit dhe namazit, të pranojë veprat tona, e ti bëjë shkak të faljes së mëkateve, ngritjes së gradave dhe çlirimit nga zjarri.

6- Ta falënderojmë All-llahun dhe ta lavdërojmë Atë ditë e natë, nëse ta zgjat ymrin dhe ta mundëson ta takosh këtë muaj të bekuar, e nëse ta lehtëson agjërimin dhe namazin në këtë muaj.

7- Përgadit shtëpinë për mikpritje meritorë të këtij mysafiri dhe nxit familjen tënde që të përgaditen për te, duke nxjerrur të gjitha gabimet, që të jetë shtëpia e pastër dhe e përgaditur për tu mbushur me adhurime dhe respekte dhe duke përgatitur numër të mjaftueshëm të mus'hafave.

8- Llogarit paraprakisht sasinë e zekatit që duhet ta japish, nëse e plotëson vitin në Ramazan, ose nëse zakonisht e jep zekatin në Ramazan.

9- Nxito të kompenzosh ditët që i ke të paagjëruara nga Ramazani i kaluar dhe mos jeni liberal në këtë drejtim, e të arrijë ky Ramazan pa e larë borxhin nga Ramazani i kaluar, sepse kështu bëhesh mëkatar.

E lus All-llahun, tebareke ve teala, që të gjith muslimanëve t'ju mundësojë ta arrijnë këtë muaj të bekuar dhe të na ndihmojë në agjërimin, namazin dhe të na i pranojë këto adhurime... amin.

Omer Abdul-Aziz El-Hamd

Përshtati: Bekir Halimi

24.10.2003

Bëhuni vëllezër!

Vëllezëria ka pozitë shumë të madhe në fenë e All-llahut, subhanehu ve tealë dhe jep frytë të bereqetshme. Për këtë pozitë të lartë të vëllezërisë në Islam tregojnë shumë ajete dhe hadithe.

Vëllezëria ka rregulla dhe edukatë, kushte dhe detyra, disa janë obligative e disa janë të pëlqyeshme.

Për këtë rëndësia që ka, për shkak të pranisë të shumë elementeve që e prishin këtë gjë, për t'i forcuar besimtarët e sinqertë në vëllezërinë tyre, për ti përgëzuar për vlerën e vëllezërisë, ua paraqesim këtë shkrim.

Definicioni i vëllezërisë

Në aspektin gjuhësor i referohet afërsisë në soj dhe participimit në lindje të afërt, nga baba dhe nëna. Mund t'i referohet edhe sojit më të largët, sikurse thuhet: vëllau i arabëve, ose siç ka ardhur në Kur'an:

“Edhe te (populli) Ad-i (dërguam) vëllain e tyre Hudin, ...”. (El-Araf: 65).

Kjo është origjina e përdorjes.

Kurse terminologjikisht domethënë:

Vëllezëria islame, që paraqet lidhjen mes dy personave që i përkasin fesë Islame, edhe në qoftëse mes tyre nuk ka ndonjë participim në babë dhe nënë. Në bazë të kësaj vëllezëri mund t'i thuhet dy gjërave:

a) vëllezëria në soj dhe

b) vëllezëria islame. Kjo e dyta është boshti i temës sonë.

Metodat e sherijatit në realizimin e vëllezërisë

1- Tregimi se vëllezëria ndodh mes besimtarëve, siç thotë All-llahu, subhanehu ve tealë:

“S'ka dyshim se besimtarët janë vëllezër, ...”. (El-Huxurat: 10).

Ky lajmërim sikurse të flet për diçka të njohur, andaj kjo është më e fuqishme si shprehje se sa të thuash, bëhuni vëllezër.

2- Vëllezërinë e konsideron si dhuratë e Zotit mbi njerëzit.

“...dhe ashtu me dhuntinë e Tij u dakorduat të jeni vëllezër. ...”. (Ali Imran: 103).

3- Konsideron vëllezërinë shkak për të arritur dashurinë e All-llahut, subhanehu ve tealë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem në hadith thotë:

“Një njeri vizitoi një vëlla të vetin në një fshat tjetër. All-llahu dërgoi një melek ti del në rrugë. Kur iu afrua i tha: ku po synon? Tha: ta vizitoj në vëlla timin në këtë fshat. Tha: ke ndonjë të mirë që e fiton prej tij. Tha: jo, vetëmse e kam dashur për hirë të All-llahut. Tha: unë jam i dërguari i All-llahut te ti që të tregoj se All-llahu të do, ashtu sikurse ti e do këtë njeri”. (Muslimi).

Kurse në një hadith tjetër kuds i qëndron:

“E meritojnë dashurinë Time ata që duhen për hirë Timen, e meritojnë dashurinë Time ata që vizitohen për hirë Timen, e meritojnë dashurinë Time ata që dhurohen mes vehte për hirë Timen dhe e meritojnë dashurinë Time ata që kujdesen për njëri tjetrin për hirë Timen”. (Sahih, Ahmedi dhe të tjerët).

4- E konsideron vëllezërinë hallkë më të rëndësishme të besimit.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Hallka më e rëndësishme e besimit është të duash për All-llahu dhe të urrejsh për All-llah”. (Bezzari, sahih).

5- Konsideron atë që do të barabartë me ate që e do.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë: “Njeriu është me ate që e do”. (mutefekun alejhi).

6- Ka shpërblim shumë të madh.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë: “All-llahu, subhanehu ve teala në ditën e Kijametit do të thotë: ku janë ata që duhen mes vehte për hirë të Madhërisë sime, sot i fus nën hijen Time, në këtë ditë që ska hije tjetër përpos hijes Sime”. (Muslimi).

7- E konsideron shkak për të arritur ëmbëlsinë e besimit.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë: “Kush i ka tre gjëra do të gjejë ëmbëlsinë e besimit; ta do All-llahun dhe Pejgamberin ma shumë se çdo gjë përveç tyre, ta do një njeri vetëm për hirë të All-llahut dhe të urrejë të kthehet në kufër (mosbesim) ashtu sikurse urrenë të hedhet në zjar”. (Buhariu dhe Muslimi).

8- Më i miri është ai që më së shumti e do vëllaun e tij.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë: “Nëse duhen dy njerëz për hirë të All-llahut, më i miri prej tyre është ai që më së shumti e do vëlluan e tij”. (sahih, Buhariu në “Edebul-Mufred” dhe të tjerët).

9- All-llahu, subhanehu ve teala këtë vepër e ka bërë shkak për të plotësuar besimin.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë: “Kush do ndokend për hirë të All-llahut dhe e urren tjetrin për hirë të All-llahut, kush jep për hirë të All-llahut dhe kush nuk i jep tjetrit për hirë të All-llahut, ai ka plotësuar besimin”. (sahih, Ebu Davudi).

10- All-llahu, subhanehu ve teala e ka bërë shkak për të fituar besimin, e në vijim hyrjen në xhennet.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Pasha Ate në Dorë të të Cilit është shpirti im nuk do të hyni në xhennet derisa nuk besoni, e nuk do të besoni derisa nuk duheni mes vehte. A t’ju tregoj një gjë, të cilën nëse e veproni, do të duheni mes vehte: përhapne selamin mes jush”. (Muslimi).

Frytet e vëllezërisë

Vëllezëria ka fryte shumë të mira, të cilat vjelen në dynja dhe ahiret.

Prej fryteve që vjelen në ahiret janë:

1- Të hyjë nën hijen e All-llahut atë ditë që ska hije tjetër përveç hijes së Tij, siç treguam në hadithet e parakaluara.

2- Arritja e pozitive të larta në ahiret.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem tregon e thotë:

“All-llahu, subhanehu ve teala thotë: “Ata që duhen mes vehte për hirë Timin, kan kolltuqe nga drita, ua kanë lakmi pejgamberët dhe shehidat”. (Sahih, Tirmidhiu).

Këtë vend të lart e arrijnë duke dashur njerëzit për hirë të All-llahut, subhanehu ve teala.

3- Arritja e gradave më të larta në ahiret se sa i kanë merituar me veprat e tyre.

Enesi, radijall-llahu anhu, tregon se një njeri e pyeti Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për Kijametin, duke i thënë: kur ndodh Kijameti? Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem i tha: çka ke përgaditur për te? Tha: asgjë më shumë, vetëmse unë e dua All-llahun dhe Pejgamberin. Tha: ti je me ata që i do. Enesi, radijall-llahu anhu tha: me asgjë nuk jemi gëzuar sa jemi gëzuar me fjalën e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: ti je me ate që e do. Enesi thotë: unë e dua All-llahun, Pejgamberin, Ebu Bekrin dhe Omerin dhe shpresoj të jem me ata, për shkak të dashurisë sime ndaj tyre, edhe pse skam punuar sa ata”. (Buhariu dhe Muslimi).

Prej fryteve që vjelen në dynja, të cilat automatikisht ndikojnë që edhe të ngritet pozita e tij në ahiret është kjo që vijon:

1- Shijimi i ëmbëlsisë së besimit.

“Kush i ka tre gjëra do të gjejë ëmbëlsinë e besimit; ta do All-llahun dhe Pejgamberin ma shumë se çdo gjë përveç tyre, ta do një njeri vetëm për hirë të All-llahut dhe të urrejtë të kthehet në kufër (mosbesim) ashtu sikurse urrenë të hedhet në zjar”. (Buhariu dhe Muslimi).

2- Të fitojë dashurinë e All-llahut ndaj tij.

Kjo dashuri pa dyshim i sjell dobi edhe në dynja edhe në ahiret, sepse prej dobisë së dynjasë është përhapja e pranimit në ruzullin tokësor, pasi që kur ta do All-llahu një njeri i përhapet pranimi i tij në ruzullin tokësor, siç tregohet në një hadith tjetër.

3- Fitimin e besimit.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Pasha Ate në Dorë të të Cilit është shpirti im nuk do të hyni në xhennet derisa nuk besoni, e nuk do të besoni derisa nuk duheni mes vehte. A t’ju tregoj një gjë, të cilën nëse e veproni, do të duheni mes vehte: përhapje selamin mes jush”. (Muslimi).

4- Plotësimin e besimit.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Kush do ndokend për hirë të All-llahut dhe e urren tjetrin për hirë të All-llahut, kush jep për hirë të All-llahut dhe kush nuk i jep tjetrit për hirë të All-llahut, ai ka plotësuar besimin”. (sahih, Ebu Davudi).

5- Ndhimesa në adhurime.

Njeriu në praninë e vëllezërve gjenë ndihmesë në adhurime, e largojnë nga mëkatet, e kjo pa dyshim se sjell fryte në jetën e kësaj jete dhe të ahiretit.

6- Përmirësim të moralit.

Sepse në këtë mënyrë mer shembull vëllezërit e tij të devotshëm, të cilët kanë moral të mirë, kurse nëse kanë moral të mirë, fiton edhe në jetën e kësaj bote edhe të ahiretit.

Mjafton që të fitojë nderim prej njerëzve në dynja dhe pozitë të lartë në ahiret.

7- Zbatimi i nocioneve islamike dhe veçorive e vrytyteve të larta, të cilat nuk mund të realizohen ndryshe përpos në xhemat, siç është altruzimi, etj.

8- Frytet në këtë botë sikurse janë:

Përfitimi nga vëllau në kryerjen e nevojave, përfitimi nga autoriteti i tij, përfitimi nga pasuria me të cilën të ndihmon ose të jep borxh, etj. Ndenja e shoqërisë dhe rehatisë, zgjërimi i gjoksit, lehtësimi i dhimbjeve dhe brengave, sepse shoqërohesh me njerëz të lehtë dhe të dashur. Pastaj përfiton nga konsultimi me vëllaun tënd, etj.

Vërejtje për katër gjëra të rëndësishme

1- Kjo vëllezëri, të cilën e kërkojmë, duhet të jetë e sinqertë për hirë të All-llahut, subhanehu ve teal.

Nëse mungon ky kusht, atëherë nuk mundet të jetë vëllezëri islame. Ky raport i cili nuk është për hirë të All-llahut, në ditën e Kijameetit mund të shndërrohet në armiqësi, siç tregon All-llahu, subhanehu ve teal në Kur’an:

“Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të sinqertë në miqësi”. (Ez-Zuhruf: 67).

2- Njerëzit janë lloje lloje, shoqërohen me ata që janë të përafërt me ta.

Ndodh që një njeri mos ta shoqëron tjetrin edhe pse ky i dyti është i mirë dhe i devotshëm, kjo asesi nuk domethënë se e urren, jo. Por e do aq sa ka besim. Mirëpo ndoshta me tjetrin është më i afërt, sepse është i përafërt me te në mendime, sjellje dhe shije. Për këtë muslimani duhet ta edukon vetvene në përputhje me dashurinë e All-llahut, subhanehu ve teal.

3- Duro në shoqërimin e të zgjedhurve dhe mos dil nga harku i burrave të mirë.

4- Asnjëher nuk mundesh të gleshë njeri të plot.

Të gjithë ne gabojmë dhe të gjithë ne kemi të meta, e nëse kërkon vëlla që ska të meta, atëherë ti nuk mund të gjesh shok, mirëpo kërko mesataren, hulumto shok që të metat dhe gabimet e tija humben në mesin e grumbullit të madh të të mirave dhe se këto të meta nuk mund të ndikojnë te ti.

Cilësitë e kërkuara

Vëllaun të cilin don ta bësh shok duhet t'i posedojë disa cilësi, prej cilësive më të rëndësishme që duhet ti posedon ai janë:

1- Të jetë besimtar.

Sepse njeriu është në fenë e shokut të vet, andaj duhet të kujdeset cilin e ban shok. Për këtë ka ardhur në hadithin e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

“Mos shoqëro askend tjetër përveç besimtarit dhe mos të ha ushqimin tënd askush tjetër përveç njeriut të devotshëm”. (sahih, Ebu Davudi dhe të tjerët).

2- Të jetë i kapur për rregullat e fesë.

Të zbaton urdhërat e All-llahut dhe të largohet nga ndalesat e Tija, ashtu siç na ka mësuar All-llahu, subhanehu ve teala duke thënë:

“Përkufizojë veten tënde me ata që lusin Zotin e tyre mëngjes e mbrëmje, e që kanë për qëllim kënaqësinë (razinë) e Tij, dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre e të kërkosh bukurinë e kësaj bote dhe mos iu bind atij që ia kemi shmangur zemrën e tij prej përkujtimit ndaj Nesh dhe i është dhënë epshit të vet, pse puna e tij ka mbaruar”. (El-Kehf: 28).

Dhe:

“...e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë, ...”. (Lukman: 15).

3- Të jetë i mençur.

Sepse ahmaku më shumë të ban dëm se sa dobi. Më herët kanë thënë:

“Armiku i mençur është më i mirë se miku ahmak”.

4- Të posedon sjellje të mirë.

Sepse ti do të shpeshosh kontaktet dhe takimet me te, e nëse është me moral të keq të dëmton dhe nuk duron në shoqërimin tënd, madje ndoshta edhe ti përvehtëson diçka nga sjellja e tij e keqe.

5- Të ndan me ty ndjenjat e vëllezërisë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem në hadithin e tij ka thënë:

“Shpirtërat janë sikur ushtarët e renditur, ato që njihen bashkohen, e ato që nuk njihen largohen”. (Buhariu dhe Muslimi).

Nëse ngushtohet kur ti shkon te ai, nëse nuk gëzohet me ardhjen tënde, nëse të refuzon, ikë prej teje, nuk shfaq interesim dhe dashuri për ty, ky njeri nuk meriton të shoqërohesh me te. Për këtë mjafton vëllezëria e përgjithshme islame, kurse vëllezëria e veçantë, nuk mund të realizohet me këtë lloj njeriu.

Mjetet që ndihmojnë në realizimin e vëllezërisë

1- Ta lajmërosh se e do.

Ti tregosh vëllaut tënd se e do është sunnet i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

“Nëse një njeri e do vëllaun e tij le ti tregoj se e do”. (sahih, Ebu Davudi dhe të tjerët).

Pastaj ka sqaruar edhe shkaku e lajmërit duke thënë:

“Nëse dikush prej jush e do vëllaun e tij për hirë të All-llahut, le ti tregon se kjo e vazhdon dashurinë dhe e vazhdon afërsinë”. (hasen, Ibn Ebi dunja).

2- Forcim i raporteve me All-llahun, subhanehu ve teala.

Dhe veprimi për të arritur dashurinë e All-llahut, subhanehu ve teala, sepse All-llahu kur e do një njeri:

“E thërret Xhibrilin e thotë: All-llahu e do filani, doje edhe tij. Atëherë e do Xhibrili. Thërret Xhibrili banorët e qiellit: All-llahu e do filanin, edhe ju ta doni, atëherë e dojnë

edhe banorët e qiellit, e pastaj i përhapet pranimi në ruzullin tokësor”. (Buhariu dhe Muslimi).

Nëse të do All-llahu, të dojnë edhe njerëzit, prej tyre është edhe ky vëlla të cilin dëshiron ta shoqërosh.

3- Njohja e fryteve të vëllezërisë për hirë të All-llahut.

Nëse i mëson frytet e kësaj bote dhe të ahiretit të cilat i fiton njeriu me vëllezëri, atëherë vepron për ti realizuar dhe për t'i përforcuar ato.

4- Njohja e jetës së parardhësve tanë të devotshëm (selefus-Salih) dhe si ka qenë vëllezëria mes tyre.

5- Kujdesi për të drejtat e vëllezërisë, kjo e shton vëllezërinë dhe e largon nga veprimet që e dëmtojnë ate.

Të drejtat dhe detyrat ndaj vëllezërve

Baza mbi të cilën mbështeten raportet vëllazore është tia duash vëllaut tënd, ate që ia do vetvetes, siç na ka treguar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem:

“Nuk beson askush prej jush derisa nuk ia do vëllaut të vet atë që ia do vetvetes”. (Buhariu dhe Muslimi).

Nëse muslimani raportet e veta me vëllau e tij i bazon në këtë hadith, pa dyshim se të gjitha obligimet që ia kanë mes tyre do të zbatohen.

Obligimet e muslimanit ndaj vëllaut të vet mundën të jenë të përgjithshme dhe të veçanta.

Prej këtyre obligimeve dhe edukatës janë edhe këto:

1- Gjashtë obligimet e përgjithshme dhe të përmendura në hadithin e njohur:

“Obligimet e muslimanit përball muslimanit janë gjashtë: kur ta takosh t'i japish selam, kur të thërret, t'i përgjigjesh, e kur të kërkon këshillë, ti japish këshillë, e kur të teshtisë e ta falënderon All-llahun, t'i përgji-

gjesh (duke i thënë jerhamukall-llah), kur të sëmuret ta vizitosh dhe kur të vdes tia pasosh xhenazen”. (Buhariu dhe Muslimi).

2- Largimi nga mendimi i keq, spionimi, zilia, hulumtimi, urrejtja dhe ikja njëri prej tjetrit. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

“Ruhuni nga paragjykimet, sepse paragjykimet janë biseda më e rrejshme, mos përgjoni bisedat e tjerëve, mos spiononi, mos keni zili mes vehte, mos ikni njëri prej tjetrit, mos urreni njëri tjetrin, e bëheni, ju robërit e All-llahut, vëllezër”. (Buhariu dhe Muslimi).

3- Ikja nga zullumi, tradhtia dhe nënçmimi i vëllezërve.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Muslimani është vëlla i muslimanit, nuk i ban zullum dhe nuk e dorëzon...”. (Buhariu).

4- Përsëritja për dore kur ta takon.

“Dy musliman që takohen dhe përsëriten mes tyre për dore, u falen mëkatet para se të ndahen”. (sahih, Ebu Davudi dhe të tjerët).

Shikoni se sa vlerë të madhe ka kjo vepër mirëpo ne përsëri e neghlizojmë këtë vepër.

5- Buzëqeshja në fytyrën e vëllaut.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Mos nënçmoni asnjë vepër të mirë, edhe në qoftëse është ta takosh vëllau tënd me fytyrë të buzëqeshur”. (Muslimi).

6- Mos të jetë smirak ndaj vëllaut të vet.

7- Ti ban vend në ndejë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Njeriu nuk e ngrit njeriun nga vendi, në të cilin është i ulur, mirëpo zgjëroni dhe lironi vend”. (Muslimi).

8- T'ia mbrosh nderin.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Kush ia mbron vëllaut të vet nderin, All-llahu ia mbron fytyrën nga zjari i xheheneimit”. (sahih, Tirmidhiu, etj).

9- Ta thërrasish me emrat e tij të dashur.

Omeri, radijall-llahu anhu thotë:

“Tre gjëra ta pastrojnë dashurinë e vëllaut tënd: ti japish selam kur ta takosh, t’i bësh vend në tubim dhe ta thërrasish me emrat më të dashur për te”.

10- T’i ndihmosh me pasuri kur ka nevojë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Kush ka deve shtesë, le t’ia jep atij që nuk ka deve, kurse kush ka ushqim tepër, le ti jep atij që nuk ka”. (Muslimi).

11- Të punon për nevojat e tija dhe të vepron në shërbim të tij.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Kush vepron për nevojat e vëllaut të vet, All-llahu vepron për nevojën e tij...”. (Buhariu dhe Muslimi).

Disa selef kushtëzonin që gjatë udhëtimeve me vëllezërit e tyre, që ai të jetë në shërbim të tyre.

Imam Gazaliu thotë:

“Obligimi i dytë prej obligimeve të vëllezërisë. Ti ndihmosh personalisht në kryerjen e nevojave të tija... Nevoja e vëllaut tënd duhet të jetë sikurse nevoja yte, ose më e rëndësishme se nevoja yte. Të kujdesesh për momentet e nevojës dhe mos të jesh i shkujdesur për gjendjen e tij, ashtu sikurse nuk je i shkujdesur për gjendjen tënde. Ta sjellish në pozitë që mos të ketë nevojë për pyetje dhe të tregoj nevojën për ndihmë. Ti kryejsh nevojat e tija sikurse të mos të dish se i ke kryer ato nevoja, mos të pretendosh se kë merita pse e ke bërë këtë gjest, madje e falënderon për pranimin e mundit tënd për te dhe zbatimin e urdhërit të tij. Nuk duhet të mjaftohesh vetëm me kryerjen e nevojës, por të përiqesh që në fillim me shtesë në nderim dhe altruizëm...”. (Ihja Ullumud-Din, 2/ 162).

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Njerëzit më të dashur te All-llahu janë ata që janë më të dobishëm për njerëzit. Prej veprat më të dashura te All-llahu është futja e gëzimit në zemrën e muslimanit, ose ia largon një

brengë, ose ia lanë borxhin, ose largon prej tij urinë, të eci në nevojën e vëllaut tim është më e dashur për mua se sa të bëjë itikaf në këtë xhami (në Medinë) një muaj. Ai që pengon hidhërimin e tij, All-llahu i ambulon të metat, kush përmban veteveten në mllef, edhe pse ka mundësi ta realizojë, All-llahu ia mbush zemrën në ditën e Kijametit. Ai që ecë në nevojën e vëllaut të vet, derisa t’ia kryen, All-llahu ia forcon këmbët në ditën kur rrëshqasin këmbët, dijeni se morali i keq i prish veprat sikurse e prish uthulla mjaltën”. (Sahih, Es-sahiha, 906).

Abdull-llah ibn Othmani, hoxha i Imam Buhariut thotë: “Secili që ka kërkuar ndonjë nevojë prej meje, ia kam kryer vet, nëse jo, atëherë me pasurinë time, nëse jo, atëherë ndihmoeshim me vëllezërit, e nëse jo, atëherë ndihmoeshim me sulltanin”. (Adab Sherije, 2/ 180).

12- Mos t’ia përmend të mirat që ua ban.

Nëse ua ban ndonjë të mirë, i ndihmon me pasuri, vepron për nevojat e tij ose në shërbim të tij, nuk duhet tua përmend këto të mira, përndryshe u asgjësohet kjo e mirë.

All-llahu, subhanehu ve teala thotë:

“O ju që besuat, mos i prishni lëmoshat tuaja me të krenuar e me ofendim...”. (el-Bekare: 264).

13- Ta falënderon për të mirat që ia bën, qoftë ndihmë materiale, ose shërbim.

Muslimani e falënderon secilin vëlla që i bën ndonjë të mirë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Ai që nuk i falënderon njerëzit nuk e falënderon as All-llahun”. (sahih, Tirmidhiu).

14- Vizita për hirë të All-llahut.

“E meritojnë dashurinë Time ata që duhen për hirë Timen, e meritojnë dashurinë Time ata që vizitohen për hirë Timen, e meritojnë dashurinë Time ata që dhurohen mes vehte për hirë Timen dhe e meritojnë dashurinë Time ata që kujdesen për njëri tjetrin për hirë Timen”. (Sahih, Ahmedi dhe të tjerët).

Pa dyshim se gjatë vizitave duhet pasur kujdes për edukatën e vizitës. Nuk duhet vizituar në kohë të papërshtatshëm, vizitat nuk duhen të jenë të shpeshta, vizitat nuk duhet të shkaktojnë humbjen e kohës, etj.

15- Shpenzimi për vëllezërit, dhënia ushqim kur vinë në vizitë ose kur takohet me te në ndonjë vend.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Dinari më i mirë të cilin e shpenzon njeriu është dinari, të cilin e shpenzon për familjen e tij, dinarin, të cilin e shpenzon për mjetin e tij bartës për rrugë të Zotit dhe dinarin që e shpenzon për shokët e tij në rrugë të Zotit”. (Muslimi).

16- Mosngarkesa e vetes dhe të tjerëve.

Nëse të viziton një vëlla, mos u ngarko për te, ose po e vizitove mos e ngarko, mos kërkko prej tij gjëra që e ngarkojnë, por prej tij kërkko që mos të ngarkohet, kjo sdo të thojë që mos të të nderon, sepse nderimi është diçka, kurse ngarkimi është diçka tjetër.

17- Mosthyerja e premtimi për takim.

Nëse caktoni mes jush ndonjë takim, kujdesu që të jesh preciz në këtë takim, sepse thyerja e premtimit për takim, qoftë me mospjesmarje ose me pjesmarje me vonesë, e ngushton vëllaun tënd.

18- Të kemi sjellje të mirë me te.

Sjellja mes jush duhet të jetë e bazuar në moral të lartë, secili prej jush duhet të duron tjetrin, mes jush të ketë modesti, butësi, vërtetësi, turp, buzëqeshje gjatë takimit, etj.

19- Fshehja e sekreteve dhe mbulimi i të metave.

Pasiqë do të jeni të afërt dhe do të jetoni bashk, patjetër të njihni sekretet e njëri tjetrit, ose do të shihni të metat e njëri tjetrit. Andaj prej obligimeve të vëllezërisë është që të mbash sekretin, tia mbulosh të metat dhe ta ndihmosh në përmirësimin e tij.

Imam Gazaliu thotë:

“Të hesht sekretet që ia ka treguar, të cilat nuk ia tregojnë asnjëher tjetërkujt, madje edhe shokëve më të ngushtë. Mos t’i shpall këto sekrete edhe në qoftë ndahen dhe hidhërohen mes vehte, sepse kjo do të ishte sjellje jofisnike dhe fëlliqësirë e brendshme. Të heshtë nga ofendimi i atyreve që i do, familjes dhe fëmijëve të tij dhe të hesht nga ofendimet që ia kanë bërë të tjerët atij...”. (Ihja, 2/ 162).

20- Altruizmi.

Muslimani duhet t’i jep përparësi vëllaut të vet.

All-llahu, subhanehu ve teala na tregon në Kur'an e na thotë:

“...madje edhe sikur të kishin vetë nevojë për te, ata u jepnin përparësi atyre para vetes. Kush është i ruajtur prej lakmisë së vet, të tillët janë të shpëtuar”. (El-Hashr: 9).

I jep përparësi në vend dhe e ulë në vend të përshtatshëm, në të cilin vend, ndoshta, ti dëshiron të ulesh, i jep përparësi para vebes në ushqim dhe pije, etj.

21- Të participosh në ndjenjat e tija.

Të gëzohesh kur gëzohet ai, të mërzhites kur mërzhitet ai. Nëse i bjer ndonjë fatëkeqësi të nxitosh që t’i dalish në ndihmë, të mundohesh t’ia lehtësosh vështirësinë e kësaj ndodhie, kurse nëse i ndodh ndonjë ndodhi e gëzuar, të nxitosh që t’ia urosh, të shfaqish gëzimin dhe lumturinë tënde me këtë rast.

22- Ti drejtohesh me fjalë të buta dhe të urta.

23- Mos ta ndërresh gjatë bisedës së tij.

Kur flet vëllau yt, duhet ta ndëgjosh, të shfaqish interesim për ate që thotë, e mos të ndërhysh e tia ndërpresish muhabetin.

24- Ta lavdërosh me ate që e meriton.

Mirëpo me kusht që kjo lavdratë mos të jetë para syve, sepse lavdrata para syve e dëmton njeriun, sikurse thot Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem është therrje.

Lavdrata e tij në mesin e njerëzve tjerë, tregon dashurinë që ke për te. Pastaj ky

veprim e shton edhe më shumë dashurinë dhe e zgjatë atë më shumë.

25- Tia sjell lavdratat dhe mirënjohjet e njerëzve për te.

Normalisht se ky veprim nuk duhet të ndikojë që këtë njeri ta kaplojë vetmburrja dhe vetpëlqimi. Me këtë veprim i tregon pozitën që ka njeriu në shoqëri dhe se njerëzit e respektojnë mundin dhe kontributin e tij.

26- Mos t'i sjell qortimin dhe akuzat e njerëzve për te.

Sepse këto lajme ia prishin zemrën dhe e çrehatojnë. Mirëpo nëse këto qortime dhe akuza kanë bazë, atëherë duhet të veprojnë që tia largojë këto të meta me fjalë të buta dhe me këshilla të urta.

27- Ta këshillojmë.

Pa marë parasysh se a është në raste kur ka mangësi në adhurime ose kur ban mëkatet. I ofron këshillë dhe përpiqet që t'i realizojë rregullat dhe edukatën e këshillës.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë:

“Feja është këshillë. I thamë: për kë? Tha: për All-llahun, Librin e Tij, Pejgamberin e Tij, udhëheqësit e muslimanëve dhe masës së gjërë”. (Muslimi).

Nëse këshilla është e domosdoshme për mbarë muslimanët, mos të flasim për muslimanët e veçantë dhe të dalluar për muslimanin.

28- Të kërkojmë prej tyre të na këshillon

Njeriu nuk mundet t'i shoh të gjitha të metat e veta, nuk i di të gjitha gabimet dhe mëkatet e veta, andaj nëse kërkon këshillë nga vëllau, ai ti tregon gabimet dhe t'i shaplos të metata, me qëllim që të largohesh prej tyre.

Hasan Basriu thotë:

“Njerëzit nga koha e selefit, kur e takonin njëri tjetrin, i thoshin: vëllau im, nuk i shoh të gjitha mëkatet e mia dhe nuk i di të gjitha të metat e mia, andaj nëse shoh të mira prej

meje më ndihmo në to e nëse shoh të këqija më largo prej tyre”.

Kurse Bilal ibn Sadi thotë:

Vëlla i yti është ai që kur çdo herë e takon, ta kujton hisen tënde te All-llahu, ti tregon të metat tuaja. ky vëlla është më i mirë dhe më i dobishëm për ty se sa ai që kur e takon, në dorën tënde e lëshon një dinar”.

29- Ik sa ma shumë nga mospajtimi me te

Sepse dallimi dhe mospajtimi në mendime shkakton urrejtje, e nëse gjindet ndonjëher ndonjë mosmarveshje ose divergjencë, atëherë duhet pasur para sysh rregullat dhe edukatën e divergjencës.

30- Ti pranojmë gabimet dhe rëshqitjet që mund të ndodhin nga vëllau

Sepse njeriu nuk është gabimtar, e ai që kërkon vëlla të pagabueshëm, ai mbetet pa vëlla.

Një njeri iu drejtua Ibn Semakut duke i thënë:

“Nesër do të qortohe mi”. Kurse ky ia ktheu:

“Nesër do të falemi mes vehte”.

Kurse Imam Shafiu [rahimehull-llah] thotë:

“Ai që është vëlla i vërtetë i vëllaut të vet, ia pranon defektet e tia, ia mbush boshllëkun dhe ia fal gabimet”.

31- Mos ta shpeshtojmë qortimin

Qortimi mes vëllezërve është i domosdoshëm, sepse ai që të qorton ta dëshiron të mirën. Mirëpo nuk duhet shpeshtuar atë dhe nuk duhet të bëhet natyrë e jona qortimi i jonë i ndërsjelltë, saqë çdo herë që takojmë vëllaun tonë ta qortojmë dhe akuzojmë. Kjo vepër shkakton largim dhe përçarje mes dy vëllezërve.

32- Prano arsyetimin e vëllaut

Nëse një vëlla kërkon falje, falja, nëse një vëlla arsyetohet për gabimin e bërë, prano arsyetimin e tij. Madje edhe nëse nuk ka kërkuar falje dhe nuk është arsyetuar, mos nxito ta qortoish dhe akuzosh për ndonjë hap ose për ndonjë vepër, sepse nuk e din shkakun i cili e ka shtyrë ta ndërmer atë hap ose ta bëjë atë gabim.

“Kërko arsytetime për vëllaun tënd”.

Pasiqë “All-llahu i pranon arsyetimet e njerëzve dhe për këtë ka dërguar peygamber”, siç na ka treguar Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, në hadithin që e transmeton Buhariu dhe Muslimi, atëherë çka na mbetet neve.

33- Ndhimoi në vepra të mira dhe largoje nga të këqijat

Muslimani duhet ta ketë parollë të vehten “ndihmoni njëri tjetrit në të mirë dhe mos i ndihmoni në të keqe”.

Andaj muslimani i ndihmon vëllaut të vet në të gjitha të mirat, i ndihmon që të mer pjesë në ligjeratë, në të cilën edhe nuk ka shumë qejf të mer pjesë. Mirëpo ti e mer duke i thënë: do të vijë dhe do të mar me veturën time e të marim pjesë në një ders të dobishëm. Ose tia kujtosh se nesër janë ditët e bardha dhe duhet agjëruar ato. Në këtë formë dhe në forma tjera duhet t'i ndihmosh për të mirat.

Gjithashtu duhet ta largosh nga të gjitha veprat që e hidhërojnë All-llahun. Nëse e sheh se do të bëjë mëkat, ndihmoji të largohet prej tij. Kjo është një dobi shumë e madhe prej dobive të vëllezërisë për hirë të All-llahut.

34- Lutu për te në mungesë të tij

Prej kujdesit që duhet të ketë muslimani për vëllaun e tij, është edhe lutja në mospraninë e tij për te.

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem ka thënë:

“Secili musliman që lutet për vëllaun e tij në mosprani, atëherë i thot melaqeja: edhe ty të takoftë e njejtja”. (Muslimi).

35- Mos u ban dyfyrsh

Pejgamberi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem e ka qortuar dyfyrësinë dhe ua ka ndaluar muslimanëve të jenë të tillë, duke thënë:

“Njerëzit më të këqinjë në ditën e Kijame-tit janë dyfyrëshat: njërit i vjen me një fytyrë e tjetrit me fytyrë tjetër”. (Buhariu dhe Muslimi).

36- Mos thirrja e njerëzve me lakabe të urryera

Gjuha shumë herë ka pasoja shumë të rënda, dëmton zemrat, lëndon shpirtin dhe përçan vëllezërit.

Prej gjërave që duhet kujdes shumë për to gjatë vëllezërisë është mos emërtimi i tyre me emra që nuk i pëlqejnë.

All-llahu, subhanehu ve teala në Kur'an na mëson e na thotë:

“...dhe mos etiketoni njëri-tjetrin me lla-gape. Pas besimit është keq të përhapet lla-gapi i keq. E ata që nuk pendohen, janë mi-zorë”. (el-Huxhurat: 11).

Kurse musliman është ai, nga dora dhe gjuha e të cilit janë rehat muslimanët, siç ka treguar Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

37- Largohu prej gjërave që e dëmtojnë vëllezërinë

Për këto gjëra do të flasim në dersin e ardhshëm në mënyrë detale.

Bekir Halimi,

12.9.2003

Disa rregulla për muajin Shaban

Shaban është emër i muajit, kështu është emërtuar sepse arabët shpërndaheshin për të kërkuar ujë, ose sipas disave për shkak të shpërndarjes nëpër shpella, e sipas të tretëve për shkak se gjindet mes muajit Rexheb dhe Ramazan. Shumësi i këtij emri është Shabanat ose Sheabiin.

Agjërimi në muajin Shaban

Aisheja, radijall-llahu anha, thotë: "Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, agjëronte sa që mendonim se aspak nuk është duke ngrënë, dhe nuk agjëronte sa që thonim se aspak nuk agjëronte. Nuk e kam parë Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, duke agjëruar një muaj të plotë përveç Ramazanit, kurse më së shumti e kam parë duke agjëruar në muajin Shaban". (Buhariu dhe Muslimi). Në transmetimin tjetër të Muslimit qëndron: "E agjëronte gjithë Shabanin, përveç një pjesës së vogël".

Një grup i dijetarëve, prej tyre është edhe Abdull-llah ibën Mubareku, kanë anuar nga mendimi se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurrë nuk e ka plotësuar muajin e Shabanit me agjërim, por e ka agjëruar pjesën më të madhe. Këtë mendim e përforcon hadithi të cilin e transmeton Muslimi nga Aisheja, radijall-llahu anha, ku thotë: "Nuk di se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka agjëruar muaj të plotë përveç Ramazanit", ose në transmetimin tjetër: "nuk e kam parë duke agjëruar një muaj të plotë prej ditës që ka ardhur në Medinë, në përjashtim të Ramazanit".

Kurse Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, thotë: "Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve

sel-lem, nuk ka agjëruar asnjë muaj të plotë përveç Ramazanit". (Buhariu dhe Muslimi). Andaj Ibën Abbasi, radijall-llahu anhu, urrënte të agjëroj në muaj të plotë përveç Ramazanit.

Ibën Haxheri, rahimehull-llah, thotë: "Agjërimi i tij vullnetar ishte më i shumtë në muajin e Shabanit sesa në muajt tjerë. Ai agjëronte pjesën më të madhe të Shabanit".

Usame ibën Zejdi, radijall-llahu anhu, thotë: i thashë Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: të shoh që më së shumti je duke e agjëruar muajin e Shabanit? Mu përgjeggj: ky është muaji që njerëzit e neglizhohen, sepse gjindet mes Rexhebit dhe Ramazanit. Ky është muaji që ngriten veprat te Zoti i botëve, kurse unë dëshiroj që të më ngriten veprat duke qenë agjërueshëm". (Transmeton Nesaiu. Shiko: "Sahihut-Tergibi vet-Terhibi", të Shejh Albanit, rahimehull-llah, fq. 425). Kurse në transmetimin e Ebu Davudit, Aisheja, radijall-llahu anha, thotë: "Muaji më i dashur për ta agjëruar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte muaji Shaban, pastaj e vazhdonte me muajin Ramazan". (Shejh Albani, rahimehull-llah, thotë se ky hadith është i vërtetë. Shiko: "Sahih Sunen Ebi Davud", 2/461).

Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, thotë: "agjërimi i muajit Shaban është më i vlefshëm se agjërimi i muajve të shenjtë, kurse agjërimi më i mirë vullnetar është ai që është më afër Ramazanit, qoftë para ose mbrapa, ashtu sikurse namazet vullnetare me farzet, ato që falen para edhe ato që fa-

len mbrapa, domethënë i plotësojnë mangësitë e farzeve. E njëjta gjë vlen edhe për agjërimin. Pastaj ashtu sikurse që sunetet e rregullta janë më të vlefshme sesa namazi vullnetar, ashtu edhe agjërimi para Ramazanit dhe pas është më i mirë sesa ai që është më larg.

Fjala e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Shabani është muaj që e neglizhojnë njerëzit sepse gjindet mes Rexhebit dhe Ramazanit", domethënë se pasiqë kufizohet me dy muaj të mëdhenj, muaji i shenjtë dhe muaji i agjërimin, njerëzit angazhohen nga ky muaj, andaj bëhet i neglizhuar. Shumica e njerëzve mendojnë se agjërimi i Rexhebit është më i vlefshëm se agjërimi i muajit Shaban, sepse muaji Rexheb është muaji i shenjtë, mirëpo kjo nuk është e saktë.

Në hadithin e lartpërmendur tregohet se mundet disa kohëra, vende ose persona të njihen si më të vlefshëm edhe pse gjinden kohëra, vende ose persona që janë më te vlefshëm se to.

Në këtë hadith gjithashtu ka argument se është e pëlqyeshme që të shfrytëzohen me ibadet kohërat që i neglizhojnë njerëzit. Për këtë disa nga selefi (muslimanët e parë) e shfrytëzonin kohën mes Jacisë dhe Akshamit me ibadet, sepse shumica e njerëzve janë neglizhent nga ibadeti në këtë kohë. E njejta vlen edhe për përmendjen e All-llahut, subhanehu ve teala, në treg, sepse e përmedin All-llahun në vend të neglizhencës dhe mes neglizhentëve. Të shfrytëzosh me ibadete kohën që zakonisht njerëzit e neglizhojnë, ka shumë dobi, prej tyre janë:

- Më lehtë e ke ta fshehish këtë ibadet, kurse te veprat vullnetare fshehja e tyre është më e mirë. Sidomos agjërimi, i cili është ibadet i fshehur mes robit dhe Zotit të vet, për këtë edhe është thënë se në te nuk ka mundësi të ketë rija, syfaqësi. Ka pasur

njerëz nga selefi që kanë agjëruar me vite, askush nuk e ka ditur. Kur ka dalur nga shtëpia për në treg ka marur me vehte bukën, rrugës i jepte ato sadaka, kurse ai vet agjëronte. Kështu, familja e tij mendonte se ka ngrënë bukën, kurse njerëzit e tregut mendoni se ka ngrënë në shtëpi. Për këtë, selefi e kanë pëlqyer për ate që agjëron që të tregon gjëra me të cilat do ta fshehë agjërimin e tij. Abdull-llah ibën Mesudi, radijall-llahu anhu, thotë: "nëse agjëroni, përdorni vajra (në fytyrë dhe flokë)". Kurse Kadtadeja, rahimehull-llah, thotë: "është e pëlqyer për agjëruarin që të përdorë vajra, që të largon nga vetja pluhurin e agjërimin".

- Veprat e mira në kohën e neglizhencës janë të rënda për nefsin, kurse prej shkaqeve që një vepër e bëjnë më të vlefshme, është vështirësi e tyre për nefsin, sepse kur një vepër e bëjnë shumë njerëz, atëherë është ma e lehtë, kurse nëse e neglizhojnë një vepër shumica e njerëzve, atëherë u bëhet e rëndë të zgjuarve. Transmeton Imam Muslimi nga Ma'kel ibën Jesari, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ibadeti në kohën e fitnes është sikur të bësh hixhret tek Unë". Sepse në këtë kohë njerëzit i pasojnë epshet e tyre, andaj ai që kapet për të vërtetën është duke bërë një vepër të rëndë.

Dijetarët kanë shumë mendime për shkakun e agjërimin të shumtë të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, në muajin Shaban, prej tyre janë edhe këto mendime:

1- Nuk mundej t'i agjëronte çdo herë nga tre ditë të çdo muajit për shkak të udhëtimit, andaj të gjitha këto i kompenzonte në muajin Shaban. Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur e bënte ndonjë vepër vullnetare e vazhdonte, e nëse i kalonte e kompenzonte.

2- Disa kanë thënë: gratë e tija, i kompenzonin ditët e mbetura nga Ramazani i kaluar

në muajin Shaban, edhe ai agjëronte me to. Kjo është në kundërshtim me atë që e thon-te Aisheja, radijall-llahu anha, e cila e vononte kompenzimin e agjërimin të ditëve të mbetura nga Ramazani deri në Shaban, sepse ishte e angazhuar me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

3- Disa të tjerë kanë thënë: sepse është muaji që shumica e njerëzve e neglizhojnë. Ky është mendimi më i saktë, duke u mbështetur në hadithin e Usame ibën Zejdit që e përmendëm pak më lartë.

Nëse i kishin mbetur Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ditë të paagjëruara nga agjërimi vullnetar, i kompenzonte në muajin Shaban që të plotësonte nafilet e tija para se të hyjë Ramazani, ashtu sikurse kur i kalonte sunneti i ndonjë namazi ose diç nga namazi i natës, e kompenzonte, kurse Aisheja, radijall-llahu anha, e shfrytëzonte kompenzimin e tij që edhe ajo të kompenzonte ditët e mbetura nga muaji i Ramazanit të kaluar, sepse në kohët tjera ka qenë e angazhuar me Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Në këtë rast duhet tua tërheqim vërejtjen se atij që i ka mbetur diç pa agjëruar nga muaji i kaluar i Ramazanit, duhet ta kompenzojë para se të hyjë muaji i ardhshëm i Ramazanit dhe nuk i lejohet ta vonojë, përveç se me ndonjë arsye. Ai që ka mundësi ta kompenzon para Ramazanit të ardhshëm dhe nuk e ka bërë, përveç kompenzimit duhet bërë teube dhe për çdo ditë duhet yshqyer nga një të varfur. Ky është mendim i Malikut, Shafiut dhe Ahmedit.

Prej dobive të agjërimin të muajit Shaban është se agjërimi i këtij muaji e stërvitë njeriun para ardhjes së agjërimin të muajit Ramazan, që mos ti vjen i rëndë agjërimi i muajit Ramazan, por i vjen muaji i Ramazani, kurse ky është i pregaditur dhe aktiv.

Pasiqë muaji Shaban është si parathënie e muajit Ramazan, atëherë edhe ky muaj duhet të ketë disa gjëra që i ka muaji i Ramazanit, siç është agjërimi, leximi i Kur'anit dhe dhënia e sadakasë. Seleme ibën Suhejli thoshte: Muaji i Shabanit është muaj i lexuesve të Kur'anit".

Edhe Habib ibën Ebi Thabit kur hynte muaji Shaban thoshte: ky është muaji i lexuesve të Kur'anit. Kurse Amr ibën Kajs el-Mulai kur hynte muaji i Shabanit, e mbyllte dyqanin e tij dhe lirohej nga angazhimet tjera për të lexuar Kur'an.

Agjërimi në fund të Shabanit

Tregon Ebu Hurejreja, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Mos agjëroni para Ramazanit një ose dy ditë, përveç atij që ka agjëruar ditë të zakonshme". (Buhariu dhe Muslimi)

Sipas argumenteve që i kemi në disponim agjërimi para muajit Ramazan i ka tri situata:

a) Të agjëron me nijet që mos të gabon fillimin e muajit Ramazan, kjo është haram.

b) Të agjëron me nijet të zotimit, ose kompenzimit, etj, kjo është e lejuar sipas shumicës së dijetarëve, dhe

c) Të agjëron me nijet të agjërimin vullnetar, nëse e ka pasur traditë t'i agjëron ato ditë, siç është e hëna dhe e enjtja, atëherë i agjëron, përndryshe jo.

Nëse ndokush thotë: pse urrehet të agjërohen ditët para muajit Ramazan, si përgjigje mund të themi, se kjo është kështu për shumë aspekte:

1- Për mos t'i shtuar muajit të Ramazanit ditë që nuk janë të tij. Për këtë shkak është i ndaluar edhe agjërimi i ditës së bajramit, që mos të bëjnë muslimanët siç kanë bërë pasuesit e librave, të cilët kanë shtuar sipas mendimeve dhe epsheve të tyre. Për këtë edhe ka ndaluar Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, agjërimin e ditës së dyshimtë.

2- Për të ndarë agjërimin vullnetar nga ai obligativ, edhe kjo është një gjë e ligjshme. Për këtë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka ndaluar ngjitjen e namazit obligativ me atë vullnetar pa i ndarë ato me selam ose fjalë, si-domos sunnetet para namazit të sabahut.

Ndokush mund të mendojë se ngrënia para Ramazanit ka për qëllim ngopjen me ushqim dhe ngopjen e epsheve para se ta ndalon nga ushqimi me agjërim, por kjo është gabim dhe injorancë, nëse ndokush kështu ka menduar.

Referenca:

1- "Lataiful-Mearif fima limevasimil-Ami minel-Vedhaifi", të Ibën Rexheb Hanbeliut.

2- "El-Ilamamu bishejin min ahkamis-Sijami", Abdul-Azizi Raxhihi.

Përpiloi: Bekir Halimi

3.10.2003

Festimi i natës së gjysëm muajit shaban

Falënderojmë All-llahun, i Cili na e ka plotësuar fenë, na i ka plotësuar dhuntitë, kurse paqja dhe bekimi qofshin mbi Pejgamberin, Muhammed, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, Pejgamberi i mëshirës dhe teubes.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Sot përsosa për ju fenë tuaj, plotësova ndaj jush dhuntinë Time, zgjodha për ju islamin fe". (El-Maide: 3).

"A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fé, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu?". (Esh-Shura: 21).

Transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Aisheja, radijall-llahu anha, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kush shpikë në fenë tonë gjëra që s'janë prej saj, kjo vepër është e refuzuar".

Transmeton Xhabiri, radijall-llahu anhu, se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, gjatë hutbes së tij thoshte: "Biseda më e mirë është, Libri i All-llahut e udhëzimi më i mirë është udhëzimi i Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kurse gjërat më të këqija janë ato të shpikurat, kurse çdo bidat është delalet". (Muslimi).

Shumë ajete dhe hadithe flasin në këtë drejtim.

Të gjitha këto argumente në mënyrë të qartë tregojnë se All-llahu, subhanehu ve teala, e ka plotësuar këtë fe, ua ka plotësuar dhuntitë, e nuk është ndalur Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, derisa e ka kumtuar fenë plotësisht dhe i ka sqaruar ummetit të gjitha gjërat që i ka caktuar shërijati, qofshin fjalë ose vepra dhe ka sqaruar se çdo gjë që e shpikin njerëzit pas tij dhe ia mveshin islamit, qofshin fjalë ose vepra, të gjitha këto janë të refuzuara, edhe po të jenë me qëllim të mirë. Këtë gjë e kanë kuptuar mirë shokët e Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, edhe dijetarët pas tyre. Ata ua kanë tërëhjekur vërejtjen muslimanëve prej bidateve dhe i kanë mohuar. Këto gjëra i ka përmendur secili që ka shkruar vepra që flasin mbi madhërimin e sunnetit dhe mohimin e bidateve, siç është Ibën Veddahi, Ibën Shame, Tartushi, etj.

Prej bidateve që i kanë shpikur njerëzit është edhe festimi i natës së gjysmë muajit shabana (nata e beratit), duke e veçuar

këtë ditë me agjërim, duke mos pasur për këtë argument në të cilin mundet të mbësh-tetemi. Mbi vlerën e kësaj dite ekzistojnë disa hadithe, mirëpo janë të dobëta, kurse sa i përket namazit në këtë ditë, të gjitha janë apokrifë, siç e kanë treguar këtë shumë dijetarë. Disa prej tyre do t'i përmendim pak më poshtë.

Sipas mendimit të shumicës së dijetarëve festimi i kësaj dite është bidat dhe se hadithet që flasin për këtë ditë janë të dobëta, e disa janë edhe apokrifë. Prej dijetarëve që e kanë treguar këtë gjë është edhe Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, në librin "Letaiful-Mearif". Sipas disave ka mundësi të punohet me hadith të dobët, mirëpo nëse për këtë vepër ka bazë të shëndoshë në hadithet e vërteta, kurse për këtë ditë nuk ka bazë të shëndoshë, që ta forcojmë me hadith të dobët. Këtë rregull e ka sqaruar shumë mirë Shejhul-Islam, Ibën Tejmiu, rahimehull-llah.

Të gjithë dijetarët janë të pajtimit se nëse muslimanët kanë mendime të ndryshme për ndonjë çështje, duhet kthyer në Kur'an dhe Sunnet, e çka të gjykojnë ato, ose njëri prej tyre, ajo është sherijat dhe fe që duhet ta pasojmë, kurse ajo që është në kundërshtim me te duhet refuzuar. Nëse për ndonjë ibadet nuk ka bazë në Kur'an dhe Sunnet, atëherë është bidat të cilin nuk lejohet ta bëjmë, e mos të flasim për davet në te ose t'i nxisim njerëzit në këtë vepër. All-llahu, subhanehu ve teala, thotë:

"Nëse nuk pajtoheni për ndonjë çështje, atëherë parashtrojeni atë te All-llahu (te libri i Tij) dhe te i dërguari, po qe se i besoni All-llahut dhe ditës së fundit. Kjo është më e dobishmja dhe përfundimi më i mirë". (En-Nisa: 59).

"A mos kanë ata ortakë (zota ose idhuj) që u përcaktuan atyre fé, të cilën nuk e urdhëroi All-llahu?". (Esh-Shura: 21).

"Thuaj: Nëse e doni All-llahun, atëherë ejani pas meje që All-llahu t'ju dojë, t'ju falë mëkatet tuaja, se All-llahu është që fal shumë, mëshiron shumë". (Ali Imran: 31).

"Për Zotin tënd jo, ata nuk janë besimtarë (të asaj që të zbriti ty as të asaj para teje) derisa të mos zgjedhin ty për të gjykuar në atë konflikt mes tyre, e pastaj (pas gjykimit tënd) të mos ndiejnë pakënaqësi nga gjykimi yt dhe (derisa) të mos binden sinqerisht". (En-Nisa: 65).

Ka shumë ajete që flasin në këtë drejtim dhe janë vendimtare se gjatë mendimeve të ndryshme duhet kthyer në Kur'an dhe Sunnet, dhe se duhet kënaqur me këtë gjykim, dhe se kjo është argument i imanit të një besimtari dhe e mirë për robin në dunja dhe ahiret.

Hafidh Ibën Rexhebi, rahimehull-llah, në librin e tij, "Letaiful-Mearif", thotë: "Namazi gjatë natës së gjysmëmuajit shaban nuk ka bazë nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e as nga shokët e tij".

Kurse çdo gjë që nuk ka bazë në argumente të shëndosha nuk i lejohet muslimanit ta shpikë në fe, pa marë para sysh a është duke e bërë vet ose në grup, pa marë para sysh a e bënë publikisht ose e fshehë, duke u bazuar në përgjithshmërinë e fjalës së Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: "Kush shpikë në fenë tonë gjëra që s'janë prej saj, kjo vepër është e refuzuar".

Dhe shumë argumente tjera që flasin në këtë drejtim.

Imam Ebu Bekr Tartushi në librin e tij, "Shpikjet dhe bidatet", thotë: "transmetohet nga Ibën Vedahi, e ky nga Zejd ibën Eslemi, i cili ka thënë: asnjë hoxhë i yni e as fukarëtë tonë nuk i kanë dhënë asnjëfar vlere gjysmëmuajit shaban, nuk e kanë zënë gjë hadithin e Mekhulit, nuk e kanë konsideruar natë me vlerë. Kur Ibën Ebi Melikjea e ka dëgjuar njërin duke thënë: fulani thotë se nata e Be-

ratit ka vlera sa nata e Kadrit, ia ktheu: po ta ndëgjoja do ta goditja me shkop”.

Shevkaniu, rahimehull-llah, në librin e tij, “Dobi të përmbledhura”, thotë: “Hadithi që fletë për namazin e natës së gjysmëmuajit shaban është i trilluar”. E në disa libra tjerë ka thënë se është i kotë, i pa bazë, i dobët etj.

Disa dijetarë janë mashtruar me këto hadithe, siç është rasti me Ebu Hamid Gazalin dhe disa dijetarë të tefsirit.

Hafidh Iraku thotë: Hadithi që flet për namazin në natën e gjysmëmuajit shaban është i trilluar mbi Pejgamberin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe është gënjeshtër mbi te”.

Imam Neveviu thotë: “Namazi i Regaibit dhe namazi i natës së gjysmëmuajit shaban janë bidate dhe nuk duhet të mashtrohet ndokush nga fakti se janë të përmendura në librin “Kutul-Kulub”, ose “lhaju ulumud-din”, e as nga hadithet që janë përmendur atje, sepse krejt ato janë të kota, e as me shkrimet e disa dijetarëve që u është përzier kjo çështje, sepse ata kanë gabuar në këtë rast”.

Shejhu Ebu Muhammed, Abdur-Rahman ibën Ismail El-Makdisiu ka shkruar libër shumë të vlefshëm mbi këtë temë, ku ka vërtetuar kotësinë e saj në mënyrë të zgjerruar dhe të mirë. Dijetarët kanë folur shumë rreth kësaj teme, po të dëshironim t'i përmendim do ta zgjatnim shumë. Mirëpo kjo që kemi përmendur, mendojmë se mjafton për ate që e kërkon të vërtetën.

Ajetet, hadithet dhe fjalët e dijetarëve që i përmendëm më lart i sqarojnë kërkuesit të së vërtetës se: festimi i natës së gjysmëmuajit shaban, me namaz ose gjëra tjera, veçimi i ditës së saj me agjërim, është bidat i urrejtur sipas shumicës së dijetarëve dhe nuk ka bazë në sherijatin e pastërt, e cila ka dalur pas shekujve të sahabeve, radijall-llahu anhum.

Në këtë kontekst kërkuesit të së vërtetës i mjafton ajeti: “Sot përsosa për ju fenë tuaj..”. Dhe ajetet tjera që flasin në këtë drejtim.

Edhe hadithi: “Kush shpikë në fenë tonë gjëra që s'janë prej saj, kjo vepër është e refuzuar”.

Imam Muslimi transmeton nga Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, i cili thotë se Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

“Mos e veçoni natën e xhuma me namaz të veçantë, e as ditën e saj me agjërim të veçantë, në përjashtim të rastit kur ju takon në agjërim të zakonshëm”.

Po të ishte e lejuar të veçohet ndonjë natë me agjërim, atëherë nata më meritore do të ishte nata e xhuma, sepse dita e saj është dita më e mirë në të cilën ka lindur dielli, sipas haditheve të Pejgamberit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Pasiqë Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ua ka tërhequr vërejtjen nga veçimi i natës së xhuma me namaz të veçantë, kjo tregon se veçimi i ndonjë nate tjetër edhe më parë është i ndaluar, në përjashtim të ndonjë rastit kur është veçuar me hadith të vërtetë.

Pasiqë sipas sherijatit është e ligjshme namazi i natës gjatë ramazanit dhe natës së Kadrit, Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ua ka treguar ummetit dhe i ka nxitur në te, bile edhe vet i ka bërë.

Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: “Kush falet gjatë netëve të Ramazanit, me besim dhe shpresim të shpërblimit, i falen mëkatet e mëparshme”. (Buhariu dhe Muslimi).

“Kush e falë Natën e Kadrit me besim dhe shpresim të shpërblimit, i falen mëkatet që i ka bërë më parë”. (Buhariu dhe Muslimi).

Kështu që, po të ishte nata e gjysmëmuajit shaban dhe nata e parë e xhumasë së parë të Rexhebit, ose nata e Israsë dhe Miraxhit e ligjshme veçimi i tyre me festim ose me ndonjë ibadet të veçantë, do t'ua tre-

gonte Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, këtë mbarë ummetit ose do ta bënte vetë, po të ndodhte diç e tillë, këtë do të na e tregonin sahabet e tij e nuk do të na e fshehnin, sepse ata kanë qenë njerëzit që më së shumti kanë këshilluar, pas Pejgamberëve. All-llahu qoftë i kënaqur prej tyre.

Pak më parë treguam fjalët e dijetarëve se për këtë gjë nuk ka asnjë hadith të vërtetë nga Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, e as nga sahabet e tij,, radijall-llahu anhum, as për natën e Regaibit e as për natën e Beratit, atëherë na bëhet e qartë se festimi i kësaj nate

është bidat, gjë e shpikur në Islam edhe veçimi me ibadet të veçantë është bidat. Kjo vlenë edhe për natën e Israsë dhe Miraxhit.

Sa mirë thotë poeti:

Gjërat më të mira janë udhëzimet e para

Kurse më të këqijat janë ato të shpikurat

E lusim All-llahun që t'i udhëzoj mbarë muslimanët që të kapen për Sunnet dhe të përqëndrohen në te dhe të kujdesen prej bidateve dhe gjërave që i kundërshtohen. Paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, dhe mbi shokët e tij në përgjithësi.

Ibën Baz,

Marrë nga "Përmbledhja e fetvave" të shejh Ibën Baz, rahimehull-llah, v. 2/882.

10.10.2003

Një çështje e fikhut mbi mjekësinë, faljen dhe mbështetjen tek Allahu

Mbi autoritetin e Usame ibn Shuraik transmetohet që Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ishte pyetur nga një beduin, "A ta përdorim mjekësinë?" Ai, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Po përdoreni mjekësinë, o robër të All-llahut. Sepse vërtetë All-llahu nuk ka vendosur mbi ne një sëmundje dhe Ai të mos ketë dhënë një shërim për të, përveç për një sëmundje - moshën e vjetër." [Autentik, Ahmed dhe Tirmidhiu]

Kuptimi "a ta përdorim mjekësinë" është marrja për çdo trajtim mjekësor. Kuptimi i "kurës" është çdo trajtim ose shërim nga Mëshira e Allahut.

Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka përmendur rëndësinë e të kujdesurit për trupin, derisa Islami është feja e balancës: përmban një balancë midis nevojave të trupit dhe nevojave të shpirtit.

Nevojat e shpirtit janë të përkufizuara me Akide dhe Teuhid dhe një shfaqje të natyreshme të veprave të adhurimit të dyja si ato të detyrueshmet dhe vullnetaret.

Nevojat e trupit janë të përkufizuara me ushqim dhe pije, me veshje rrobash dhe jetesës në një banesë të këndshme, dhe marrja e trajtimeve mjekësore dhe kështu në vazhdim.

Në këtë hadith Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka drejtuar në rrugë të drejtë me fjalët e tij: "Po, përdoreni mjekësinë për të gjitha sëmundjet sepse Allahu është më i Madhëruari. Ai nuk ka zbritur një sëmundje e të mos ketë zbritur me të edhe shërimin bashkë me të."

Megjithatë, Ai ia la njerëzve për të kërkuar shërimin. Ata sigurisht do t'i gjejnë ato nëse përpiqen për të bërë kështu.

Kjo është një mënyrë për t'i sprovuar ata. Prandaj është e nevojshme për të kërkuar

shërim për çdo sëmundje që bjen mbi njerëzimin.

Një numër i gjërave të urta mund të mësohen nga ky hadith:

-Ligjshmëria, sipas Islamit të përdorimit të mjekësisë dhe kërkimit për kurat për çdo sëmundje të njohura nga njeriu.

-Mjekësia e derivuar nga ajo që është e ndaluar nga Allahu, siç është vera [pjetet alkoolike], derri dhe gjëra të tilla që nuk janë të lejuara.

-Hadithi tregon fuqinë e All-llahut dhe Madhësitinë e Tij derisa një sëmundje qoftë e re apo e vjetër nuk ekziston në këtë botë por All-llahu ka dhënë shërimin për të. Si rrjedhojë, dobësia dhe inferioriteti i njerëzimit qëndron kur ata dështojnë në kërkimet shkencore të cilat do t'i lejonin atyre për të nxjerrur shërim mjekësor për çdo sëmundje të dhënë. Ky dështim ka ndodhur për shkak të zënies së njerëzimit në garimin me armë dhe ndryshimit të shumave të parave.

-Thuhet se nuk ekziston shërim për sëmundjen e Sida-s, herpes-it, alkoolizmit dhe kancerit.

Kjo nuk është korrekte. Shërimi ekziston. Di-sa mund ta dinë dhe disa janë injorant për të.

All-llahu fsheh atë çfarë ata kërkojnë, për arsyt e Tij dhe ndoshta Ai mund t'ua jap atyre për arsye të tjera.

Një çështje e cila duhet konsideruar

Të kuptuarit të këtij hadithit me hadithet e tjera që ndalojnë ose nuk aprovojnë trajtimet mjekësore për muslimanët - të tillë si hadithi i 70.000 personave të cilët do të hyjnë në Parajsë pa gjykim ose dënim që është për ata që nuk besojnë në nuska, por i mbështeten vetëm All-llahut subhane ve te'ala. A e refuzon trajtimi mjekësor mbështetjen tek Allahu?

Mjekësia nuk e refuzon mbështetjen tek Allahu.

Ebu Khozana ka thënë: "O Profet i Allahut, recitimet që ne përdorim dhe mjekimet që ne i bëjmë a ndryshojnë ato diçka që është e përcaktuar nga Allahu?"

Ai, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ato janë nga përcaktimi i Allahut"

Të marrin një kurë do të thotë si të reduktojnë urinë me ushqim dhe etjen me pije. Dhe në pjesën më të madhe ia del me Madhësitinë e All-llahut.

Nëse mjekësia është e lejuar në themele dhe nëse fakti ligjor gjithashtu e tregon këtë atëherë hadithi i mësipërm duhet të kuptohet se do të thotë:

Si i përket recitimeve ata nuk kanë recituar me një dua të ndaluar nga All-llahu ose me ato të cilat nuk kanë baza në Kur'an dhe Sunnetit.

Nëse ata do të sëmureshin do të vraponin tek recitimet e ligjshme të përmendura në Kur'an dhe Sunnet. Lejimi i recitimeve ishte vendosur kur Resulullahu, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, ka thënë:

"Asnjë recitim nuk është i lejuar përveç syrit ose kafshimeve helmuese [të gjarprit] dhe të akrepit"

Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, i ka lexuar recitimet mbi veten e tij dhe Xhibrili, Engjulli gjithashtu ka recituar mbi të. Aisheja pasi që Profeti, sal-lall-llahu alejhi ve sel-leme, urdhëroi atë të kërkonte mbrojtje nga syri (përmes recitimeve) ka thënë:

"Unë kam kërkuar mbrojtje për Profetin, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, nga syri dhe vendosa dorën time në gjoksin e tij dhe e fërkova atë dhe thashë:

"Largoje dhimbjen, O Zot I njeriut, kura është nga dora Yte dhe nuk ka shërim përveç shërimit Tënd."

Dr. Fahd El-Usaimi,

17.10.2003

Dispozita e Sheriatit mbi ata që kanë vdekur para se të dërgohet Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ose para se të ju vjen feja

Dijetarët e selefiteve i largoheshin diskutimit për çështjen e dispozitës mbi fëmijët e mushrikëve dhe njerëzit që kanë jetuar në kohën mes dy Pejgamberëve (Ehlul Fetre). Këtë qëndrim ata e bazonin në fjalën e Ibën Abbasit, radijall-llahu anhu, që disa ia mveshin Resulullahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem: 'Është e këtij ummeti nuk do të del prej binarit të duhur përderisa nuk fillohet të flitet për fëmijët dhe kaderin. (d.m.th. për dispozitat e tyre)

Kur Ibën Mubareku dëgjoi këtë fjalë të Ibën Abbasit tha: A thua vallë duhet që njeriu duhet të heshtë kur ballafaqohet me injorancë? Të pranishmit e pyetën: A po na urdhëron që të flasim? Ibën Mubareku heshti dhe nuk u përgjigj.

Kur Rebi'atu Er-Re'ji foli për fëmijët e mushrikëve Kasim ibën Muhammedi tha: Nëse All-llahu nuk ka folur për një gjë as ju mos folni për të dhe ndaluni. Transmetuesi tha: Sikur ishte zjarrë i cili u fik me këtë fjalë.

Ata të cilët e kanë ndaluar zhytjen në këto mesele kanë pasur parasysh paqartësinë e këtyrë çështjeve dhe çdo herë kur një gjë është e paqartë bëhet obligim kapja për Ixmanë (konsensuzin e dijetarëve) të Ehli Sunnetit, për këtë shkak Ibën Kajjimi duke e komentuar fjalën e Ibën Abbasit, radijall-llahu anhu ka thënë: Në përgjithësi ky qortim vlen për ata që flasin pa dituri ose kundërshton disa hadithe me hadithe në kohë që ai i cili flet me dituri dhe kërkon të vërtetën nuk qortohet.

Dispozita e sheriatit mbi ata që kanë vdekur para se të dërgohet Muhammedi, sal-

lallahu alejhi ve sel-lem, ose para se t'ju vjen feja. Këto njerëz quhen Ehlul Fetre që kanë jetuar në kohën mes dy Pejgamberëve as që kanë arritur të hyn në thirrjen e të parit e as që kanë arritur kohën e Pejgamberit pas tij.

All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: O ithtarë të librit, ju erdhi i dërguari i Jonë, ju sqaroi (çështjet e fesë) pas ndërprerjes së të dërguarve, në mënyrë që të mos thoni: "Neve nuk na erdhi as i dërguar që të na përgëzojë, e as që të na tërheqë vërejtjen" (El Maide 19). Kohëzgjatja mes Isaut [alejhi selam] dhe Muhammedit [sal-lallahu alejhi ve sel-leme] ka qenë 600 vjet siç na njofton Buhariu në Sahihun e tij.

Prej Ehlul Fetre ka njerëz që kanë dëgjuar për thirrjen e Pejgamberit para tij dhe ka besuar në të siç është rasti me El Kiss ibën Sa'ide dhe Zejd ibën Amër ibën Nufejl i cili ka qenë prej ithtarëve të teuhidit dhe për këtë pajtohen gjithë dijetarët.

Bejhakui me sened sahih tansmeton rastin e Zejdit i cili duke qenë i mbështetur në murrin e Qabës ka thënë: Sot nuk ka mbetur askush përpos meje në fenë e Ibrahimit [alejhi selam]. Thoshte: Zoti im është Zoti i Ibrahimit, alejhi selam. Për të i Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-leme, ka thënë: Do të ringjallet i vetëm si popull mes meje dhe Isaut, alejhi selam. Këto pa dyshim janë besimtarë dhe do të hyjnë në xhennet. Lloji i dytë janë njerëz që u ka ardhur thirrja e Pejgamberit dhe nuk kanë besuar në të si Amër ibën Luhajj el Huzai për të cilin i dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-leme, ka thënë: E kam Amër ibën Amir ibën Luhajj El

Huzaiun si i tërheq zvarrë zorët e tij në zjarr ishte i pari që shpiku Saïben (adhurim i kotë në kohën e injorancës kur i lëshonin devete e tyre pa përkujdesje në shkretëtirë për shkak plotesimit të zotimit). Transmetuan Buhariu dhe Muslimi.

Për ata tek të cilët nuk kanë ardhur thirrjet e Pejgamberëve ka dy mendime të dijetarëve:

1) Ata do të janë në zjarr. Ku është mendimi i Mu'tezilive dhe mendimi i disa Maturidive që i përkasin medh-hebit Hanefij. Argumentet e tyre janë:

Ajetet që flasin për dënimin me zjarr e gjitha njerëzve që nuk kanë besuar siç janë:

“Nuk është pendim (i pranueshëm) i atyre që vazhdimisht bëjnë punë të këqia dhe vetëm atëherë kur t'i vjen vdekja ndonjërit prej tyre, të thotë: "Unë tash u pendova!" e as i atyre që vdesin duke qenë jobesimtarë. Ndaj tyre kemi përgatitur dënim të ashpër”. (En-Nisa, 18)

“Ata që nuk besuan dhe vdiqën si mosbesimtarë, asnjërit prej tyre nuk do t'i pranohet për kompensim, qoftë edhe plotë faqen e dheut ari”. (Ali Imran, 91)

“Ata, të cilët mohuan dhe vdiqën si pabesimtarë, kundër tyre është mallkimi i All-llahut, i engjëjve dhe i të gjithë njerëzve. Ata përgjithmonë janë aty (në zjarr), as nuk u lehtësohet dënimi, as nuk u jepet afat”. (El Bekare, 161-162)

“S'ka dyshim se All-llahu nuk falë (mëkatin) t'i përshkruhet Atij shok (idhujtarinë), e përpos këtij (mëkati) i falë kujt do”. (En-Nisa, 48)

Kundër-argumenti: Këto janë argumente të përgjithshme të cilat janë përkufizuar me ajetin: “E Ne nuk dënuam askë para se t'ia dërgojmë të dërguarin”. (El Isra, 15) dhe me argumente tjera që do t'i cekim më vonë.

Hadithi të cilin e transmeton Ebu Hurejre, radijall-llahu anhu, prej të Dërguarit, sal-llallahu alejhi ve sel-leme: Kërkova prej All-llahut që të më lejoni të kërkoj falje për nënën

time dhe nuk më lejoi, kërkova leje që të vizitoj varrin e saj dhe këtë ma lejoi. Transmeton Muslimi.

Nga ky hadith ata potencuan faktin se po të mos ishte nëna e Pejgamberit, sal-llallahu alejhi ve sel-leme (e cila bën pjesë në Ehlul Fetre) në zjarr do t'i lejohej që të kërkon falje për të.

Hadithi të cilin e transmeton Enesi, radijall-llahu anhu: Një njeri pyeti të Dërguarin e All-llahut, sal-llallahu alejhi ve sel-leme: O Resulall-llahu ku është i ati im? I ati im dhe i yti janë në zjarrë. Transmeton Muslimi. Nga ky hadith ata potencuan faktin se i Dërguari i All-llahut ka pohuar hyrjen në zjarr për njerëz që i përkasin Ehlul Fetres.

Si kundër-argument themi: Ka mundësi që këta persona të kenë dëgjuar për thirrjen e Pejgamberëve dhe pastaj nuk kanë besuar ashtu që hyn nën hukmin e mohuesve që do të hyjnë në zjarr. Kjo mundësi është akoma më e madhë për ata njerëz që janë marrë me tregti dhe udhëtime të shumta. Pjesa tjetër mbetet nën hukmin e përgjithshëm të Ehlul Fetre e paraqitur në ajetin: “E Ne nuk dënuam askë para se t'ia dërgojmë të dërguarin”

2) Mendimi i dytë: Këto njerëz do të shpëtojnë prej dënimit me zjarr (d.m.th. nuk do të hyjnë në zjarr me mosbesimtarët). Ky është mendimi i xhumhurit, katër Imamët, shumë prej selefit, është mendimi i Esh'ariut, Ibën Tejmijjës, Ibën Kajjimit. Ibën Kethirit, Ibën Haxherit dhe shumë tjerë.

Argumentet e tyre janë:

Ajeti: “E Ne nuk dënuam askë para se t'ia dërgojmë të dërguarin” nga i cili kuptuam se dënimi i ndonjë popullit është i kushtëzuar me ardhjen e të Dërguarëve

Ajeti: “Të dërguar që ishin lajmgëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para All-llahut”. (En Nisa 165)

Ajeti: "Sa herë që hidhet në të ndonjë turmë, roja i pyet: "A nuk ju pat ardhur juve ndonjë pejgamber (qortues)?" Ata thonë: "Po, na erdhi pejgamberi, por ne e përgënjeshtruam dhe ne u thamë: "All-llahu nuk shpalli asgjë, e ju nuk jeni tjetër vetëm se në një humbje të madhe!" (El Mulk 8-9)

Ajeti: "O grumbull i xhinve dhe i njerëzve! A nuk ju erdhën nga mesi juaj të dërguar t'ju rrëfejnë argumentet e Mia dhe t'ju tërheqin vërejtjen për takimin tuaj në këtë ditë? Ata thonë: "Dëshmojmë kundër vetvetes". (El En'am 130)

Ajeti: "O ithtarë të librit, ju erdhi i dërguari i Jonë, ju sqaron (çështjet e fesë) pas ndërprerjes së të dërguarve, në mënyrë që të mos thoni: "Neve nuk na erdhi as i dërguar që të na përgëzojë, e as që të na tërheqë vërejtjen". (El Maide, 19)

Hadithi: Ubadete ibën Samit, radijall-llahu anhu, tregon se i Dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-leme, ka thënë: Ashkush nuk e don arësyeën aq sa e don All-llahu, subhanehu ve teala. Për këtë ai i dërgoi Të dërguarit lajm gëzues dhe kërcënues. Transmetuan Buhariu dhe Muslimi

Ithtarët e këtij mendimi pastaj janë ndarë në lidhje me pyetjen a do të sprovohen ata ditën e gjykimit që të vërtetohet besimi i tyre e pastaj ai që ka respektuar urdhërin e All-llahut do të shpëton, ndërsa ai që ka mohuar do të denohet me jobesimtarët.

Shkaku i kësaj divergjenceje në mendime është hadithi të cilin e ka transmetuar Esved ibën Seri': Ditën e gjykimit i shurdhëri do të thotë: O Zot erdhi Islami në kohë që unë nuk kisha mundësi të dëgjoj asgjë. I prapambeturi (idioti, teveqeli) do të thotë: O Zot erdhi

Islami në kohë që fëmijët luashin me mua (isha i paaftë të kuptoj fenë). I plaku do të thotë: O Zot erdhi Islami në kohë kur unë nuk isha i vetëdijshëm për asgjë. Njeriu që ka jetuar në kohë kur nuk ka pasur Pejgamber do të thotë: Nuk më erdhi i dërguar prej teje. All-llahu do të merr zotimet prej tyre pastaj do të dërgoi kush do t'i urdhëron me hyrje në zjarr. I dërguari i All-llahut, sal-lallahu alejhi ve sel-leme, tha: Pasha All-llahun në dorën e të Cilit shpirti im nëse hyjnë në të do të bëhet i ftohtë dhe shpëtim për të. Transmetoi Ahmed

Disa prej dijetarëve kanë refuzuar këtë hadith duke e vlerësuar si të dobët për dy shkaqe:

- Në të ka obligim të krijesës me atë që është e pamundshme të bëhet Hyrja në zjarr
- Senedi i këtij hadithi është i dobët për shkak të disa transmetueve në këtë sened

Edhe hadithet tjerë që flasin për këtë temë janë të dobët dhe nuk mundën të mirren si përforsim i hadithit në fjalë.

Kësaj mundemi të ja shtojmë faktin se rregull i përgjithshëm i fesë Islame është që kjo botë është vendi i sprovës kurse ahireti është vendi i dënimit apo shpërblimit. Sipas kësaj me i saktë është mendimi i dytë por pa shtojcën se këta njerëz do të vihen në provë ditën e gjykimit. All-llahu e di më së miri.

Shënim i përkthyesit:

Sipas Albanit senedi i hadithit është i saktë (shih Silsiletul Ehadith Es-Sahih nr. 1434). Kështu mendimi i atyre që thojnë se do të sprovohen ditën e gjykimit për mendimin e tyre kanë fjalë të Dërguarit për çështjen në fjalë. All-llahu e di më së miri.

Dr. Abdul Aziz ibën Ahmed El Buxhadi

Marrë nga: www.islamtoday.net

Përktheu dhe përshtati: Talha Kurtishi,

24.10.2003

Mirësia ndaj prindërve

"Ai i cili dëshiron që furnizimi i tij të shtohet dhe jeta t'i zgjatet le të mbajë marrëdhënie të mira me të afërmit" [Sahih el-Buhari]

Ai i cili është i dhëmbshur dhe dashamirës drejt të afërmeve të tij fiton të paktën dy gjëra në këtë botë përkrah shpërblimit në tjetrën. Këto dy avantazhe janë shtimi i furnizimit të tij dhe jetëgjatësisë së tij. Shtimi në furnizim do të thotë që Allahu do ta shtojë cilësinë e të mirave të kësaj bote ose mënyrat e tij të furnizimit të tij do të jenë bekimi nga Ai. I njëjtë është rasti me jetëgjatësinë. Jeta e një personi të tillë ose është e shtuar (me numrin e viteve) ose jeta e tij është e hijeshuar nga bekimet e Allahut. Të dyja interpretimet janë të sakta. (shih Rijad us Salihin)

Prindërit janë një bekim nga Allahu, subhanehu ve teala, por prezenca e tyre është marrë nëpërkëmbë edhe të drejtat e tyre janë të neglizhuara veçanërisht kur ata bëhen të plakur dhe bëhen të varur prej fëmijëve të tyre. Të folurit me ashpërsi dhe pa respekt prindërve dhe shfaqja e pakënaqësisë kur ata kërkojnë diçka është bërë e modës. Kurse islami mëson t'i bindemi dhe të jemi të këndshëm me prindërit, duke i përmbushur të drejtat e tyre duke mbrojtur nderin e tyre dhe na ka paralajmëruar kundër neglizhimit të të drejtave të prindërve. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: "... keni frikë Allahun që me emrin e Tij përbetoheni, ruajeni farefisnin (akraballëkun), se All-llahu është mbikëqyrës mbi ju.... ". [en-Nisa: 4: 1]

Ebu Hurejrah, radijallahu anhu, ka transmetuar se i Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Allahu i ka krijuar të gjitha krijesat dhe kur ai ka mbaruar krijimin e tij, Er-Raham (mitra) ka thënë: "(O Allah) në këtë vend unë kërkoj mbrojtje me Ty nga të gjithë ata të cilët më veçojnë mua (i shkëpusin lidhjet). Allahu ka thënë: "Po. A je e kënaqur që unë do të dënoj atë që i shkëput lidhjet me ty. Ajo ka thënë: "Unë jam e kënaqur". Allahu ka thënë: "Kjo të është garantuar ty". Pastaj i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Recito versin nëse ju dëshironi: "E ju pastaj nëse ju jepet autoritet do bëni ç'rregullim në tokë dhe t'i shkëputni lidhjet farefisnore? Të tillët janë ata që Allahu i ka mallkuar..... ". [Sahih el-Buhari dhe Sahih Muslim]

Imam Ahmedi ka regjistruar nga Abdullah Ibën Amër, radijallahu anhu, që i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Mitra do të vendoset në ditën e ringjalljes në formë të lakuar si një cikrik tjerrëses duke folur me një gjuhë të rrjedhshme duke thirrur për t'i këputur lidhjet me atë që i ka këputur lidhjet dhe duke u lidhur (lidhjet farefisnore) me ata që i kanë mbajtur të lidhura (lidhjet farefisnore)". [Musnad Ahmad: 2: 189]

Këto hadithe tregojnë rëndësinë e trajtimit të mirë të të afërmeve sepse kjo është një mënyrë e veçantë për të arritur mëshirën e Allahut. Një sjellje e kundërt me të - neglizhimi i të drejtave të të afërmeve është një shkak për pakënaqësinë dhe dënimin e Allahut.

Kështu mbajtja e lidhjeve familjare është e obligueshme dhe për më tepër kur është një lidhje e mitrës. I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, na ka paralajmëruar kundër sjelljes së keqe kundrejt prindërve kur ai ka thënë: "Tre vepra do të bëjnë veprat e një personi të pavlefshme; shoqërimi i të tjetërve me Allahun, Ukuk (pandëgjueshmëria dhe sjellje e vrazhdtë) kundrejt prindërve dhe dezertimi nga lufta". [Et-Tabarani]

El-Hasan el-Basri ka thënë: "Vrulli (i bindjes) drejt prindërve përfshinë bindjen ndaj urdhërave të tyre përveç kur ata urdhërojnë diçka që shpie në mosbindje ndaj Allahut. Në të kundërt Ukuk përfshin neglizhimin e prindërve dhe mbajtjen e këndshmërisë me ta". [Ad-Durr el-Manthut, vol. 5, faqe 259]

Ibën Abbas, radijallahu anhu, ka thënë: "Allahu hap dy dyer (të Parajsës) për çdo musliman i cili është i dhënë pas dy prindërve të tij musliman duke pritur shpërblimin e Allahut të Vetëm dhe një derë nëse ai (ose ajo) ka një prind të gjallë (dhe që kujdeset për të). Më tepër nëse dikush e zemëron një nga prindërit e tij atëherë Allahu nuk do të jetë i kënaqur me të derisa prindërit e tij ta falin". Ai është pyetur: "Edhe nëse ata janë të padrejtë ndaj fëmijës së tyre?" Ai ka thënë: "Edhe nëse ata janë të padrejtë". [El-Bejhaki]

Ai i cili përmbush detyrat e tij ndaj prindërve të tij ka zgjedhur një rrugë për në Parajsë dhe ai i cili ka neglizhuar detyrat e tij drejt prindërve të tij është me të vërtetë i privuar nga një mundësi e madhe për të hyrë në Parajsë sepse bindja dhe nderimi i prindërve është një mënyrë për të hyrë në Parajsë. Ebu Hurejrah ka transmetuar që Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Qoftë ai i poshtëruar! Qoftë ai i poshtëruar! Qoftë ai i poshtëruar". I është thënë: "Kush o i dërguar i Allahut?" Ai ka thënë: "...Personi prindërit e

të cilit, njëri apo të dy ata arrijnë moshën e thyer gjatë jetëgjatësisë së tij e ai nuk hyn në Parajsë (nëse nuk i shërben atyre)". [Sahih Muslimi 4627]

Shërbimi ndaj prindërve është esencial në çdo nivel të jetës së tyre nëse ata janë të rinjë ose të moshuar. Por ky hadith përmend moshën e vjetër për arsyen që në atë periudhë të jetës ata janë në nevojë dhe u duhet shërbim më i madh. është një krim i madh të lihen në mëshirën e rrethanave kur ata janë të vjetër, të dobët dhe të varur nga të tjerët për nevojat e tyre. Neglizhimi ndaj tyre në këtë fazë është një mëkat i madh. Ebu Bekrah Nufai Ibën el-Harith ka transmetuar se i dërguari i Allahut ka thënë: "A t'ju informoj për një nga gjynahet më të mëdha?". I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, e përsëriti këtë pyetje tri herë. Ne i thamë: "Po o i dërguar i Allahut. Ai salallahu alejhia ua selam ka thënë: "Për t'i shoqëruar partner me Allahun në adhurim dhe moskujdesi ndaj prindërve... " [muttefekun alejhi]

Një person duhet të gjejë kohë të mjaftueshme për t'u kujdesur për prindërit e tij, t'i shërbejë atyre në nevojat e tyre duke i folur atyre, ti mbështesë ata financiarisht dhe emocionalisht dhe t'i urdhërojë fëmijët e tij që t'i duan ata dhe të qëndrojnë pranë tyre. Koha e kaluar me prindërit është kënaqësi, dëgjimi i historive të tyre, konsultimi me ta për punët e familjes, të kërkuarit këshilla prej tyre, dashuria ndaj tyre dhe shfaqja e kënaqësisë dhe kujdesit duhet të jenë plan-program i tij. Si mund që kjo të quhet barrë ose e vështirë kur ata janë personat më të dashur të zemrës, streha që ai gjen rehati kur ai është i trishtuar dhe i dëshpëruar.

Islami jo vetëm që urdhëron për bindje ndaj prindërve besimtarë por gjithashtu ngulmon në lidhje të këndshme edhe me prindërit pabesimtarë. I transmetuar nga

Asma bint Ebu Bekër: "Nëna ime erdhi të më vizitohet në kohën e të dërguari të Allahut salallahu alehijë ua selamdhe ajo ishte një mushrike (jobesimtare). Unë u konsultova me të dërguarin e Allahut, salallahu alehijë ve sel-lem, duke thënë: "Nëna ime erdhi të më vizitohet mua për disa arsye a duhet t'i mbajë lidhjet e mira me nënën time?". Ai ka thënë: "Po mbajë lidhjet e mira me nënën tënde". [Sahih el-Buhari 2477]

Kjo sepse asnjë fëmijë nuk mund t'i paguajë vështirësitë që i kanë patur prindërit e tij për ta rritur atë. Ibën Umari, radijallahu anhu, ka parë një burrë duke e mbajtur nënën e tij në shpindë për të bërë Tavaf rreth Kabes dhe ai e pyeti Ibën Umarin, radijallahu anhu: "A e kam përmbushur detyrën time drejt saj?" Ibën Umari i është përgjigjur: "As për një marrje! Megjithatë ti ke vepruar mirë dhe Allahu do të ta shpërblejë (me shumë të mirë) për minimumin që mund të bësh". [El-Kabair, faqe 42]

Gjithashtu Zurah Ibën Ibrahim ka thënë që një burrë erdhi tek Omeri, radijallahu anhu, dhe i tha atij: "Unë kam një nënë të plakur e cila është e paaftë edhe për t'i kryer nevojat (personale) kështu që unë e mbaj atë mbi shpinën time. Unë gjithashtu i ndihmojë edhe në abdes, duke e kthyer fytyrën time larg nga ajo (nga respekti). A e kam përmbushur detyrën time ndaj saj". Omeri, radijallahu anhu, ka thënë: "Jo". Njeri ka thënë: Edhe pse e kam mbajtur mbi shpindë dhe jam lodhur në shërbim të saj". Umari, radijallahu anhu, ka thënë: "Ajo ka bërë të njëjtën gjë (kur ti ke qenë i vogël) duke shpresuar që t'i do të jetosh, e ti pret derisa ajo të largohet nga kjo botë (të vdesë)". [Birr-ul-Ulidein nga Ibën Xheuzi]

Respektimi dhe bindja ndaj prindërve është një mënyrë mirëpritjeje për ata. Ibën Abbasi, radijallahu anhu, ka thënë: "Janë tre

verse që janë të shtrënguara mbi tre gjëra dhe ata janë të pa ndashme". Ai përmendi midis tyre versin: "..... më falendero Mua dhe prindërit e tu". [el-Llukman 31: 14] Dhe ai e ka komentuar: "Kushdo që ka falenderuar Allahun por nuk ka qenë i kënaqur me prindërit e tij atëherë (falenderimi ndaj Allahut) nuk do të pranohet nga Allahu. Kjo sepse pejgamberi, salallahu alehijë ve sel-lem, ka thënë: "Zoti është i kënaqur kur kënaqen prindërit dhe Zoti është i zemëruar me atë i cili zemëron prindërit e tij". [Sahih el-Xhami (3500) dhe Silsilah es-Sahihah]

Rëndësia e nderimit dhe e shërbimit të prindërve është gjithashtu e ditur nga verset e sures Llukman ku Allahu përmend këshillën e Llukmanit drejtuar djalit të tij. Ai e këshillon djalin e tij me këndshmëri dhe sjellje të mirë ndaj prindërve përkrah Tevhidit (adhurimit të Allahut të Vetëm).

Siç Allahu, subhanehu ve teala, e përmend në Kur'an : "(përkujtoni) Kur ne morëm zotimin e bijëve të israilit; mos adhuroni tjetërkë, përveç All-llahun, të silleni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmëve, ndaj jetimëve, ndaj të varfërve.....". [el-Bekare 2: 83]

Ibën Kethir rahimahullah ka komentuar mbi kuptimin e këtij ajeti: "Allahu i ka urdhëruar Beni Israilët që ta adhurojnë Atë të Vetëm dhe të mos bashkangjeshin partner askënd ose asgjë në adhurimin e tij. Këtë Ai ia ka urdhëruar të gjithë krijimit të tij, dhe kjo është pse Ai i ka krijuar ata. Me të vërtetë e drejta më e lartë dhe e madhe janë të drejtat e Allahut që askush përveç tij të mos adhurohet. Pas saj vijnë të drejtat e krijimit veçanërisht dhe më të rëndësishmet të drejtat e prindërve. Për shembull Allahu ka thënë: "... më falendero Mua dhe prindërit e tu.." [el-Israh17: 23]

Allahu ka vendosur shpërblim dhe bekime për prindërit në përpjekjet e tyre për t'u për-

pjekur shumë për të mbështetur dhe ndihmuar fëmijët e tyre. E njëjtë me këtë Allahu ka vendosur shpërblimin dhe bekimet për fëmijët që i shërbejnë, i ndihmojnë dhe i sjellin rehati prindërve të tyre. Kab Ibën Uxhrah ka transmetuar: "Një burrë ka kaluar pranë pejgamberit, salallahu alejhi ve sel-lem, dhe sahabet ishin të mahnitur nga ai për përpjekjen dhe ngulshmërinë (për të siguruar jetesën). Ata i thanë: "O i dërguar i Allahut salallahu alejhis ua selam! Po nëse ajo gjallëri të shpenzohej në rrugën e Allahut". I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nëse ai ka dalë për të fituar në mënyrë që të ushqejë fëmijët e tij atëhere ai është në rrugën e Allahut. Nëse ai ka dalë për të fituar për të mbështetur dy prindërit e plakur atëhere ai është në rrugën e Allahut. Nëse ai ka dalë të mbështesë veten dhe të ruajë nderin e tij (duke mos iu lutur njerëzve për para) atëhere ai është në rrugën e Allahut. Nëse ai ka dalë për tu shfaqur dhe nga mendjemadhësia atëhere ai është në rrugën e Shejtanit". [Et-Tabarani]

Allahu gjithashtu i ka lavdëruar pejgamberët, veçanërisht pejgamberin Jahja, alejhis-selam, sepse ai ishte i këndshëm me prindërit e tij në moshë të thyer. Më të vërtetë kjo gjë në kohë nevojë është më e madhe sesa në kohë të tjera. Ka një nevojë të madhe që haset në moshë të thyer dhe një dobësi të tmerrshme që ajo sjellë: "O Jahja, merre librin me shumë kujdes, dhe ashtu Ne i dhamë atij urtësi kur ishte fëmijë. Dhe nga ana jonë i mundësuam të jetë i butë, i pastër dhe respektues (i dëgjueshëm). Edhe i sjellshëm ndaj prindërve të vet, nuk ishte kryelartë e i padëgjueshëm". [el-merjem 19: 14]

Allahu e ka lavdëruar Isan alejhis es-selam sepse ai ishte i dedikuar për t'i shërbyer nënës së tij gjithashtu ai ishte i mëshirshëm ndaj saj. Ai e ka përmendur këtë fakt

kur ai ka thënë: " Më ka bërë të mirësjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë as të padëgjueshëm!". [el-Merjem 19: 32]

Bindja dhe shërbimi ndaj prindërve ishte nga karakteristikat e pejgamberëve.

Kur fëmijët i dedikojnë kohë të mjaftueshme për t'i shërbyer prindërve të tyre për t'iu bindur atyre dhe përmbushur detyrën e tyre drejt tyre, veçanërisht ndaj nënës, ata do të fitojnë kënaqësinë e Allahut dhe hyrjen në Parajsë.

Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, u ngrit në minbar dhe atëhere ai ka thënë: "Amin, Amin, Amin" I është thënë: "O i dërguar i Allahut, Pse the Amin?" Ai, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Xhibrili erdhi tek unë dhe tha: "O Muhammed është i dënuar ai i cili pasi të dëgjon të përmendësh dhe të thotë: "Salavat" Ai ka thënë: "Thuaj Amin". Kështu unë thashë Amin. Atëhere ai tha: "është i dënuar ai i cili shikon muajin e Ramazanit që vjen dhe shkon dhe nuk është i falur (nga Allahu)". Ai tha: "Thuaj Amin". Kështu unë thashë Amin". Pastaj ai tha: "është i dënuar ai i cili rritet dhe të dy prindërit ose njëri janë ende gjallë dhe ata nuk bëhen shkak që të hyjë në Xhennet". Ai tha: "Thuaj Amin". Kështu unë thashë Amin". [Tuhfat el-Ahuadhi 5: 550]

Nëna e meriton të nderohet më shumë sesa babai

Nëna e mban fëmijën nëntë muaj, në dobësi mbi dobësi, bartë vështirësitë e barrës dhe të lindjes, ushqen fëmijën dhe e dedikon veten e saj në shërbim të tij, duke e mbrojtur, mbathur, pastruar etj... Për arsye se nëna e meriton më shumë të nderohet sesa babai dhe më tepër e meriton këndshmërinë, shërbimin dhe bindjen si një kompesim i vogël për kujdesin e saj dhe përpjekjet e saj të qënura si tre herë më shumë nga çfarë

meriton babai. Ebu Hurejrah, radijallahu anhu, transmeton: "Një burrë erdhi tek Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, dhe ka thënë: "O i dërguar i Allahut cili prej njerëzve e meriton më shumë shoqërinë time të mirë?" Ai ka thënë: "Nëna jote". Ai e pyeti: "Po pastaj kush?" Ai pastaj tha: "Nëna jote". Ai e pyeti: "Po pastaj kush?" Ai i ka thënë: "Nëna jote". Ai e pyeti: "Po pastaj kush?" Ai ka thënë: "Pastaj babai yt". [Sahih el-Buhari 4/13 dhe Sahih Muslim 2548]

El Hafidh Ibën Haxhar rahimahullah ka thënë: "Ibën Battal ka thënë çfarë kuptohet këtu është që nëna duhet të nderohet tre herë më shumë sesa babai. Ai ka thënë se kjo është për shkak të vështirësive të barrës, pastaj lindjes, pastaj ushqimit me gji. Këto janë vështirësi që janë të bartuara vetëm nga nëna pastaj babai ndanë me të vështirësitë e rritjes së fëmijës. Kjo është gjithashtu e referuar në versin: "Ne njeriun e kemi urdhëruar për (sjellje të mira ndaj) prindërit të vet, sepse nëna e vet atë e barti me mund pas mudi dhe pas dy viteve ia ndau gjinin. (e porositëm) Të jeshë mirënjohës ndaj Meje dhe ndaj dy prindërve tu, pse vetëm tek Unë është kthimi juaj". [Lukman 31: 14]

Ky hadith gjithashtu nënkupton që në raste ku burri i saj është i varfër dhe nuk është i aftë për ta mbajtur atë atëhere djali duhet të shpenzojë mbi nënën e tij dhe asaj duhet t'i jepet përparësi më shumë sesa babait".

Këndshmëria në shëtitjet me prindërit

Këndshmëria ndaj prindërve gjithashtu përfshin mënyrën sesi ai ecën me ta siç është e treguar në këtë histori, Ebu Ghasan edh-Dhehebi doli jashtë duke ecur përpara babait të tij në Medine dhe Ebu Hurejrah, radijallahu anhu, e ka kapur atë dhe e ka pyetur: "Kush është ky burri që po ecën prapa teje?" Ai tha: "Babai im". Ebu Hurejrah, radi-

jallahu anhu, ka thënë: "Ti ke lënë korrektësinë dhe ke kundërshtuar sunnetin. Mos ec përpara babait tënd, vetëm prapa tij ose në të djathtën e tij dhe mos lë askënd të ju ndajë ty dhe atë (gjatë ecjes). Mos ha asnjë kockë që ka mish në të të cilën babai yt e ka parë sepse ndoshta ai e ka dëshiruar. Mos shiko drejt babait tënd, mos u ul derisa ai të ulet dhe mos fle derisa ai të flejë". [Et-Tabarani]

Llojet e ndryshme të Ukukit drejt prindërve

I Dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, na ka paralajmëruar kundër Ukukit drejt prindërve kur ai ka thënë: "Tre akte do t'i bëjnë veprat të pa vlefshme; të shoqërosh të tjerë me Allahun, Ukuku drejt prindërve dhe dezertimi nga lufta". [Et-Tabarani]

El-Hasan el-Basri ka thënë: "Birr-i ndaj prindërve përfshin bindjen e urdhërave të tyre përveç kur ata të urdhërojnë në mosbindje ndaj Allahut. Ndërsa Ukuku përfshin neglizhimin e prindërve dhe mos mbajtjes së këndshmërisë me ta". [Ed-Durr el-Manthur vol. 5 faqe 259]

1. Shkaktimi i vuajtjes dhe trishtimit ndaj prindërve për shkak të ndonjë fjale ose një vepre

Allahu ka thënë: "Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjallë të mira (të buta respektuese)". [el-Israh 17: 23]

Ed-Dejlani ka transmetuar që el-Husejn Ibën Ali, radijallahu anhu, ka transmetuar se Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nëse do të kishte ndonjë akt të Ukukit më të vogël sesa Uf, Allahu do ta kishte ndaluar atë gjithashtu".

Abdullah Ibën Amr Ibën el-As, radijallahu anhu, na ka transmetuar që një burrë erdhi tek i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, për t'i dhënë atij betimin e aleancës (bejën) duke thënë: "Unë kam ardhur për të dhënë Bej'ah-n time për të kryer Hixhrën (emigrimin në Medine). Megjithatë unë lashë prapa prindërit e mi ndërsa ata po qanin". Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Atëhere kthehu mbrapa dhe bëji të qeshin ashtu si i ke bërë ata të qajnë". [Musnad Ahmed]

Më tepër Ibën Umari, radijallahu anhu, ka thënë: "Shkaktimi i të qarit ndaj prindërve është pjesë e Ukukut dhe një gjynah i madh". [Sahih el-Buhari]

2. Fyerja ose sharja e prindërve ose sharja e prindërve të dikujt tjetër

I dërguari i Allahut e ka mallkuar atë i cili i fyen prindërit e tij ai, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "I mallkuar është ai që shanë babain e tij, i mallkuar është ai i cili shanë nënën e tij, i mallkuar është kushdo që e therrë (kafshën) në emër të tjetër kujt përveç Allahut, i mallkuar është ai i cili e udhëzon gabim një të verbër në rrugë, i mallkuar është kushdo që bën atë që populli i Nuhit ka bërë". [Sahih el-Xhami 5767]

Dhe ai, salallahu alejhi ve sel-lem, gjithashtu është raportuar të ketë thënë: "Nga gjynahet e mëdha është rrebelimi ndaj prindërve të tij". Ne (as'habët) thamë: "O i dërguar i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, si një njeri i shan prindërit e tij?" Ai ka thënë: "Po, sharja e babait të dikujt është sharje ndaj babait tuaj dhe sharja e nënës së dikujt është sharja e nënës tuaj". [Sahih el-Buhari dhe Sahih Muslim]

Dhe në një tjetër transmetim i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, i është përgjigjur: "Ai që abuzon babain e dikujt tjetër, në kthim ai abuzon vetë (babain e tij) ai

që abuzon nënën e dikujt tjetër, në kthim ai abuzon nënën e tij". [Sahih el-Buhari dhe Sahih Muslim]

Ne mësojmë nga ky hadith që askush nuk duhet të abuzoj prindërit e askujt sepse ai do ta paguaj me të njëjtën gjë dhe ai do të bëhet përgjegjës për ofendimin e vet prindërve të tij.

3. Praktikimi i të keqes përballë prindërve

Askush nuk duhet të sillt keq përballë prindërve me punë të tilla si lënia e namazit, të pijë duhan, të dëgjoj muzikë, të shikoj filma të ndytë ose vepra të tjera amorale. Këto vepra i zemërojnë prindërit e si kjo kur Allahu ka ndaluar madje edhe thënien uf ndaj tyre. Nëse prindërit bien dakord me këto vepra të fëmijës së tyre nga dashuria për ta, atëherë prindërit do të fitojnë vepra të këqija. Fëmija do të veproj keq duke i gënjer prindërit dhe duke i çuar ata në gjynah.

4. Braktisja e prindërve

Enes el-Xhuheni ka thënë që babai i tij ka transmetuar që Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Me të vërtetë në ditën e gjykimit Allahu do të ketë rob që nuk do t'i flasë, as ta pastrojë e as ti shikojë". Ai është pyetur "Kush janë ata o i dërguar i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem?" Ai ka thënë: "Ai i cili i braktisë prindërit e tij, ai i cili braktisë fëmijët e tij dhe ai i cili është bërë një nder nga një njeri por ai e mohon atë nder të tij dhe e braktisë atë". [Musnad Ahmed]

Mos shpenzimi për prindërit e varfër, duke i detyruar ata t'i drejtohen gjykatave që gjykatësi t'i detyrojë pastaj fëmijët të shpenzojnë për ta është gjithashtu një formë e Ukukut. Duhet kujtuar që ai dhe e gjithë pasuria e tij i përket babait të tij siç është e ditur nga hadithi i mëposhtëm;

Një burrë i ka thënë të dërguarit të Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, që ai ka pasuri dhe fëmijë por babai i tij dëshironte të për-

dorë një pjesë të pasurisë së tij. I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, i është përgjigjur: "Ti dhe pasuria jote jeni të babait tënd". [Ibën Maxhah]

5. Preferimi i gruas mbi prindërit

Preferimi i gruas mbi prindërit është gjithashtu pjesë e Ukukut dhe është bërë gjë shumë e përhapur në kohën tonë. Dhe është edhe më e rëndë në raste kur dikush preferon gruan e tij të pabindshme e cila përpiqet në të gjitha mënyrat për ta larguar burrin e saj nga nëna dhe babai i tij.

6. Mos vizitimi i prindërve shpesh

Mos vizitimi i prindërve shpesh dhe mos mbajtja e kontakteve të zakonshme me ta është gjithashtu një lloj i Ukukut. El-Buhari dhe Muslimi ka transmetuar që Ebu Hurejrah, radijallahu anhu, ka thënë që i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Allahu ka krijuar të gjitha krijesat dhe kur Ai mbaroi krijimin e tij, Er-Raham (Lidhja e marrëdhënies nga mitra) ka thënë: "O Allah në këtë vend unë kërkoi mbrojtje me Ty nga të gjithë ata të cilët i presin (marrëdhëniet). Allahu ka thënë: "Po. A je e kënaqur nëse unë do ta dënoj atë që të dënon ty dhe do t'i shkëpus lidhjet me atë që i këput lidhjet me ty. Ajo ka thënë: "Po unë jam e kënaqur". Allahu ka thënë: "të qoftë". Atëhere i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Recitoni versin nëse dëshironi: "A nëse do t'ju jepet autoritet bëni shkatërrime dhe i këpusni marrëdhëniet e këndshme? Të tillë janë ata që Allahu i ka mallkuar..... ". [Sahih el-Buhari dhe Sahih Muslimi]

Si është mirësia ndaj prindërve pas vdekjes së tyre?

Vdekja sjell paaftësinë e kryerjes së veprave të mira dhe është një udhëtim shumë i largët që kërkon furnizime të mjaftueshme dhe vetëm tre cilësi që mund ta bëjnë këtë udhëtim më të lehtë. I dërguari i Allahut,

salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kur një njeri vdes të gjitha veprat e mira përfundojnë përveç se në tre raste; bamirësia e vazhdueshme, dija e dobishme që ai ka lënë dhe një fëmijë i devotshëm i cili lutet për të". [Sahih Muslim]

I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, e ka shpjeguar sesi mund t'i bëjë mirë një fëmijë prindërve të tij pas vdekjes së tyre. I transmetuar nga Ebu Usejd Melik Ibën Rabbiah es-Saidi: "Gjatë kohës që ishim me të dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, një burrë nga Benu Selmah erdhi tek ai dhe ka thënë: "O i dërguari i Allahut a ka ndonjë të mirë të lënë që unë mund ta bëj për prindërit e mi pas vdekjes së tyre?" Ai iu është përgjigjur: "Po, ka katër mënyra për të kryer:

1. Lutju (Allahut që t'i falë ata) dhe përmende atë për faljen e tyre.

2. Përmbushi premtimet e tyre (ose vullnetin).

3. Ji bujar ndaj miqve të tyre.

4. Mbaj marrëdhëniet me fafësinë të cilët janë të dashur për prindërit e tu. Kjo është ajo që mbetet nga mirësia që ti mund të bësh për ta pas vdekjes së tyre". [Sunan i Ebu Daudit 5123]

Praktikat inovative (bidatet) në fe nuk do t'i bëjnë dobi të vdekurit

Islami na ka dhënë udhëzime rreth gjithë asaj që i bën dobi të vdekurit. është e rëndësishme për tu kuptuar që Allahu i vetëm e di çfarë i bën dobi të vdekurit dhe Ai i ka shpjeguar ato mënyra tek ne përmes të dërguarit të Tij, salallahu alejhi ve sel-lem. Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, nuk ka bërë ceremoni të recitimit të Kur'anit për muslimanët e as për anëtarët e familjes së tij të cilët kanë vdekur gjatë jetës së tij, as për vajzat e tij që vdiqën në jetën e tij e as sahabet nuk e kanë bërë një gjë të tillë. Si

rezultat ne duhet të kufizojmë veprat tona brenda limiteve të përshkruara nga Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem. Kryerja e veprave të cilat nuk janë të legjisluara nga Allahu nuk sjellin shpërblim por ata bëhen një shkak për ndëshkim.

Kryerja e Haxhit për personin e vdekur

Një tjetër formë e njohur e sunnetit që mund të kryehet për të vdekurin është haxhi. Haxhi mund të kryehet për personin e vdekur pasi është kryer obligimi i të kryerit të haxhit (nga vet personi). është transmetuar nga Ibën Abbas që i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, e ka dëgjuar një burrë të thotë: "lebbejke an Shubrumah (në shërbim tëndin, O Allah për Shubrumah-n)". I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, e ka pyetur: "Kush është Shubrumah?" Ai ka thënë: "Një i afërm i imi". Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "A e ke bërë haxhin përpara?" Ai u përgjigj: "Jo". I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, e ke urdhëruar atë: "Bëje këtë haxh për veten tënde pastaj bëje haxhin për Shubrumah-n". [Ebu Daud (1811). Hadithi është i klasifikuar si Sahih nga Shejh Albani në Irva el-Ghalil (4/171).

Aisha, radiallahu anha, gjithashtu ka transmetuar që një burrë i ka thënë të Dërguarit, salallahu alejhi ve sel-lem: "Nëna ime ka vdekur papritur dhe unë mendoj që nëse ajo do të kishte mundur të flasë do të kishte dhënë sadaka [do të kishte lënë instruksione që disa pasuri të saj t'i jepeshin si sadaka]. A do të shpërblehem nëse unë shpenzoj për të?" Ai ka thënë: "Po". [Sahih Muslim 1004]

Imam Naveviu, rahimahullah, ka thënë: "Ky hadith tregon që është e lejueshme për të dhënë sadaka për të vdekurit dhe që të kryerit e saj është mustehab (e rekomanduar) dhe që shpërblimi për atë do ta arrijë të vdekurin dhe t'i bëjë dobi atij por gjithashtu

do ta arrijë edhe atë që e ka kryer sadakanë. Ka një konsensus për gjithë atë midis muslimanëve".

Detyrat e fëmijës ndaj prindërve të tij të vdekur

1). Kryerja e agjërit të obliguar të tyre:

Aisha, radiallahu anha, ka transmetuar që i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Kushdo që vdes dhe që ka ndonjë agjërim që nuk e ka kryer (prej atyre të obligueshme) trashëgimtari i tyre duhet ta kryejë për atë". [Sahih el-Buhari 1851 dhe Sahih Muslim 1174]

Një grua erdhi tek i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, duke e pyetur: "Nëna ime ka vdekur dhe ajo ka një muaj agjërimi pa e agjëruar". Ai, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Borxhi ndaj Allahut meriton më tepër që të paguhet". [Sahih el-Buhari dhe Sahih Muslim 1148]

2. Përbushja e obligimeve të adhurimit dhe pagimi i borxheve të tyre:

"Është raportuar nga Ibën Abbasi, radijallahu anhu, që një grua nga Xhuhejneherdhi tek Pejgamberi, salallahu alejhi ve sel-lem, dhe ka thënë: "Nëna ime ka bërë betimin që do të shkojë në haxh por ajo nuk shkoj për haxh përpara se të vdiste. A duhet ta kryej unë për atë?" Ai ka thënë: "Po, kryeje haxhin për të. A nuk mendon se nëse nëna jote është në borxh dhe ti do ta paguash atë? Paguaje borxhin që është për Allahun sepse Allahu e meriton atë dhe çfarë është e Tij duhet paguar". [Sahih el-Buhari 1754]

3. Mbajtja e marrëdhënieve me ata të cilët ata kanë mbajtur lidhje nga të afërmit dhe miqtë.

I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Më e mira nga veprat e devotshme është për një njeri të mbajë lidhje me miqtë e babait të tij pasi ai vdes". [Sahih Muslim 2552]

Kur Abdullah Ibën Umar, radijallahu anhu, doli nga Meka ai mbajti një gomar me të për ta nisur kur ai u lodhte nga kalërimi i devesë dhe ka pasur një çallmë të rrotulluar pas kokës së tij. Një ditë kur ai ishte duke nisur gomarin një beduin ndodhi që të kalonte aty pranë atij. Ai (Abdullah Ibën Umar) ka thënë: "A nuk je ti filani dhe filani?" Beduini iu përgjigj: "Po". Ai (Abdullah Ibën Umar) i dha atij gomarin dhe çallmën e tij dhe i tha: "Nise këtë gomar dhe rrotulloje këtë çallmë rreth kokës tënde" Disa nga shokët e tij i thanë: "Allahu të faltë ia dhe këtij beduini gomarin me të cilin ti po rehatohej dhe çallmën të cilën ti e pate rrotulluar rreth kokës tënde". Abdullah Ibën Umar (radiallahu anhu) ka thënë: "Unë e kam dëgjuar të dërguarin e Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, duke thënë: "Vepra më e mirë në mirësi është trajtimi i mirë i një personi i dashur nga babai i tij pas vdekjes së tij" dhe ky personi ishte një shok i Umarit, radijallahu anhu". [Sahih Muslim]

Duaja që dikush mund të bëjë për prindërit e tij të vdekur

"Dhe në shenjë mëshire shtrije pranë tyre krahur përulës e respektues dhe thuaj: "Zoti im! mëshiroi ata të dy, sikurse më edukuan mua kur isha i vogël". [el-israh 17: 24]

"Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër pos Tij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve. Nëse njërin prej tyre, ose që të dy, i ka kapur pleqëria pranë kujdesit tënd, atëherë mos u thuaj atyre as "of - oh", as mos u bë i vrazhdë ndaj tyre, po atyre thuaju fjalë të mira (të buta respektuese)". [el-Israh 17: 23]

"Në këtë vers Allahu ka përmendur veçanërisht rritjen dhe kujdesin kështu që fëmijët të kujtojnë këndshmërinë dhe kujdesin që kanë patur prindërit e tyre gjatë kohës që i kanë rritur. Mund që ata të ndihen të më-

shirshëm dhe të këndshëm ndaj prindërve të tyre. Ne duhet të përmendim që Allahu nuk e ka lejuar përmendjen e tij për faljen e të vdekurve jobesimtarë. Si rezultat nëse prindërit e muslimanëve janë kristian ose çifut ai ose ajo duhet të sjellet me ta në mënyrën sesi Allahu e ka urdhëruar përveç të kërkuarit prej Tij për t'i mëshiruar ata nëse ata vdesin gjatë kohës që janë jobesimtarë". [Ahkam el-Kuran nga el-Xhasas, vol.2 faqe 236]

Kultivimi i karakteristive të bindjes ndaj prindërve në fëmijët tuaj

Mëshira dhe kujdesi që prindërit kanë për fëmijët e tyre nuk ka nevojë për shpjegim aq gjatë, ngase sa që dikush bëhet prind, mëshira, kujdesi, këndshmëria, dedikimi dhe dashuria drejt fëmijëve të tij fillon. Megjithatë dashuria dhe kujdesi për fëmijët e tij nuk duhet ta bëjnë atë neglizhent ndaj të drejtave të Allahut. Allahu na ka paralajmëruar kundër sprovës që fëmijët paraqesin për ata: "S'ka dyshim se pasuria juaj dhe fëmijët tuaj janë vetëm sprovë, ndërsa ajo që është tek All-llahu, është shpërblim i madh". [64:15]

Një herë Halifeja Hisham Ibën Abdul Melik nuk e ka parë djalin e tij midis atyre që merrnin pjesë në faljen e Xhumasë dhe e ka pyetur atë (pse ai nuk ka vajtur) dhe djali i tij është përgjigjur që deveja e tij nuk mund ta mbante atë. Hishami i ka thënë atij: "Por ti kishe patur mundësi të ecje". Hishami ia ka ndaluar djalit të tij për ta nisur deven për një vit gjatë të cilit atij i është dashur të ecë në këmbë për të shkuar në faljen e Xhumasë". [El-Bidaja en-Nihaja vol (faqe 396]

Omer AbdulAzizit i është thënë se djali i tij kishte blerë një unazë për një mijë dirhem ai i shkruajti atij: "Më është thënë se ti ke blerë një unazë që kushton një mijë dirhem . Kështu kur ti ta marrësh këtë letër shite unazën dhe mbushja barkun një mijë personave me ato para. Pastaj blejë një unazë

prej dy dirhem, që ka një hekur në midis dhe shkruaji këto fjalë në të: "Allahu pastë mëshirë për atë i cili ja din hallin vetes". [Madarixh es-Saalikin vol2 faqe 396]

Kjo është sesi të parët tanë i kanë edukuar fëmijët e tyre për të përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e tyre islame. Ata i ndiqnin fëmijët e tyre dhe ecnin për krah tyre duke i mësuar, këshilluar, duke i drejtuar dhe i rritur me drejtësi. Kjo është arsyeja pse fëmijët e tyre ishin rehatia e syve të tyre, ngushllimi i zemrave të tyre dhe esenca e Ummetit musliman.

Kështu nga çdonjëri prej nesh kërkohet që t'i mësojë fëmijët të bëjnë vepra të mira, t'i mësojmë limitet që ka caktuar Allahu dhe duke i paralajmëruar ata kundër rrugëve që çojnë në pakënaqësinë e Allahut. Prindërit duhet gjithashtu t'i kryejnë vetë të gjitha ato që duan t'i mësojnë fëmijët e tyre sepse fëmija ndjek gjurmët e prindërve. Kur Melik Ibën Dinar ka parë një njeri që nuk falej në rregull ai ka thënë: "Më vjen keq për fëmijët e tij!" Ai është pyetur: "Ai nuk falej në rregull dhe ty të vjen keq për fëmijët e tij?" Meliku ka thënë: "Ai është kreu i tyre dhe ata mësojnë nga ai!" [Sifatus Safuah, vol 3 faqe 287]

Kjo tregon rolin e rëndësishëm të prindërve në ndërtimin e karakterit të fëmijëve të tyre. Nëse prindërit janë të drejtë ata i mësojnë fëmijëve të tyre disiplinën dhe të jenë të drejtë, kjo do të influencojë në sjelljen e fëmijës për t'i trajtuar prindërit e tij me këndshmëri në të ardhmen. Kështu nëse ju jeni të pabindshëm dhe të pakëndshëm ndaj prindërve tuaj ju mund të merrni trajtimin e njëjtë nga fëmijët tuaj në moshën tuaj të thyer. I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Allahu i ka lënë ndëshkimin e të gjitha gjynaheve në ditën e Gjykimit përveç mosbindjen ndaj prindërve, për të

cilën Allahu e ndëshkon gjynahqarin në këtë botë para vdekjes së tij". [I raportuar nga el-Hakimi mbi autoritetin e transmetuesve të besueshëm]

E njëjtë me këtë nëse një person nderon prindërit e tij kjo mund t'i sjellë atij mirësi në këtë botë përmes fëmijëve të tij të cilët e nderojnë dhe i shërbejnë atij në moshën e tij të thyer sepse i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Nëse një djalë i ri e nderon një person të vjetër shkaku i moshës së tij, Allahu dërgon dikënd për ta nderuar atë në moshën e tij të thyer". [Et-Tirmidhiu]

Nuk ka bindje ndaj askujt në mosbindje ndaj Allahut

Një parim i përgjithshëm i islamit është që nuk ka bindje ndaj asnjë krijese kur kjo ka të bëjë me mosbindjen (të kryerit të gjynaheve) ndaj Allahut, subhanehu ve teala. I dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ai i cili i bindet urdhërit të një pronari, një lideri ose një pushtetari dhe kjo rezulton në mosbindjen dhe mohimin e Allahut është një jobesimtar dhe një mushrik (ai i cili shoqëron partner të tjerë me Allahun). Nuk ka bindje ndaj krijesës kur të rezultojë në mosbindje apo në pakënaqësinë e Allahut". [Sahih Muslim] Ai, salallahu alejhi ve sel-lem, gjithashtu ka thënë: "Bindja është vetëm në çfarë është e mirë". [Sahih El-Buhari dhe Sahih Muslim] Dhe: "Dëgjimi dhe bindja (është e lejuar) për muslimanin për gjërat që ai pëlqen apo nuk pëlqen aq gjatë sa ai nuk është i urdhëruar të bëjë gjynah. Nëse ai është i urdhëruar të bëjë gjynah atëhere nuk ka dëgjim dhe nuk ka bindje". [Buhari & Muslim]

E njëjtë me këtë është bindja ndaj prindërve. Ajo është e detyrueshme vetëm në çështjet që janë të lejuara nga Allahu, subhanehu ve teala. Siç Allahu ka thënë: "E nëse ata të dy tentojnë që ti të më për-

shkruash Mua shok, për çka ti nuk ke kurrfarë fakti, atëherë mos i respekto ata, po në çështjet e jetës së kësaj bote të keshë mirë-kuptim ndaj tyre, e ti ndiqe rrugën e atij që është i kthyer kah Unë, mandej kthimi juaj është tek Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni punuar". [el-Llukman 31: 15]

Imam Ibën Kethir, rahimahullah, shkruan në tefsirin e tij mbi versin e mësipërm: "Do të thotë nëse ata përpiqen shumë për t'iu bërë ju që t'i ndiqni ata në fenë e tyre të rreme atëherë mos e prano të bësh si të thonë por mos e lë që kjo t'ju ndaloj nga të sjellurit me respekt".

Allahu gjithashtu thotë në Suran el-Ankebut: "Ne e kemi obliguar njeriun me punë të mira ndaj prindërve të vet, e nëse ata të dy përpiqen të shpiejnë ty që të më përshkruash Mua shok (zot tjetër) për çka ti nuk di asgjë, atëherë ti mos i respekto ata. Kthimi juaj është te Unë, e Unë do t'ju njoftoj për atë që keni vepruar". [Ankebut 29: 8]

Një shembull i shkëlqyer për versin e parë është i gjetur në transmetimin e Sa'd Ibën Melik i cili ka thënë: "Ky vers [31: 15] është shpallur për mua. Unë isha një njeri i cili e ka nderuar nënën e tij por kur u bëra musliman ajo tha: "O Sa'd! çfarë është kjo gjë e re që të shoh se je duke bërë? Leje këtë fe ose unë nuk do të ha derisa të vdes dhe njerëzit do të thonë: "Turp të kesh se çfarë më ke bërë dhe ata do të thonë se ti ke vrarë nënën tënde". Unë i thashë: "Mos e bëj atë O nënë sepse unë nuk do ta lë këtë fe për asgjë tjetër". Ajo qëndroi pa ngrënë për një ditë dhe një natë dhe ajo u lodh shumë atëherë ajo qëndroi edhe për një ditë dhe një natë tjetër pa ngrënë dhe ajo u bë shumë shumë e lodhur. Kur unë e pashë unë i thashë: "O nënë, Vallahi! Edhe nëse të kesh një qind shpirtëra dhe ata të ikin një e nga një unë nuk do ta lë këtë fe për asgjë

kështu nëse dëshiron të hashë, ha dhe nëse dëshiron mos ha". Kështu ajo hëngri". [I përmendur nga Ibën Ethir në Usd el-Ghabah 2: 216]

Shejh ul islam Ibën Tejmijah ka thënë: "Ebu Bekri ka thënë në librin e tij Zadul Mu-safir: "Kushdo që i ka bërë prindërit e zemëruar dhe i ka bërë të qajnë është e kërkuar nga ai të kthehet dhe t'i bëjë ata të qeshin". Kjo tregon që është e nevojshme për t'ju bindur prindërve në gjërat e lejueshme dhe çfarëdo që ata urdhërojnë duhet t'i shman-gemi nëse e gjitha kjo do t'i sjellë dobi atyre dhe nuk do të dëmtoj fëmijën e tyre dukë përfshirë kryerjen e udhëtimeve dhe qëndri-min me ta nëse ata dëshirojnë këtë".

Përfundim: Mësime të rëndësishme

1. Bindja ndaj prindërve, shërbimi dhe kujdesi për ta në moshën e tyre të thyer është obligim mbi fëmijën ashtu siç prindërit e kanë rritur atë me dashuri dhe kujdes në fëmijërinë e tij, nëse prindërit e tij janë besimtarë apo jo.

2. Mos bindja dhe neglizhimi i të drejtave të prindërve është kërkimi i ndëshkimit të Allahut dhe mos respektimi i tyre dhe fyerja e tyre është nga gjynahet e mëdha.

3. Fëmija duhet të preferoj kënaqësinë e prindërve të tij mbi vetë kënaqësinë e tij dhe kënaqësinë e gruas së tij, fëmijëve të tij dhe të gjithë njerëzve përveç Pejgamberit.

4. Fëmija duhet t'i bindet prindërve të tij në të gjithë atë që e urdhërojnë madje edhe kur kërkesa nuk është e përshtatshme në opinionin e fëmijëve të tyre derisa ata nuk urdhërojnë për të mos iu bindur Allahut, subhanehu ve teala.

5. Fëmija duhet me dëshirën dhe me një zemër të mirë t'i garantojë prindërve të tij çfarë ai mendon që ata pëlqejnë ose preferojnë përpara se ata ta kërkojnë atë e gjitha kjo duke e ndjekur me një ndjenjë dhe pra-

nim që ai nuk e ka arritur perfekten në kryerjen e të drejtave ndaj tij.

Ne duhet të kujtojmë që i dërguari i Allahut, salallahu alejhi ve sel-lem, ka thënë: "Ka tre tipe lutjesh që nuk do të refuzohen (nga Allahu), lutja e prindërve për fëmijët e tij, lutja e një personi që agjëron dhe lutja e udhëtarit". [Sahih el-Xhami nr 3029] Kështu nëse bindja dhe këndshmëria për prindërit tanë vetëm sjell përmendjen e tyre ndaj Allahut meriton dhe është e mjaftueshme në drejtimin tonë për lumturinë e përjetshme, Inshallah.

E mësipërmja është vetëm një përkujtues dhe një këshillë ndaj të gjithë atyre të cilët kanë urtësi dhe të kuptuar të drejtë për të realizuar begatinë e të pasurit prindër njëri-tjetri me vite kanë plotësuar nevojat, urinë, sëmundjen, lumturinë dhe kënaqësitë. Kur ata të arrijnë moshën e thyer dhe të varren nga ju është detyra e juaj për t'i plotë-

suar nevojat, kënaqësitë dhe rehatinë e tyre. "Zoti është i kënaqur kur prindërit janë të kënaqur dhe Zoti është i zemëruar me atë që zemëron prindërit e tij". [Sahih el-Xhami 3500] Kështu përvetsoji avantazhet për t'i shërbyer prindërve tuaj përpara se është shumë vonë kur të shikoni tek karrigeja që nëna e juaj ose babai juaj është ulur për të pushuar ose shtrati ku kanë fjetur dhe nuk i shihni ata më dhe as që dëgjoni zërat e tyre me plotë dashuri.....

Roli i prindërve

"Prindërit duhet t'i ndihmojnë fëmijët e tyre në këndshmëri ndaj tyre duke u frenuar nga të kërkuarit nga fëmijët e tyre për gjëra që nuk mund t'i bëjnë dhe as të mos insistojnë mbi gjëra kur fëmijët e tyre janë të mërzitur nga frika që ata mund të mos i binden Allahut dhe kështu të jenë të dënuar me Zjarr". [Tanbihul Ghafilin faqe 98]

Shauana Abdul Aziz

Marrë nga: revista "Es-Sunnah" nr. 20

Përktheu: Ammar Ardit Kraja

03,10,17.10.2003

Gratë dijetare të hadithit

Islami si një fe e cila (në dallim nga krishterizmi) refuzoi të atribuojë gjini për Hyjninë [1] dhe kurrë nuk ka vendosur një elitë priftërinjesh për të shërbyer si ndërmjetësues midis krijesës dhe Krijuesit, e filloi jetën vetëm me siguri, e që burrat dhe gratë janë të pajisur nga natyra si plotësues e jo si role identike, superioritet shpirtëror nuk trashëgohet në gjininë mashkullore [2]. Si një rezultat komuniteti musliman ishte i gëzuar ti besonte çështjet e barazisë në shiki-

min e Zotit. Vetëm kjo mund ta shpjegojë pse veçanërisht islami, midis feve perëndimore klasike, prodhoi një numër të madh dijetarësh femra nga dëshmia e të cilave dhe gjykimi i shëndoshë mvaret ndërtesa e Islamit.

Përderisa në Islamin e ditëve të mëparshme, gratë kanë patur një pjesë të rëndësishme në ruajtjen dhe kultivimin e hadithit dhe ky funksionim vazhdoi përgjatë shekujve. Në çdo periudhë në historinë Islame kanë

jetuar gra shumë të famshme tradicionaliste të trajtuara nga vëllezërit e tyre me respekt dhe nderë. Shënimet biografike me një numër shumë të madh të tyrin do të gjinden në fjalorin e biografive.

Gjatë jetës së Profetit shumë gra nuk kanë qenë vetëm shkak për evolucionin e shumë traditave por gjithashtu kanë qenë transmetueset e tyre për motrat dhe vëllezërit e tyre në fe [3]. Pas vdekjes së Profetit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, shumë gra sahabije, veçanërisht gratë e tij, shikoheshin si ruajtëset e gjalla të dijes dhe ishin të afruara për mësim nga sahabet e tjerë të cilëve ata tashmë i dorëzuan hangarin e pasur të cilin ato e kishin grumbulluar nga Profeti, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Emrat si Hafsa, Umm Habiba, Mejmuna, Umm Selam dhe Aisha janë të njohura për çdo student të hadithit si të qënurit nga më të hershmit dhe transmetuesit më të dallueshëm [4]. Në veçanti Aisha është midis figurave më të rëndësishme në tërë historinë e literaturës së hadithit - jo vetëm si një nga raportueset e numrit më të madh të hadithit por gjithashtu njëra nga ato më të kujdesëshmet në transmetimin e tyre.

Në periudhën e tabi-inëve gjithashtu gratë kanë mbajtur pozicione të rëndësishme si tradicionaliste. Hafsa vajza e Ibn Sirin-it [5], Umm el-Darda e vogla (81/700) dhe Amra bin Abdelrrahmen janë vetëm disa nga gratë kryesore tradicionaliste të kësaj periudhe. Umm el-Darda ishte mbajtur nga Ijas Ibn Muaujjah si një tradicionaliste e rëndësishme të asaj kohe dhe një fakihe me një aftësi të pamohueshme për të qënë superiore nga të gjithë tradicionalistët e asaj kohe duke përfshirë muhadithët si Hasan el-Basri dhe Ibn Sirin[6]. Amra ishte e konsideruar si një autoritet i madh në trasmetimet e Aishes. Midis studentëve të saj Ebu Bekër Ibn Hazm

gjykatësi i famshëm i Medinas i cili ishte urdhëruar nga Khalifi Umar Ibn Abdul Aziz për të shkruar të gjitha transmetimet që ajo kishte shkruar [7].

Pas tyre Abida el-Madanija, Abda bin Bishr, Umm el-Thakafijah, Zeuneb, vajza e madhe e Ali Ibn Abdullah Ibn Abbas. Nafisa bint el-Hasan Ibn Zijad, Khatixhah Umm Muhammed, Abda bint Abd el-Rahmen dhe shumë anëtarë të tjerë femra kanë shkëlqyer duke dhënë ligjërata publike mbi hadithin. Këto gra të devotshme kanë ardhur nga edukime të ndryshme duke treguar se as klasa dhe as gjinia nuk ishin pengesa për tu ngritur përmes elitës së dijetarëve islam. Për shembull, Abida e cila e filloi jetën e saj si robëreshë e Muhammed Ibn Jezidit mësoi një numër të madh hadithesh me mësuesit në Medina. Ajo i është dhënë 9si robëreshë) Habib Dahhun tradicionalistit shumë të madh në Spanjë kur ai vizitoi qytetin e shenjtë mbi këtë rrugë në haxh. Dahhun ishte kaq i impresionuar nga dituria e saj sa e liroi atë dhe e martoi dhe e solli në Andaluzi. Është thënë së ajo ka transmetuar me mijëra transmetime nga autoritetet e mësuesve të saj në Medine [8].

Zejneb bint Sulejman (142/759) ishte një princeshë nga lindja. Babai i saj ishte kushëri i el-Saffas, themeluesit të dinastisë Abaside dhe ka qënë një guvernator i Basrës, Omanit dhe Bahreinit gjatë Khalifatit të Mansurit[9]. Zejneb e cila mori një edukim të mirë mori masterin në hadith, fitoi një reputacion si një nga gratë më të dalluara tradicionaliste të kohës dhe kishte shumë njerëz të rëndësishëm si burra midis studentëve të saj [10].

Ky partnerizim i grave me burrat në kultivimin e traditës Profetike vazhdoi kur antologjitet e mëdha të hadithit u formuluan. Një vëzhgim i teksteve tregon që të gjithë për-

punuesit e rëndësishëm të transmetimeve nga periudhat më të hershme kishin midis tyre shumë gra dijetare: çdo koleksion i madh jep emrat e shumë grave si autoritete imediate të autorit. Dhe kur këto vepra u përpunuan nga gratë tradicionaliste vetë morën masterin me to dhe dhanë shumë ligjërata me klasa të mëdha studentësh për të cilët ato do t'i jepin ixhazat e tyre personale.

Në shekullin e katërt hixhri ne gjejmë Fatima bint Abd el-Rahmen (312/924) e njohur si el-Sufijah për shkak të devotshmërisë së saj të madhe; Fatima (mbesa e Ebu Daudit i cili ka shkruar Sunanin e famshëm); Amat el-Uahid (377/987), vajza e juristit të dalluar el-Muhamilit; Umm el-Fath Amat es-Selam (390/999) vajza e gjykatësit Ebu Bekër Ahmed (350/987); Xhumua bint Ahmed dhe shumë gra klasat e të cilave ishin gjithmonë të mbushura me njerëz të rëndësishëm [11].

Tradita islame e grave të hadithit vazhdoj në shekullin e pestë dhe të gjashtë të hixhretit. Fatima bint el-Hasan ibn Ali Ibn el-Dakak el-Kurejshi ishte shumë e famshme jo vetëm për devotshmërinë e saj dhe për shkëlqyeshmërinë e saj në kaligrafi por gjithashtu edhe për dijen e saj në hadith dhe për cilësinë e zingjireve të transmetimit (isnadet) që ajo dinte [12]. Më e dalluar ishte Kerima el-Maruzijah (463/1070) i cili është i konsideruar më i miri autoritet në Sahih el-Bukhari në vetë kohën e saj. Ebu Dharr i Heratit një nga dijetarët e mëdhenj i periudhës vendosi një rëndësi të madhe autoritetit të saj sa që ai i këshilloj studentët e tij të studjonin Sahihun nën askënd tjetër për shkak të cilësisë së diturisë së saj. Kështu ajo figuron si një pikë qendrore në transmetimin e këtij teksti të rëndësishëm Islam [13]. Për sa i përket kësaj shkruan Godziher " emri i saj

gjendet me një shpeshsi të jashtëzakonshme të ixhazas për transmetimin e këtij libri" [14]. Midis studentëve të saj ishin el-Khatib el-Bagdadi [15] dhe el-Humejdi (428/1036 - 488/1095) [16].

Përveç Kerimas një numër grash të tjerë tradicionalite zënë një vend të rëndësishëm në historinë e transmetimit të tekstit të Sahihut [17]. Midis këtyre njëri mund të përmend në veçanti Fatima bint Muhammed (539/1144); Shuhda shkrimtarja (574/1178) dhe Sitt el-Uazara bint Umar (716/1316) [18]. Fatima ka transmetuar librin nën autoritetin e tradicionalistit të famshëm Said el-Ajar; ajo mori nga specialistët e hadithit titullin e famshëm Musnida Isfan (autoritet i madh i hadithit të Isfahanit). Shuda ishte një kaligrafe e famshme dhe një tradicionalite e me një reputacion të madh; biografët e saj e përshkruajnë atë si kaligrafe, autoritet i madh në hadith dhe krenare për feminitetin e saj. Stërgjyshi i saj ka qenë një tregëtarë i parëndësishëm dhe kështu mori nofkën el-Ibri. Por babai i saj Ebu Nasir (506/1112) kishte një pasion për hadithin dhe ka arritur të studiojë me disa dijetarë të këtij subjekti [19]. Në bindje të sunnetit ai i dha vajzës së tij një edukim të pastër akademik duke siguruar që ajo të studiojë nën shumë tradicionalistë me reputacion të pranuar.

Ajo u martua me Ali Ibn Muhammed një figurë e rëndësishme me disa interesa në letërsi i cili më vonë u bë një shok i ngushtë i Khalifit el-Muktadi dhe themeloi një shkollë të cilën ai e administroi shumë bujarisht. Gruaja e tij megjithatë ishte e njohur më mirë; ajo fitoi një reputacion në fushën e hadithit dhe është e shënuar për cilësinë e is-nedeve (zingjireve të transmetimit) të saja [20]. Ligjëratat e saj mbi Sahih el-Bukharin dhe koleksione të tjera hadithesh ishin të pritura nga grumbuj të mëdhenj studentësh

dhe në lidhje me reputacionin e saj të madh shumë njerëz madje duke gënjyer kanë thënë të jenë studentët e saj [21].

Gjithashtu e njohur si një autoritet në Sahih el-Bukharin ishte Sit el-Uazara e cila krahu saj mori masterin në ligjin islam ishte e njohur si Musnida e kohës së saj dhe ka dhënë ligjëratat mbi Sahihun dhe veprat të tjera në Damask dhe Egjipt [22]. Klasat në Sahihun ishin të dhëna nga Umm el-Khajër Amat el-Khlik (811/1408-911/1505) i cili është i shikuar si dijetari i fundit i hadithit në Hixhaz [23]. Ende një autoritet tjetër në Sahihun e Bukharit ishte Aishah bint Abd el-Hadi [24].

Përveç këtyre grave të cilat duket se janë specializuar në Sahihun e madh të Imam Bukharit ka patur të tjera ku ekspertiza e tyre ishte përqëndruar mbi tekstet e tjera. Umm el-Khajr Fatima bint Ali (532/1137) dhe Fatima el-Shehzarurijah ka dhënë ligjëratat mbi Sahih Muslimin [25]. Fatima Xheuz-danijah (524/1129) i ka transmetuar studentëve të tyre tre Maxhamet e Tabaranit [26]. Zejneb i Harranit (680/1289) ligjëratat e së cilës tërhoqën një turmë të madhe studentësh, i ka treguar atyre Musnadin e Ahmed Ibn Hanbel koleksioni më i madh i haditheve [27]. Xhuajrijah bint Umar (783/1381) dhe Zejneb bint Ahmed Ibn Umar (722/1322) e cila udhëtoi shumë në kërkim të hadithit dhe ka dhënë ligjëratat në Egjipt gjithashtu në Medine i ka transmetuar nxënësve të saj koleksionet e Darimit dhe Abd Ibn Humejd dhe ne na është thënë se studentet kanë udhëtuar nga larg për të marrë pjesë në ligjëratat e saj [28]. Zejneb bint Ahmed (740/1339) zakonisht e njohur si Bint el-Kalem ka marrë një ngarkesë de-veje me diploma; ajo ka dhënë ligjëratat mbi Musnadin e Ebu Hanifes, Shemailin e Tirmidhiut dhe Sharh Ma'ani el-Athar i Tahauit të

fundit ajo e ka lexuar me një tjetër grua tradicionaliste Axhiba bin Ebu Bekër (740/1339) [29]. Mbi autoritetin e saj është bazuar, thotë Goldziher, "autenticiteti i kodekstit të Gotës ...në të njëjtin isnad (zingjir transmetimi) një numër i gjërë i grave të ditura janë të cituara sikur kanë marrë nga kjo vepër" [30]. Me të dhe gra të tjera udhëtarë i famshëm Ibn Battuta ka studiuar disa transmetime gjatë qëndrimit të tij në Damask [31]. Historiani i Famshëm i Damaskut Ibn Asakir i cili na tregon ne që ai ka studiuar nën më shumë se 1200 burra dhe 80 gra, ka marrë ixhazan e Zejneb bint Abdurrahmen për Mu-uaatën e Imam Malikut [32]. Xhelal el-Din el-Sujuti ka studiuar Risalen e Imam Shafiut me Haxhar bint Muhammed [33]. Afif el-Din Xhunevd një tradicionalist i shekullit të nëntë hixhri ka lexuar Sunanin e el-Darimit me Fatima bin Ahmed Ibn Kasim [34].

Tradicionaliste të rëndësishme të tjera duke përfshirë Zejneb bint el-Shari (524/615-1129/1218). Ajo ka studjuar hadithin nën tradicionalist të rëndësishëm dhe i ka dhënë mësim shumë studentëve disa prej të cilëve kanë fituar një reputacion të madh duke përfshirë Ibn Kalikan autorin e mirënjohur të fjalorit biografik Uafajat el-Ajen [35]. Një tjetër ishte Kerima sirianja (641/1218) e përshkruar nga biografët si autoriteti më i madh i hadithit të kohës së saj. Ajo ka dhënë ligjëratat mbi shumë vepra të hadithit mbi autoritetin e mësuesve të shumtë [36].

Në veprën e tij el-Durar el-Kerima [37], Ibn Haxhar jep shënime të shkurtra biografike për rreth 170 gra të famshme të shekullit të tetë pjesa më e madhe janë tradicionaliste dhe nën të cilat autori vetë ka studjuar [38]. Disa nga këto gra ishin të nohura si tradicionalistët më të mira të periudhës. Për një cast, Xhuajrijah bint Ahmed të cilën tash-

më e kemi përmendur ka studjuar një numër të shumë mbi tradita nën dijetarët nga të dy palët femra dhe meshkuj ajo ka ligjruar në Universitetet më të mëdha të kohës së saj dhe pastaj ka vazhduar të jap ligjërata të famshme mbi parimet islame. "Disa nga vetë mësuesit e mi "thotë Ibn Haxher"dhe shumë bashkëkohës të mi kanë marrë pjesë në ligjërata e saj" [39]. Aishah bin Abd el-Hadi të cilën gjithashtu e kemi përmendur më lart e cila për një kohë të konsiderueshme ishte një nga Mësuesit e Ibn Haxherit është e konsideruar të jetë tradicionalistja më e mirë e kohës së saj dhe shumë studentë morën rrugë shumë të gjata në mënyrë që të merrnin pjesë . . . në ligjërata e saja për të vërtetat e fesë [40]. Sitt el-Arab (742/1341) ka qenë mësuesja e tradicionalistit të mirënjohur el-Iraki (742/1341) dhe shumë të tjerë të cilët kanë shpërndarë një pjesë të mirë të dijes së tyre nga ajo [41]. Dakika bint Murshid (746/1345) një tjetër grua tradicionaliste e famshme ka marrë instruksione nga një numër i madh grash të tjera.

Informacione mbi gratë tradicionaliste të shekullit të nëntë është e dhënë në një veprë nga Muhammed Ibn Abd el-Rahmen el-Sakhau (830-897/1427-1489) të quajtur si Dau el-Lami e cila është një fjalor biografish i personave më të famshëm të shekullit të nëntë [42]. Një burim tjetër është Muxham el-Shujakh i Abd el-Aziz ibn Umar Ibn Fahd (812-871/1409-1466) i përpunuar në 861 hixhri dhe ka qenë e devotcionuar me shënimet e biografive e më tepër se 1100 mësuesve të autorit duke përfshirë mbi 130 gra dijetare nën të cilat ai ka studjuar [43]. Disa nga këto gra ishin të quajtura si tradicionalistet më precize dhe të ditura të kohës së tyre dhe kanë stërvitur shumë dijetarë të mëdhenj e gjeneratës tjetër. Umm Heni Merjem (778-871/1376-1466) për shembull

mësoi Kur'anin përmendësh kur ishte ende fëmij dhe mori dije në të gjitha shkencat Islame duke përfshirë Teuhid, Sheriat, Sirah dhe Gramatikë arabe dhe pastaj ka udhëtuar në kërkim të hadithit me tradicionalistët më të mëdhenj të kohës së saj në Kairo dhe Mekë. Ajo ishte gjithashtu e famshme për përsoshmërinë e saj në kaligrafi, njohuritë e gramatikës arabe dhe zakoneve natyrore në poezi, gjithashtu mbikëqyrja e saj strikte e detyrave fetare (ajo ka shkruar në Haxh më shumë se trembëdhjetë herë). Djali i saj i cili u bë një dijetarë i njohur i shekullit të dhjetë ka treguar shumë madhështi për të dhe vazhdimisht i ka qëndruar pranë gjatë fundit të jetës së saj. Ajo ka ndjekur një program intensiv mësimi në Univeritetin e madh të Kairos, duke dhënë ixhazas shumë dijetarëve, vetë Ibn Fahd-i ka studjuar vepra të shumta teknike mbi hadithin nga ajo [44].

Bashkëkohësja e saj siriane Bei Khatun (864/1459) ka studjuar hadithe me Ebu Bekër el-Mizzin dhe tradicionalistët të tjerë të shumtë dhe pasi ka siguruar ixhazat e një numri të madh të muhadithëve burra dhe gra, ka dhënë ligjërata në Siri dhe Kairo. Ne na është transmetuar që ajo ka marrë një cilësi të lartë në mësimdhënie [45]. Aishah bin Ibrahim (760/1358-842/1438) e njohur në qarqet akademike si lbnat el-Shareih gjithashtu ka studjuar hadithin në Damask dhe Kairo dhe ka dhënë ligjërata të cilat dijetarët e famshëm të asaj kohe nuk mund të qëndronin pa i dëgjuar [46]. Umm el-Hajr Saida e Mekës (850/1446) kanë marrë instruksione ne hadithe nga tradicionalist të shumtë në qytete të ndryshme duke fituar një reputacion si dijetare [47].

Aq sa mund të grumbullohet nga burimet e ndryshme pjesëmarrja e grave në studimin shkencorë të hadithit dhe në disiplinat islame në përgjithësi duket se ka rënë në mëny-

rë të konsiderueshme nga shekulli i dhjetë i hixhretit. Libra të tillë si el-Nur el-Safir i el-Ajdarusit, Hulasat el-Akhbar i el-Muhibit dhe el-Suluh el-Uabila i Muhammed Ibn Abdullahut (të cilat janë fjalorë biografik i njerëzve të famshëm musliman të shekullit të dhjetë, njëmbëdhjetë dhe të dymbëdhjetë të hixhretit) përmban emrat e vetëm disa dhjetëra grave tradicionaliste të famshme. Por do të ishte gabim të përfundonin nga kjo që pas shekullit të dhjetë gratë humbën interesin në këtë subjekt. Disa nga gratë tradicionaliste të cilat fituan një reputacion në shekullin e nëntë jetuan edhe në shekullin e dhjetë dhe vazhduan shërbimin e tyre ndaj sunnetit. Asma bint Kemal el-Din (904/1498) kishte një influencë të madhe me sulltanët dhe nëpunësit e tyre të cilëve ajo shpesh i ka bërë rekomandime për të cilat na është thënë se ata i kanë pranuar gjithmonë. Ajo ka dhënë ligjëratat mbi hadith dhe i ka stërvitur gratë në shkencat e ndryshme islame [48]. Aisha bint Muhammed (906/1500) e cila martoi gjykatësin e famshëm Muslih el-Din i ka treguar transmetimet shumë studentëve dhe ishte vendosur si profesore në Universitetin e Salihija-s në Damask [49]. Fatimah bint Jusuf i Alipos (870/1465-925/1519) ishte e njohur si një nga dijetaret e shkëlqyeshme të asaj kohe [50]. Umm el-Khajr i ka dhënë një ixhaza një haxhiut në Mekë në vitin 938/1531 [51].

Gruaja e fundit tradicionaliste e rangut të parë e cila është e njohur për ne ishte Fatima el-Fudejliah gjithashtu e njohur si Shejha el-Fudejliah. Ajo ka lindur përpara fundit të shekullit të dymbëdhjetë hixhri dhe shpejt shkëlqeu në artin e kaligrafisë dhe shkencave të ndryshme islame. Ajo kishte një interes të veçantë në hadith dhe mësoi shumë për subjektin. Ajo ka marrë diploma nga një numër i shumë të dijetarëve dhe fitoi një reputacion si një tradicionaliste e rëndësishme

në të drejtën e saj. Drejt fundit të jetës së saj ajo u shpërngul në Mekë ku aty themeloi një librari publike shumë të pasur. Në qytetin e shenjtë ajo ishte e pritur nga shumë tradicionalist të famshëm të cilët morën pjesë në ligjëratat e tyre dhe morrën certifikata nga ajo. Midis tyre ai që ne mund të përmendim në veçanti është Shejkh Umar el-Hanefi dhe Shejkh Muhammed Sali. Ajo vdiq në 1247/1831 [52].

Përmes historisë së dijetareve (të gjinsisë femërore) në islam është e qartë që gratë nuk ishin vetëm të kufizuara duke studjuar në mënyrë individuale transmetimet ose duke mësuar disa individ por ata morën pjesë si student ashtu si edhe mësues në institucionet edukative publike bashkë me vëllezërit e tyre në fe (duke respektuar parimet e distancës midis gjinive). Shënimet e shumë dorëshkrimeve i paraqet ata të dy si studentë që kanë marrë pjesë në klasa të mëdha dhe gjithashtu si mësues duke shpërndarë kurse ligjëratash. Për shembull certifikata në fletët 238-40 e el-Mashikat ma el-Tarikh i ibn Bukharit tregon që shumë ggra morën pjesë kurse të rregullta të njëmbëdhjetë ligjëratave të cilat u dhanë përpara një klase që kishte më shumë sesa pesëqind student në Xhaminë e Umarit në Damask në vitin 687/1288. Një tjetër certifikatë në faqen 40 të të njëtit dorëshkrim tregon që shumë studente (femra) emrat e të cilave janë të përmendura morën pjesë në një tjetër kurs të gjashtë ligjëratave të librit të cilat ishin dhenë nga Ibn Sejrifi një klase që kishte më shumë sesa 200 nxënës në Alipo në vitin 736/1336. Dhe në fletën 250 ne do të zbulojmë që një grua e famshme tradicionaliste Umm Abdullah ka dhënë një kurs prej pesë ligjëratash mbi librin tek një klasë e përzier me më tepër sesa pesëdhjetë studentë në Damask në vitin 837/1433 [53].

Shënime të shumta mbi dorëshkrimin e Kitab el-Kifaja i el-Katib el-Baghdadi dhe një koleksion i disa analizave mbi hadithin tregon Nima bin Ali, Umm Ahmed Zejneb bint Meki dhe gra të tjera duke dhënë ligjërata mbi këto dy libra nga ndonjëherë në mënyrë in-

dividuale dhe nga ndonjëherë së bashku me tradicionalist meshkuj në Universitete të tilla si Medrasa Azizijah dhe Medrasa Dijajia drejtuar klasave të rregullta të studentëve. Disa nga këta ligjërata ishin të pritura nga Ahmedi djali i gjeneralit të famshëm Salah ud-din [54].

Shënime:

1. Maura O'Neill, *Women speaking, Women Listening* (Mariknoll, 1990) 31: "Muslimanët nuk përdorin një Zot mashkullorë as si vegël të vetëdijshme dhe as si vegël të pavetdijshme në ndërtimin e roleve gjinore".
2. Për një shikim të përgjithshëm mbi pyetjen e statusit të gruas në islam shiko M. Boisiers, *L'Humanisme de l'Islam* (edicioni i tretë, Paris, 1985), 104'10.
3. el-Khatib, *Sunnah*, 53-54, 69-70.
4. Shiko sipër, 18, 21.
5. Ibn Sad, VIII, 355.
6. Sujuti, *Tadrid*, 215.
7. Ibn Sad, VIII, 353.
8. Makkari, *Nefl*, II, 96.
9. Wustenfelf, *Genealogische Tabellen*, 403.
10. el-Khatib el-Baghdadi, *Tarikh Baghdad*, XIV, faqe 434.
11. *Ibid*, XIV, 441-44.
12. Ibn el-Imad, *Shsadarat el-Dhahah fi Akhbar men Dhelah* (Kairo, 1351), V 48; Ibn Khalikan, no. 413.
13. Makkari, *Nefl*, I, 876; cited në Goldziher, *Muslim Studies*, II, 366.
14. Goldziher. *Muslim Studies*, II, 366. "është një fakt shumë i zakonshëm në ixhazan e transmetimit të tekstit të Bukharit për të gjetur si anëtarë të mesëm të zingjireve të gjata emrin e Kerima el-Maruaazijah". (*Ibid*)
15. *Jakut*, Muxham el-Ubada, I, 247.
16. *COLP*, V/i, faqe 98.
17. Goldziher, *Muslim studies*, II, 366.
18. Ibn el-Imad, IV, 123. *Sitt el-Uazara* ishte gjithashtu një juriste e famshme. Ajo ishte një herë e ftuar në Kairo për të dhënë fetuat e saja mbi një subjekt që kishte munduar juristët atje.
19. Ibn el-Athir, *el-Kamil* (Kairo, 1301), X, 346.
20. Ibn Khalikan, nr 295.
21. Goldziher, *Muslim Studies*, II, 367.
22. Ibn el-Imad, IV, 40.
23. *Ibid*, faqe 28.
24. Ibn Selim, *el-Imdad* (Hyderabad, 1327), 36.
25. Ibn el-Imad, IV, 100.
26. Ibn Selim, 16.
27. *Ibid*, 28.
28. Ibn el-Imad, VI 56.
29. *ibid*, 126; Ibn Selim, 14, 18; el-Umari, *Kitf el-Thamar* (Hyderabad, 1328), 73.
30. Goldziher, *Muslim Studies*, II, 407.
31. Ibn Battuta, *Rihla*, 253.
32. *Jekut*, Muxham el-Buldan, V, faqe 140.
33. *Jekut*, Muxham el-Udaba, faqe 17.
34. *COLP*, V/i, 175.
35. Ibn Kalikan, nr. 250.
36. Ibn el-Imad, V, 212, 404.
37. Dorëshkrime të shumta të kësaj vepra janë të ruajtura në librari dhe është publikuar në Hyderabad në 1348-50. Volumi i VI i *Shadharat el-Dheheb* të Ibn el-Imad një fjalor biografik shumë i gjërë i dijetarëve më të mëdhenj musliman nga shekulli i parë tek shekulli i dhjetë i hixhretit është i bazuar shumë në këtë vepër.

38. Goldziher, e mësuar me ekskluzivitetin e ambjeteve mashkullore të shekullit të nëntëmbëdhjetë në Universitetet Europiane ishte mahnitur nga skena e përshkruar nga Ibn Haxhari. Cf. Goldziher, *Muslim Studies*, II, 367: "Kur ne lexojmë veprat biografike të mëdha të Ibn Haxhar el-Askalanit mbi dijetarët e shekullit të tetë, ne mund të mahnitemi nga numri i grave të cilave autori i ka dedikuar artikuj".

39. Ibn Haxhar, *el-Durar el-Kerima fi Ajen el-Mia el-Themina* (Hyderabad, 1348-50), I, nr. 1472.

40. Ibn el-Imad, VIII, faqe 120.

41. *Ibid.*, VI, 208. Ne na është treguar që el-Iraki (autoriteti më i njohur në Hadith i Ihia Ulum el-Din i Gazaliut) siguroi që gjithashtu djali i tij të studjonte tek ajo.

42. Një Shënim i Abd el-Selam dhe Umar Ibn El-Shamma ekziston (C. Brokelman, *Geschichte der arabischen Literatur*, edicioni i dytë. (Leiden, 1943-49), II, 34) dhe një dorëshkrim me defekte i vonshëm është i ruajtur në O. P. Librari në Patna (COLP, XII, nr. 727).

43. *Ibid.*

44. Sakhaui, *el-Sau el-Lemi li Ehl el-Karn el-Tesi* (Kairo, 1353-55), XII, nr. 980.

45. *Ibid.*, nr. 58.

46. *Ibid.*, nr 450.

47. *Ibid.*, nr 901.

48. *el-Ajdarus, el-Nur el-Safir* (Baghdad, 1353), 49.

49. Ibn Ebu Tahir, shiko COLP, XII, nr 665.

50. *Ibid.*

51. Goldziher, *Muslim Studies*, II, 407.

52. *el-Suhuh el-Uabila* shiko COLP, XII, nr 785.

53. COLP, V/ii, 54.

54. *Ibid.*, V/ii, 155-9, 180-208. Për më tepër dorëshkrime të vecanta janë të ruajtura në Librarinë e Zahirijah në Damask, shiko artikullin e Abd el-Aziz el-Mejmani në *el-Mabahith el-Ilmijah* (Hyderabad: Dairat el-Ma'arif, 1358), 1-14.

Dr Muhammed Zubejr Sidiki

Profesor i Kulturës islame, Universiteti i Kalkutës.

Marrë nga: Kapitulli i gjashtë faqe 142-153 në "Hadith Literature: Its Origin, Development, Special feature and criticism.

Përktheu: (Ammar) Ardit Kraja,
24.10.2003



Muhammed Salih el Uthejmin

Muhammed ibën Salih ibën Muhammed el Uthejmin ka qenë anëtar i „Këshillit të Ulemave të Mëdhenj“ (K.U.M.) në Mbretërinë e Arabisë Saudite, profesor në filialën e Universitetit islamik „el Imam Muhammed ibën Saud“ në Kassim dhe imam dhe hatib në xhaminë e madhe në Unejze.

Lindja e tij: Lindi më 27 Ramadan të vitit 1347 h. në qytetin Unejze.

Zhvillimi i tij: Në fëmijërinë e tij e mësoi Kur'anin përmendësh dhe shkoi në kërkim të diturisë tek eminenca e tij, eruditi, Abdurrahman ibën Nasir es Sa'dij-Allahu e mëshiroftë, i cili konsiderohet shejhi i tij i parë, të cilin e shoqëroi dhe nga ai mësoi Teuhidin, Tefsirin, Sire-n (biografinë e Muhammedit a.s.), Hadithin, Fikhun, Usuli Fikhun, Feraidin (e drejta e trashëgimisë), Terminologjinë e Hadithit, Nahv-in (sintaksa arabe), Sarf –in (morfologjia arabe), dhe nga ky shejsh shumë përfitoi meqë ai ishte shumë i pajisur me dituri, vepër, zuhd, devotshmëri, modesti dhe zemërgjërësi. Pati poashtu ndikim nga menhexhi i tij i shëndoshë dhe metodologjia e tij e veçantë në mësimdhënie dhe paraqitjen dhe afrimin e dijes tek studentët.

Kurse shejhi i tij i dytë ka qenë eminenca e tij shejsh Abdulaziz ibën Abdullah ibën Bazrahimehullah-mufti i përgjithshëm i Arabisë Saudite dhe kryetari i K.U.M. dhe i drejtorisë së Kërkimeve Shkencore dhe Fetvasë, tek i cili ka mësuar Sahihul Buhari-un dhe disa veprat e Shejhul Islam-it Ibën Tejmije-s dhe libra nga Fikhu.

Veprat dhe aktiviteti i tij shkencor: Që nga vdekja e shejsh Sa'di-ut-rahimehullah-shejsh Uthejmini u bë imam i xhamisë së madhe në Unejze dhe jepte mësim në të siç jepte mësim në Fakultetin e Sheriatit dhe atë të Usuli Dinit në filialën e Universitetit Islamik „el Imam Muhammed ibën Saud“ në Kassim.

Shejhi pati aktivitet të bujshëm dhe mund të pakursyer në fushën e da'ves, mësimdhënie, shkrimin e librave, dhënien e fetvave, shkrimin e mesazheve dhe mbajtjen e ligjëratave të përgjithshme të dobishme në Mesxhidul Haram (Qabe) dhe Mesxhidi Nebevij (xhaminë e Pejgamberit, sal-lall-lahu alejhi ve sel-lem.) dhe në qytete të ndryshme në Mbretërinë e Arabisë Saudite me një metodë të dalluar me ertësi dhe këshillë të mirë dhe paraqitjen e një menhexhi të gjallë të Selefi Salihit.

Prej veprave të tij-rahimehullah: Si mësimdhënës filloi qysh në v.1370 h. në xhaminë e madhe në Unejze në një përmasë të ngushtë në kohën e Sa'di-ut, kurse pasi e mbaroi Institutin Shkencor në Rijad, u emërua mësimdhënës në Institutin Shkencor në Unejze në vitin 1374 h. Në vitin 1376 vdiq shejhi i tij es Sa'di-u dhe pas tij u bë imam dhe hatib i xhamisë së madhe në Unejze dhe mësimdhënës në bibliotekën kombëtare e cila ishte në kuadër të xhamisë e të cilën e kishte themeluar shejhi i tij në vitin 1359 h. Pasi u shtuan shumë talebet (studentët) dhe biblioteka u bë e pamjaftueshme për ta, filloi të japë mësim në të njejtën xhami dhe atij iu tubuan shumë studentë prej brenda dhe

jashtë Mbretërisë Saudite ku numri i tyre arriti në qindra sish. Këta nuk prezentonin vetëm për t'i dëgjuar mësimet por edhe i mësonin ato. Ai vazhdoi punën e tij si mësimdhënës, imam dhe hatib në xhaminë e tij derisa vdiq-rahimehullah.

-Vazhdoi si mësimdhënës në Institutin Shkencor në Unejze deri në vitin 1398 h.dhe kah fundi i kësaj periudhe mori pjesë në antaresinë e Komisionit Planpërpilues Programor dhe planprogramin e Instituteve Shkencore në Universitetin Islamik "el Imam Muhammed ibën Saud"ku ishte autor i disa planprogrameve mësimore.Pastaj vazhdoi si mësimdhënës në filialën e Universitetin Islamik "el Imam Muhammed ibën Saud"në Kassim, në Fakultetin e Sheriatit dhe atë të Usuli Dinit që nga viti shkollor 1398/1399 h. e deri kur vdiq-rahimehullah-.

-Ka dhënë mësim në Mesxhidul Haram (Qabe) dhe në Mesxhidu Nebevij (xhaminë e Pejgamberit a.s.në Medine) gjatë sezonave të Haxhit , muajit të Ramazanit dhe pushimeve verore.

-Ka marrë pjesë në Komisione Shkencore Ekspertësh të shumënumërta brenda Mbretërisë Saudite.

-Ka mbajtur ligjërata brenda dhe jashtë Mbretërisë Saudite përmes telefonit.

-Udhëhoqi kryesinë e "Shoqatës Humanitare për Mësimin e Kur'anit famëlartë Përmendësh" në Unejze që nga themelimi i saj në vitin 1407 h.e deri në vdekjen e tij.

-Ka qenë anëtar i Mexhlisit (Këshillit) Shkencor pranë Universitetit Islamik "el Imam Muhammed ibën Saud" për dy vitet akademike 1398/1399 h. dhe 1399/1400 h.

-Ka qenë anëtar në Mexhlisin e fakultetit të Sheriatit dhe të Usuli Dinit dhe Kryetar i Katedrës së Akides në to.

-Ka qenë anëtar i „Këshillit të Ulemave të Mëdhej“ (K.U.M.)në Mbretërinë e Arabisë Saudite që nga viti 1407 h. e deri në vdekje.

-Krahas veprave të çmuara dhe përgjegjësiive të mëdha, ai kishte kujdes të veçantë për dobinë e njerëzve me fetva dhe kryerjen e nevojave të tyre gjatë natës dhe ditës, në prezencë dhe gjatë udhëtimit dhe gjatë ditëve kur ishte i shëndoshë dhe i sëmurë.

-Siç e obligonte veten me takimet e dobishme shkencore dhe shoqërore të sistemuara dhe të programuara, ai i mbante takimet e sistemuara favore me gjykatësit e Regjionit të Kusejmit, me anëtarët e "Këshillit për Urdhër në të Mirë dhe Ndalim nga e Keqja"në Unejze, me hatibët e qytetit të Unejzes, me studentët e mëdhej të tij, me studentët në konvikt, me anëtarët e Këshillit Drejtues të "Shoqatës Humanitare për Mësimin e Kur'anit famëlartë Përmendësh"dhe me anëtarët e Pjestarëve të Katedrës së Akides pranë filialës së Universitetit Islamik "el Imam Muhammed ibën Saud" në Kusejm.

-I mbante takimet e përgjithëshme, prej tyre takimin javor e mbante në shtëpinë e tij, kurse takimin mujor në xhaminë e tij dhe takimet sezonale vjetore të cilat i programonte i mbante jashtë qytetit të tij. Jeta e tij pra, ishte e bujshme me dhënie, aktivitet dhe vepër të çmuar kështu që i bekuar ishte kudo që shkonte sikur shiu prej qielli, ku bie bën dobi.

-U shpall lajmi për fitimin e tij "Çmimin Ndërkombëtar të Mbretit Fajsal" për shërbim Islamit për vitin 1414 h.dhe Komisioni Selektues në justifikimin e tyre për fitimin e shejhut "Çmimin"në fjalë, theksuan këtë që vijon: Së pari:pajisja e tij me virtyte të larta të Ulemave nga të cilat më të dalluara janë devotshmëria, zemërgjërësia, thënia e të vërtetës, të vepruarit në interes të muslimanëve dhe këshillimi i njerëzve në mënyrë të veçantë dhe të përgjithëshme.

Së dyti: dobia e shumtë e njerëzve nga dituria e tij përmes dhënies së tij mësim, fetva dhe shkrimit të librave.

Së treti: mbajtja e tij ligjërata të përgjithshme të dobishme në vende të ndryshme brenda Mbretërisë Saudite.

Së katërti: pjesëmarja e tij konstruktive në Kongrese të mëdha Islamike.

Së pesti: ndjekja e një metode të dalluar në Da've në Allah dhe Va'z të mirë brenda Mbretërisë Saudite dhe paraqitja e tij një shembull të gjallë të Menhexhit të Selefi Salihit në të mënduar dhe sjellje.

-Ka pasur -Allahu e mëshiroftë-një erudicion të madh për Sheriatin e Allahut s.v.t. dhe tërë jetën e kaloi në rrugën e diturisë dhe nxënies së tij, pastaj ua mësonte dhe e përhapte atë në mesin e njerëzve çdoherë i pajisur me argumentim të shëndoshë, analizim të drejtë, siç ka qenë jashtzakonisht i kujdesshëm t'i përmbahet akides së Selefi Salihit në dituri, vepër, da've dhe sjellje kështu që veprat e tija shkencore dhe Menhexhi i tij në Da've ishte po në atë Menhexh të shëndoshë. Allahu fuqplotë i kishte dhënë aftësi të madhe në prezentimin e ajeteve dhe haditheve për përforcimin e argumentit dhe deduktimin e hukmeve (dispozitive) dhe dobive dhe ai në këtë fushë ka qenë dijetar në diturinë dhe precizitetin e deduktimit të hukmeve dhe dobive dhe në gjërësinë e fikhut dhe njohurisë së tij në fshehtësitë e gjuhës arabe dhe retorikës së saj, nuk ka patur mundësi t'i hudhet pluhur përmbi.

-Kohën e tij e ka kaluar në mësimdhënie, arsim, ifta (dhënie fetva), kërkim, verifikim dhe ka patur ixhtihad. Ai ka patur zhjedhje dhe ixhtihade të mirëpritura. Vetes nuk i lente kohë për pushim sa që edhe kur ecte në këmbë prej shtëpisë së tij e deri në xhami dhe në kthim për në shtëpi, njerëzit e pritnin dhe ecnin bashkë me të duke e pyetur, e pastaj ky u përgjigjeje dhe ata i shënonin përgjigjet dhe fetvatë e tij.

-Ai-rahimehullah-ka pasur një metodë të shkëlqyer arsimore dhe të veçantë. Ai pyeste dhe diskutonte që kështu ta mbjellë vetëbesimin në shpirtat e nxënësve. I mbante mësimet dhe ligjëratat me plot vullnet, aktivitet dhe interes të madh dhe kalonte orë të tëra pa u mërzhitur fare, bile në të e gjente kënaqësinë dhe dëshirën e tij vetëm për shkak të përhapjes së diturisë dhe afrimit të saj tek njerëzit.

Nga aktivitetet dhe përpjekjet e tij shkencore:

1- Në arsim ka punuar që nga viti 1370 h. e deri në natën e fundit të muajit Ramadan të vitit 1421 h. (më shumë se gjysëm shekulli)- Allahu e mëshiroftë me mëshirë të gjërë. Mësimdhënien e kishte të përditshëm, kurse në disa pjesë të vitit brenda një dite mbante edhe më tepër se një hallkë shkencore.

-Jepte mësim në Mesxhidul Haram dhe Mesxhidi Nebevij gjatë sezonave të Haxhit, Ramazanit dhe pushimeve verore.

-Ka dhënë mësim në Universitetin Islamik "el Imam Muhammed ibën Saud".

-Ka dhënë mësim përmes telefonit brenda dhe jashtë Mbretërisë Saudite nëpër qendrat islamike.

2-Mbante ligjërata të përgjithëshme, të drejtpërdrejta dhe mësimet nëpër xhamitë brenda Mbretërisë Saudite, sa herë që shkonte në vizitë të ndonjë regjionit.

3-Aspekti i Va'zit, i cili ka qenë një ndër preokupimet kryesore të tij, i kushtoi një pozitë të veçantë dhe bukur shumë në mbajtjen e derseve të tij.

4-Kujdesi i tij për orientimin dhe udhëzimin e talebeve dhe durimi i tij në mësimin e tyre dhe durimi i tij në pyetjet e shumta të tyre dhe kujdesja e tij për çeshtjet e tyre.

5-Mbajtja e hutbes nga xhamia e tij nga xhamia e tij në Unejze në të cilën u dalluan hutbet e tij me sqarimin e hukmeve të ibade-

teve dhe marëdhëniet ndërnjerëzore dhe rastet e tyre sipas ndodhjeve, sezonave kështu që të gjithat kanë qenë frytdhënëse dhe realizuese të qëllimit fetar.

6-Takimet shkencore të sistemuara dhe të programuara javore, mujore dhe vjetore.

7-Fetvatë për të cilat Allahu i mundësoi praninë të lehtë në mesin e njerëzve kështu që ishin të kënaqur në fetvatë dhe zgjedhjet e tij.

8-Distribimi përmes mjeteve të informimit si radio, gazetë dhe përmes kasetave që sa më lehtë të përdoren dhe dëgjohen.

9-Së fundi u kurorëzuan përpjekjet e tij shkencore dhe shërbimi i madh që ua ofroi njerëzve në veprat e shumënumërta me vlerë të çmuar shkencore.

Veprat e tij në libra, mesazhe dhe sqarime shkencore arritën horizontet me famë, të cilave talebet u afruan nga anët e botës. Veprat e tij numrohen në më shumë se 90 libra dhe mesazhe dhe assesi nuk i harojmë ato thesaret e çmuara shkencore që ruhen në kasetat e derseve dhe të ligjëratave të cilat vlerësohen se janë me orë të tëra. Allahu i madhëruar e nderoi këtë dijetar të nderuar në kohën dhe jetën e tij, andaj pra i lutej Allahut s.v.t. që çdo hap të tij që e ka ndërmarë në përpjekjet e tij të hajrit dhe të dobishme, ta vënë në mizandin e punëve të mira të tij Ditën e Kijametit, që do ta përgatitin për në pozitën e shehidëve dhe salihinëve në afërsi të Zotit të botërave.

Disa ndriçime nga cilësitë e tij personale: - Shejhi-Allahu e mëshiroftë-ka qenë një shembëlltë e mirë dhe e gjallë dhe dituria e tij nuk ka qenë vetëm mësim dhe ligjëratat që jepen para auditoriumit të studentëve por kanë qenë shembëlltë në diturinë e tij, modestinë, butësinë, devotshmërinë dhe vrytytet e tij të larta morale. U veçua me butësinë, durimin, qëndrueshmërinë dhe serio-

zitetin në kërkimin e diturisë, mësimin e saj të tjerëve, sistemimin e kohës së tij dhe përkujdesjen ndaj çdo çasti të jetës së tij. Ai ishte larg ngarkesave. Ka qenë kulmi i modestisë, vrytyteve morale, i cilësive të mira dhe shembëlltë në veprim, adhurim, zuhd dhe devotshmëri. Me fytyrën e tij shkëlqyese ishte shoqëror, përzihesh me njerëzit dhe kishte ndikim tek ata, në zemrat e tyre fuste gëzim. I lexojë njerëzit duke shqiptuar shehadetin nga gjallëria e tij, ndërsa gëzimi shëndriste në ballin e tij derisa i mbante derset dhe ligjëratat.

Ishte-Allahu e mëshiroftë-sentimental me të rinjtë, i dëgjonte, debatonte me ta dhe u jepte va'z edhe mësim me plot butësi. Ka qenë jashtzakonisht i kujdesshëm në praktikimin e sunetit në të gjitha punët e tij.

Nga devotshmëria e tij ishte se kishte shumë stabilitet në çështjet për të cilat jepte fetva. Nuk nxitonte në fetvanë para se t'ia shtroje argumentin dhe kur ndonjë fetva i bëhej e përzier dhe jo e qartë, thoshte: "prit të kujtohem mirë në këtë mesele" e fjalë të tjera, të ngjajshme me to nga të cilat nënkuptohet devotshmëria e tij dhe kujdesi i tij për analizim preciz në meselet e fikhut.

Vullneti i tij në rrugën e përhapjes së diturisë nuk pushoi, saqë edhe në udhëtimin e tij për mjekim në SH.B.A. gjashtë muaj para se të vdesë, organizoi një numër ligjëratash nëpër qendrat islame dhe u takua me një numër të madh amerikanësh dhe të tjerë dhe u dha va'ze e udhëzime dhe poashtu u priu si imam në namazin e xhumasë. Brengat e Ummetit islam i barti anekënd botës.

Ai -Allahu e mëshiroftë-e vazhdoi udhëtimin e tij mësimdhënës dhe të da'ves edhe pas kthimit të tij nga udhëtimi që e pati për mjekim dhe sëmundja e madhe nuk mundi ta ndalojë nga derset dhe udhëzimet në Haremin Mekkas (Kabe) deri pak ditë para vdekjes së tij.

E goditi sëmundja dhe e pranzi caktimin e Allahut kështu që u veçua me një shpirt durues, të pajtuar dhe shpërblimfitues dhe paraqiti një shembëlltyrë të gjallë dhe të mirë për të marrë shembull nga ai se si të veprojë besimtari me sëmundjen e bren-dëshme. E lutim Allahun e lartmadhëruar që në këto të ketë ngritje të pozitës së tij tek Zoti i botërave.

Ai -Allahu e mëshiroftë-i dëgjonte ankesat e njerëzve dhe i trajtonte nevojat e tyre sipas mundësisë që kishte dhe për këtë punë të hajrit kishte ndarë një kohë të caktuar çdo ditë për pranimin e këtyre çështjeve. Ai i përkrahte shoqatat bamirëse dhe ato për mësimin e Kur'anit famëlartë përmendësh (hifz). Allahu e kishte dhuruar për të gjitha dyert e mirësisë dhe hajrit dhe dobisë së njerëzve dhe me hak ka qenë institucion mirësie dhe shoqërie edhe atë me mirësitë e Allahut që ia jep kujt don Ai.

Vdekja e tij: Vdiq -Allahu e mëshiroftë-më 15/Sheval v.1421 h. (ditë e Mërkurë), duke lënë pas pesë djem: Abdullah, Abdurrahman, Ibrahim, Abdulaziz dhe Abdurrahim, Allahu

mbjell në ta hajr dhe bereket dhe i bëftë prej pasardhësve të mirë.

Pas namazit të ikindisë, ditën e Ejte më 16 Sheval v.1421 h. në Mesxhidul Haram (Qabe) ia falën xhenazen mijëra muslimanë të cilët e përcollën deri tek varri në një numër thujse të pamundur të numrohet. Pas-taj të nesërmen, pas namazit të xhumasë në të gjitha qytetet e Mbretërisë Saudite dhe jashtë saj ia kanë falur xhenazen në mungesë (salatul gaib) poashtu një numër jashtzakonisht i madh. U varros në Mekke mukerreme -Allahu e mëshiroftë-, pas një jete që e mbushi me dituri, mësim dhe udhëzim dhe me vdekjen e tij muslimanët janë goditur me musibet të madh.

Kohëve të fundit është parë në ëndërr duke bërë lutje të përzemërt për atë që mësimet e tij i zbret në internet-faqe.

Allahu e mëshiroftë shejhun me mëshirën e tij të gjërë dhe e gradoftë me xhenetet e Tij të pakufijshme. Allahu e shpërbleft nga Islami dhe Muslimanët me shpërblimet më të mira për atë që ka bërë...

...Allahumme Amin!

Marrë nga: www.islamway.com

Përktheu: Emin Limani

03.10.2003

Abdul Ganij El Makdisij

Kush është Abdul Ganij El Makdisiu: Quhet Abdul Ganij ibën Abdul Vahid ibën Alij ibën Surur El-Xhemaili El-Makdisij El-Hanbeli. Lindi në vitin 541H në Bejtul Makdis në vitin në të cilin lind Imam Muveffek ibën Kudame nga i cili dallohet për shkak të animit kah hadithi në kohë që ibën Kudameja anonte ka lëmia e fikhut. Udhëtoi

në Bagdad për të mësuar dhe atje u takua me shumë dijetarë të njohur siç ishte: Abdul Kadir El Xhejlani dhe Ibën Munij biografinë e të cilit e shkroi. Pas Bagdadit udhëtoi në Egjipt, Esbahan, në të cilët u takua me dijetarët e vendit, përfitoi prej tyre, që më vonë të kthehet në Damask ku e përfundoi udhëtimin në kërkim të diturisë.

Mbi moralin e tij:

Në Damask ai filloi të mirret me shkrim, ligjërata dhe përshkrim të librave të dijetarëve. Abdul Ganij ishte i njohur me ibadetin e tij, modestin dhe ndjekjen e selefit në të gjitha sferat e jetës. Urdhëronte në të mira dhe ndalonte prej të këqijave, gjë e cila shkaktoi konfliktin mes tij dhe dijetarëve të bidatit, ashtu që ishte i sprovuar me shumë sprova. Këto sprova do ti gjeni shumë në biografite të dijetarëve muslimun (përmirësues), ishte bujar, bamirës ndaj njerëzve, modest dhe krenar.

Disa fjalë të dijetarëve për Hafidh Makdisiun:

Hafidh Dija El Makdisij ka thënë: Kur e pyetnin për ndonjë hadith e kujtonte në moment dhe fliste për të duke e vlerësuar si të saktë apo si të dobët. Kështu ishte puna edhe me transmetuesit e hadithit.

Ibën Rexhebi ka thënë: Hafidh Abdul Ganij El Makdisij, Prijësi i besimtarëve në hadith.

Është parë duke lexuar libra të tëra të hadithit me senedet e tyre në minberin e xhamisë në Damask.

Et-Taxh El Kindi ka thënë: Pas Darekutniut nuk ka pasur Hafidh si puna e Abdul Ganij El Makdisiut.

Ibën Nexhxhari në librin e vet ka shkruar: "...ka shkruar libra bukur të mira në lëminë e hadithit, kishte kujtesë të bujshme dhe dituri të gjërë në të gjitha degët e hadithit... (Dhejl Tabekatil Hanabile 2/7-8 të autorit Ibën Rexheb)

Veprat e tij:

Numri i librave që i shkroi kalon 40-shin.

Në mesin e tyre do të përmendim:

El Misbah fi ujuni el ehadith es-sihah

Tuhfetut-talibin fil xihadi vel muxhahidin

Mihnetul Imam Ahmed

Fedailu Mekke

Dhemmur-rija

El Xhami' Es-Sagir li ahkam el Beshir en-Nedhir

El Athar el murdiije fi fedaili hajril berijje

Umdetul ahkam (ky libër) dhe të tjerë

Shumica e tyre shqyrton çështje të besimit (Teuhid), Fikhut, Hadithit, Këshilla për moralin dhe biografite të disa personaliteteve të shquara.

Vdekja e tij:

Ndëroi jetë ditën e Hënë me 23 Rebi'ul Evvel në vitin 600 sipas hixhrit. All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e Tij të gjërë.

Përgatiti: **Talha Kurtishi**

10.10.2003



Imam Hasan el-Basri

I zgjedhuri i kohës së tij në dituri dhe adhurim, Shejhu i Basrasë, njeriu që fliste me perla të urtësisë nga trashigimia e Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-leme]. Prej tabi'inëve të cilët i lavdëroi i Dërguari i All-llahut [sal-lallahu alejhi ve sel-leme]. Fjalët janë të paafata të përshkruajnë këtë njeri që kuptoi realitetin e kësaj bote dhe duke ia kthyer shpinën kërkoi atë që All-llahu [subhanehu ve teala] e ka përgatitur për robërit e tij të sinqertë.

Quket Hasan ibën Ebil Hasen Jesar Ebu Se'id meula (rob i liruar) i Zejd ibën Thabit El Ensari sipas disa historianëve meula (rob i liruar) i Ebi Jusr Ka'b ibën Amër Es-Sulemi.

Është lindur në kohën e hilafetit të Omerit [radijall-llahu anhu] gjegjësisht dy vjet para përfundimit të tij. Sipas disa transmetimeve fëmijërinë e ka kaluar në Medine ku gji i ka dhënë Nëna e besimtarëve Ummu Seleme (vlen të përmendet se këto transmetime janë të dobëta për shkak të senedit jo të plotë-mursel)

Kur'anin e ka lexuar para Hittan ibën Abdil-la Er-Rekashi

Është takuar me shumë As-habë të Pejgamberit [sal-lallahu alejhi ve sel-leme] dhe ka transmetuar hadithe prej: Imran ibën Husajnit, El Mugire ibën Shu'be, Abdur-Rahman ibën Semure, Semure ibën Xhundub, Ebi Bekrete, En-Nu'man ibën Beshirit, Xhabirit, Enesit, Amër ibën Teglubit dhe shumë të tjerë All-llahu [subhanehu ve teala] qoftë i kënaqur me të.

Është takuar edhe me Uthmanin dhe Talha ibën Ubejdil-lahin [radijall-llahu anhu]

Ai poashtu ka përfutuar edhe prej shumë dijetarëve të tabi'inëve. Nxënës që më shumë kanë transmetuar prej tij janë

Humejd Et-Tavili, Ibën Auni, Thabit El Bunani, Malik ibën Dinari dhe Ebu Esh-hebi.

Disa fjalë të dijetarëve për Hasan El Basriun:

Katadeja [radijall-llahu anhu] ka thënë: Ju këshilloj të uleni me këtë dijetar sepse nuk kam parë njeri që aq shumë i përngjan Umerit [radijall-llahu anhu].

Enesi [radijall-llahu anhu] thoshte: Pyetni Hasanin sepse ai i ka mbajtur mend (dituritë e fesë) e ne i harruam.

Humejdi thoshte: Askush si Hasani nuk kishte tipare të plota të burrërisë.

El Avvam ibën Havsheb ka thënë: Sa shumë i përgjante Hasani Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Ebu Berdete ka thënë: Nuk kam parë njeri që aq shumë u përngjan shokëve të Resulullahut, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, si Hasani.

El Ata ka thënë: Kapu për këtë njeri, është Imam i madh që duhet përcjellur.

Er-Rebi' ibën Enes ka thënë: Dhjetë vjet me radhë mësonim tek Hasan El Basriu dhe çdo ditë sjellte diç të re.

Auf ibën El A'rabi thoshte: Ashkush si Hasan nuk e njihje rrugën e xhennetit.

Ibën Sa'di ka thënë: Hasan El Basriu ishte njeri që kishte tubuar dituri të shumtë, fekih i besueshëm, autoritet besnik, fliste gjuhën e pastër, i dalluar në devotshmëri, i bukur dhe i pashëm...

Disa qëndrime dhe fjalë të Hasan El Basriut:

Kur fliste fjalët e tij ishin plotë urtësi, fjalët e tij u përngjanin fjalëve të Pejgamberëve.

Kur e transmetoi hadithin e minberit në të cilin tregohet rasti i drurit mbi të cilin i mbante hutbet dhe i cili qau për shkak të largimit të Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, qante dhe thoshte: O robër të All-llahut pse

s'po qani nga mallëngjimi për të Dërguarin e All-llahut [sal-lallahu alejhi ve sel-leme].

Thoshte: O biri i Ademit, ai që e lexon Kur'anin dhe beson në të i zgjatet pikëllimi, frika dhe të qajturit.

Thoshte: Fekih i vërtetë është asketi në këtë botë, që e njeh mirë fenë e tij dhe që është i përpikur në adhurim.

Thoshte: Atë që e madhëron dinarin do ta mposht All-llahu [subhanehu ve teala].

Thoshte: Sa shokë të këqij janë dynjaja dhe pasuria e saj nuk të bëjnë dobi përderisa nuk ua kthen shpinën.

Thoshte: Të larguarit prej mëkatit është gjë me e lehtë prej pendimit prej tij. Ç'është garanca yte se do të arrishë të pendohesh para se të mbyllet dyert e pendimit?

Thoshte: Po qeshim dhe harrojmë se All-llahu në hollësi i di veprat tona.

Thoshte: Dituria shihet në modestinë e njeriut në mënyrën e të folurit dhe të shikuarit.

Thoshte: Vdekja i prish kënaqësitë e dynjasë dhe nuk le vend për gëzim tek i mençuri.

Thoshte: O biri i Ademit ti nuk je gjë tjetër përpos disa ditëve të numëruara kur të shkon një ditë ka shkuar edhe një pjesë e ytja.

Thoshte: Besimtar i vërtetë është ai që beson në fjalët e All-llahut ashtu siç i ka thënë, që bën vepra të mira dhe ka frikë që të mos pranohet nga All-llahu. Bamirësia e tij ia shton devotshmërinë dhe mirësinë.

Thash: All-llahu e mëshiroftë Hasan El Basriun Fjalët e tij me të vërtetë u përgjajnë fjalëve të Pejgamberëve.

Ndërroi jetë në muajin Shaban të vitit 110 H All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

Mexhdi Arefat

Marrë nga: <http://www.altawhed.com/>

Përshtati: Talha Kurtishi

17.10.2003

El Al-lame Muhammed Ibën Ibrahim Alu Shejh

Leximi i historisë dhe të biografive në veçanti ndikon në lexuesin e tyre duke e nxitur që të ndjekë rrugën e të parëve që kanë vërtetuar kuptimin e sakrificës dhe vetëfljimit në shërbim të fesë. Nëse kësaj dobie ia bashkangjesim faktin se njeriu për të cilin do të flasim ishte i dalluar me devotshmërinë, bamirësinë dhe trimërinë në përhapjen e fesë atëherë shumëfishohen dobitë e leximit...

Ky njeri ishte burrë i llojit të vjetër të burrave i cili në vetën e tij, si dhunti hyjnore, përmbodhi tiparë që ishin të mjaftueshme

që të shpallët si Imam i kohës së tij...

Quhet El Imam El Al-lame, oqeani i dijes i dalluari në zgjuarsin Muhammed ibën Ibrahim ibën Abdul-Latif ibën Abdur-Rahman ibën Hasen ibën Shejhul Islam Muhammed ibën Abdul Veh-hab Et-Temimi. Ishte njëri prej vargut të bekuar të dijetërëve pasardhës të Imamet Muhammed ibën Abdul Veh-hab i cili u dëshmuar si reformator i kohës së tij, i cili punoi dhe luftoi që të pastrohet vatra e Pejgamberit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, nga mbeturinat e shirkut dhe politeizmit që kishin marrë përmasa të gjëra.

Ka lindur me 10 Muharrem të vitit 1311H (ditën e Ashurasë) prej nënës Xheuhere e cila ishte e agjerueshme ditën kur e lindi.

Në këtë shtëpi të diturisë shejhu u edukua në mënyrën më të mirë. Para moshës gjashtë vjeçare filloi kërkimin e diturisë, mësoi Kur'anin përmendsh dhe u ul para shumë dijetarë që më vonë të hendi keq për shkak të humbjes së aftësisë së pamurit në moshën 17 vjeçare, gjegjësisht në vitin 1328H

Gjatë kërkimit të ditursë përfitoi prej:

Abdur-Rahman ibën Mufejrixhit tek i cili mësoi Kur'anin

Abdull-llah ibën Abdul-Latif (axha i tij) filloi mësimin para tij para se të humbë të pamurit

Sa'd ibën Hamed ibën Atik

Abdull-llah ibën Rashid tek i cili mësoi rregullat e ndarjes së trashigimisë (Feraidin)

Muhammed ibën Abdul Aziz ibën Mani'

Veprimtaria e tij:

Ka qenë gjykatës dhe këtë post e mbajti gjashtë muaj.

Ushtri postin e Imamit në xhaminë njohur me emrin e tij dhe hatib në xhaminë e madhe në Rijad.

Mbante ligjerata të rregullta pas namazit të sabahut, në kohën e duhasë dhe pas iqindisë në disa raste.

Ishte kryemyftiu i vendit edhe para se të hapët zyrtarisht si myfti i Saudisë në vitin 1374 kur u hap Zyra e Fetvave në Arabinë Saudite.

Ushtri postin e kryetarit të Kryesisë së Instituteve shkencore që u hapën në Arabinë Saudite dhe shumë institucioneve shtetërore që kanë të bëjnë me çështjet e fesë.

Ushtri postin e kryetarit të këshillit inicues për formimin e Rabitasë.

Në vitin 1380H me iniciativën e tij u hap Univerziteti Islamik që ishte dedikuar për ar-

simin fetar e muslimanëve që jetojnë jashtë Arabisë Saudite.

Disa cilësi dalluese të shejhut:

Ka qenë i zgjuar, i mençur, me kujtesë të fortë. Një shoqëruar i tij që e ka shoqëruar 18 vjetë thotë: Këto vite që isha me shejhun nuk ka ndodhur që ndokush ti gjenë gabim gjatë leximit të Kur'anit. Ishte i prerë dhe i vendosur, nuk bënte lëshime. Për këtë dëshmojnë edhe nxënësit e tij.

Ishte modest dhu nuk pëlqente që të lavdërohet me fjalë. Kur ndokush i thoshte Eminenca e tij Shejhu apo Myftiu thoshta All-llahu na i falë mëkatët. Ishte i përmbajtur në shumë raste nuk është përgjigjur ose e ka vonuar përgjigjen disa ditë.

Respektonte kolegët e tij, mësuesit dhe dijetarët në përgjithësi. Nuk lejonte që masa e thjeshtë të flet për këto dijetarë pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gjëra të argumentuara apo të paargumentuara.

Nuk lejonte të mirren nëper këmbë ligjet e fesë, kishte kujdes të veçantë për kohën dhe për shfrytëzimin e saj. Edhe në çastet e pushimit kujdesej që të përfiton dhe të përfitojnë të tjerët.

Nuk folte për jetën e tij private, në veçanti për adhurimet që i bënte. Në vetmi miku itij ishte Libri i All-llahut.

Ishte zemërbardhë, i çiltër, nuk lejonte që në praninë e tij të përgojohen njerëz apo të transmetohen fjalë me qëllim të prishjes.

Pas jetës së tij të begashme dhe të frytshme në shërbim të fesë përfundoi jeta e tij pas një sëmundje me 24 Ramazan 1389H dhe u varros në varrezat (El'Ud) pasiqë ia fali xhenazën myftiu i ri Abdul Aziz ibën Baz, rahimehull-llah.

All-llahu e mëshiroftë me mëshirën e tij të gjërë.

Përgatiti: Talha Kurtishi,

24.10.2003

Pyetje dhe përgjigje

Tema: Agjërimi

Numri: 738

Data: 21.03.2001

Pyetja: Esselamu Alejkum dëshiroj të pyes për një hadith që e kam dëgjuar prej një hoxhe që thotë se i Dërguari sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem ka thënë kur të bëhet iftari dhe dikush e shtynë një minute dhe më vonë nuk bën iftar atëherë për atëherë ,agjërimi i tij atë ditë llogaritet i pa vlefshem. A është hadith i vërtetë apo jo dhe cili është kuptimi i këtij hadithi. Faleminderit për mirëkuptim, esselamu alejkum.

Përgjigjja: All-llahun e falënderojmë, paqja dhe bekimi qofshin për Muahmmedin. Ky hadith nuk është i vërtetë, madje nuk mund të gjindet në librat e hadithit, andaj edhe domethënia e nxjerrur nga ky hadith nuk është e vërtetë. All-llahu e di me se miri

Bekir Halimi,

02.04.2003

Numri: 587

Data: 26.02.2001

Pyetja: Ju lutem më tregoni nëse njeriu në agjërim gjatë Ramazanit duke shiquar ndonjë femer ejakulon pa dashje, qka duhet bërë dhe a duhet agjëruar atë ditë apo edhe më teper, dhe si duhet agjëruar si kompenzim.

Përgjigjja: Jo kjo vepër nuk e prish agjërimin, nëse nuk ka qenë mastrubim, e nëse ka qenë mastrubim, atëhere te dijetarët ka dy mendime:

Një: e prish agjërimin sepse kjo është në kundërshtim me qëllimin e agjërimin, pakësimin e epsheve, dhe

Dy: nuk e prish sepse nuk ka argument për këtë gjë. Sidoqoftë njeriu duhet larguar mastrubim gjatë agjërimin. All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,

26.02.2001

Numri: 556

Data: 22.02.2001

Pyetja: Tani jemi në muajin e Ramazanit,e une flej deri disa minuta para iftarit a me pranohet mua agjerimi?

Përgjigjja: Agjërimi është në rregull, mirëpo nuk është e pëlqyeshme që muslimani tërë ditën të flejë e ti lë pas dore obligimet që i ka ndaj fesë dhe ndaj familjes.

Bekir Halimi,

22.02.2001

Numri: 555

Data: 22.02.2001

Pyetja: A lejohet ne islam qe gruaja te perdori bakam ne buzet e saja gjate muajit te Ramazanit.

Pergjigjja: Sa i perket perdorimit te makjazhit gjate ramazanit, kjo lejohet, mirepo ne mosprezence te njerzve te huaj per ate grua. Doemthene gruas i lejohet zbkurimi, nese nuk ka te pranishem ne ate vend burra te huaj per ate grua, dhe kjo aspak nuk e demton agjërimitin e saj. All-llahu e di me se miri.

Bekir Halimi,

22.02.2001

Numri: 416

Data: 05.12.2000

Pyetja: Kisha pasur deshire te pyes se a lejohet qe gjate agjërimit dhe pas agjërimit te kryhen vepre seksuale jo me ndonje femer po vetem ne enderra seksuale.

Pergjigjja: Falnderoj All-llahun dhe paqa dhe bekimi qofshin Mbi Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Vella i nderuar. Nese ne musliman gjate agjërimit enderron dhe ejakulon, kjo vepër nuk e prishë agjërimitin, mirepo nese ai masturbon, ketu ka dy mendime kryesore: ne qe e prish agjërimitin dhe ne qe nuk e prishë. Mirepo ma e sigurtë eshte qe t'i largohesh kesaj vepre ne ketë muaj, se ky muaj eshte qe ta kufizon epshin, per ketë edhe mund te ta prish agjërimitin.

Bekir Halimi,

30.01.2001

Numri: 367

Data: 06.02.2001

Pyetja: Es-selamu alejkum a mund te agjërojme me disa nijete ne ditë agjerimi p.sh. Agjëroj ditën e enjte me nijetin e saj, por ne kohesisht eshte edhe muaji Sheual, po ashtu kam edhe ne zotim per te kryer, etj. A me quhet qe i kam agjëruar keto vetem po te agjëroj ne ditë vetem me duke e bere nejet per gjitha qe kam per te agjëruar por qe barazohen me ne ditë? Nese nuk jam e qarte ju lutem me shkruani ne e-mail per sqarime. All-llahu ua shperblefte!

Pergjigjja: Falenderojme All-llahun kurse paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin alejhis-selam. Mundet te agjërosh me disa nijete ne agjërimit, mirepo shperblimi eshte me i vogel sesa kur te agjërosh secilin agjërimit me ditë ne vehte. Nese ne vepër shperblehet dhjetë fish per verpim e ne herë per nejet, atëherë nese ne ditë agjëron me p.sh., katër nejet, i ke 14 sevape, e nese e agjëron çdo ditë me nejet te vetin, i ke 40 sevape, ky eshte dallimi. Mirepo ne esence ben te besh keshtu. Kjo eshte fetvaja te cilën na e ka dhene shejh Albani, All-llahu e meshirofte. All-llahu e di me se miri.

Bekir Halimi,

28.02.2001

Numri: 287

Data: 20.01.2001

Pyetja: Esselamu alejkum jam kureshtare të dij mbi plotësimin e ditëve të lëshuara gjatë muajit të Rramazanit (per shkak të pengesave mujore), a duhet qe ato të plotësohen pa i ndërprerë ditet, apo jo me ditë të pa ndërprera? Ju faliminderit per mirëkuptimin Esselamu alejkum

Përgjigjja: Falënderojmë All-llahun, kurse salavatet dhe selamet qofshin mbi Muhammedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem. E nderuara motër. Plotësimi i ditëve të lëshuara gjatë muajit të ramazanit, mund të bëhet edhe rend, pa ndërperë që është gjëja ma e mirë, por edhe të ndërprera, nëse ka nevojë,

Bekir Halimi,

30.01.2001

Numri: 199

Data: 25.12.2000

Pyetja: A ben te lahesh në goje kur je me Ramazan

Përgjigjja: Falënderojmë All-llahun, kurse paqa dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Vëlla i nderuar. Nuk ka problem nëse lahet muslimani gjatë ditëve kur është duke agjëruar. Larja aspak nuk e dëmton agjërimin.

Bekir Halimi,

02.02.2001

Numri: 179

Data: 20.12.2000

Pyetja: Këtë pyetje e bën një shoqe e imja; a është ndonjë mëkat që në muajin e Ramazanit të hyj në ndonjë lokal, d.m.th. pas iftarit sepse ajo e agjëron muajin e Ramazanit

Përgjigjja: Nuk është e lejuar për një vajzë muslimane të shkon dhe të qendron në lokal, sidomos në ato lokale ku ka alkool. Sidomos gjatë muajit të Ramazanit që është muaj i adhurimeve dhe veprave të mira e jo qëndrimit në lokale! All-llahu e di më së miri!

Bekir Halimi,

22.02.2001

Numri: 162

Data: 16.12.2000

Pyetja: Si mund të agjëroj Ramazanin kur nuk më lejojin prindrit

Përgjigjja: Es-selamu alejkum ve rahmetull-llahi ve berekatuhu. Vëlla i nderuar! Muslimani fillimisht duhet t'i rrespektojë obligimet që i ka ndaj All-llahut e pastaj obligimet që i ka ndaj prindërve. All-llahu në Kuran thotë: "Adhuroni All-llahun e mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ...". Nisa: 36.

Domethënë se sjellja e mirë ndaj prindërve vjen pas adhurimit tonë ndaj All-llahut. Ky është obligimi ynë i parë dhe kryesor. Pastaj vjen sjellja jonë ndaj prindërve me kusht që mos të na largojë nga obligimet fetare që i kemi.

Pejgamberi alejhisselam thotë: "Nuk respektohet krijesa në bërje mëkat ndaj Krijuesit". (hadith i vërtetë)

Për këtë ti duhet të agjërosh pa marrë parasysh se nuk të lënë prindërit. Normalisht nëse je i moshërritur dhe ke hyrë në bylyk, ke arritur kohën kur obligohesh me detyrat fetare. All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,
02.03.2001

Numri: 158

Data: 15.12.2000

Pyetja: A është e obliguar të agjërojnë fëmijët 12 vjeçarë?

Përgjigjja: Falënderojmë All-llahun kurse paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Vëlla i nderuar. Nëse ky djal që i ka mbushur 12 vjet nuk ka hyrë në bylyk, nuk e ka obligim agjërimin, mirëpo është mirë ta agjërojë që të mësohet. E nëse ka hyrë në bylyk e ka obligim agjërimin. Kjo që thamë na dërgoni te njohja e kohës së bylykut. Njeriu hyn në bylyk ose me shenja, siç është ejakulimi në ëndër, dalja e qimeve në nënsjetull ose te vendet e turpshme, ose me vite, ku sipas haditheve të Pejgamberit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, kur t'i mbush djaloshi 15 vjet hyn në bylyk.

Bekir Halimi,
02.02.2001

Numri: 145

Data: 14.12.2000

Pyetja: Gjatë muajit të ramazanit kam ngrënë në mesin e ditës, kjo ka ndodhur para disa viteve kur kam qenë shumë i sëmurë çka duhet të veproj ?

Përgjigjja: Falënderojmë All-llahun, kurse paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Vëlla i nderuar. Nëse ke ngrënë gjatë ditës së Ramazanit nga shkaku i sëmurjes, këtë ditë duhet ta kompenzoshë me një ditë tjetër. Argument për këtë është ajeti Kuranor: "2:184. (jeni të obliguar për) Ditë të caktuara, e kush është i sëmurë prej jush ose është në udhëtim (e nuk agjëroi), atëherë ai (le të agjërojë) më vonë aq ditë. E ata që i rëndon ai (nuk mund të agjërojnë), janë të obliguar për kompenzim, ushqim (ditor), i një të varfëri ai që nga vullneti jep më tepër, ajo është aq më mirë për te. Mirëpo, po që se dini, agjërimi është më i mirë për ju".

Tani duhet ta kompenzosh këtë ditë.

Bekir Halimi,
02.02.2001

Numri: 141

Data: 14.12.2000

Pyetja: Es-selamu alejkum, vëlla i nderuar Bekir! Paqa dhe mëshira e Zotit qofshin mbi ju Nuk e di se a është edhe te populli arab kështu por te na në muajin e shenjtë të Ramadanit tani është normale që 10 deri më 20 minuta para se të falet namazi i sabahut të bëhet nijeti (me gojë!?) dhe të ndërprehet ushqimi i syfirit. Por në Kur'an është apo ekziston ajeti kur Zoti, subhane ve teala, thotë se: "hani deri sa të dallohet...". E tash si vëlla dua të të pyes se si ka vepruar Muhammedi a.s. në muajin e Ramadanit në syfyr, a ka hadithe?

Përgjigjja: ...Sa i përket nijetit me gojë kjo nuk ka bazë në fenë e All-llahut, nijeti bëhet me zemër. Vet ngritja jote për të ngrënë syfyr është nijet.

Pejgamberi alejhisselam ka thënë: "Hani dhe pini deri ta dëgjoni ezanin e Bilalit, sepse Abdull-llah ibn Umri Mektumi thërret ezanin gjatë natës" domethënë është e pëlqyeshme vonimi i syfirit deri në momentin e fundit, para se të thërret ezani, nëse ezani thërritet me kohë... All-llahu e di më së miri.

Bekir Halimi,

28.02.2001

Numri: 64

Data: 30.10.2000

Pyetja: Kur agjëroj të hënën dhe te ejten dhe te pyet dikush ndonjë shok ose dikush tjetër a don te hash a duhet unë ta prish agjërimin.

Përgjigjja: Falënderojmë All-llahun kurse paqja dhe bekimi qofshin mbi Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Vëlla i nderuar. Nëse ju jeni duke agjëruar agjërim vullnetar dhe nëse ndonjë vëlla të thërret në drekë, ti mbetesh të zgjedhish mes ngrënjes dhe vazhdimit të agjërimin, Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem thotë: "Kur të ftohet ndokush prej jush le t'i përgjigjet ftesës. Nëse është agjërues, le të bëjë dua (le të lutet për atë person), e nëse s'është agjërues, le të hajë". Muslimi.

Bekir Halimi,

31.01.2001

Hadithe mbi agjërimin

Transmetohet nga i dërguari i fundit i All-llahut, Muhammedi, paqja e All-llahut qoftë mbi të, se ka thënë: “Zoti i Madhëruar ka thënë: Çdo vepër e birit të Ademit i takon atij, përveç agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të. Agjërimi është mburojë (nga epshet dhe zjarri), prandaj kur të agjërojë ndokush le të mos flasë fjalë të ndyta dhe mos ta ngre zërin, e nëse dikush e ngacmon apo e sulmon, le të thotë: Unë agjëroj, unë agjëroj!”.

Dhe, pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti i Muahmedit, aroma e pakëndshme që del nga goja e agjëruarit është më e mirë tek All-llahu se sa era e miskut. Agjëruesi i përjeton dy gëzime: kur të hajë iftar gëzohet dhe kur ta takojë Zotin e vet gëzohet për agjërimin e vet (për shpërblimin). (Buhariu dhe Muslimi).

Në një transmetim tjetër qëndron:

“Pejgamberi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: Çdo vepër e birit të Ademit i takon atij. Një e mirë shpërblehet sa dhjetë sosh dhe deri në shtatëqind herë shumëfishohet shpërblimi, e Zoti ka thënë: “Përpos agjërimit. Ai është për Mua dhe Unë shpërblej për të, për shkak se njeriu e braktisë ushqimin për Mua, e braktisë pijen për Mua, i braktisë të këndshmet për Mua, e braktisë gruan e tij për Mua. Era e keqe e gojës së agjëruarit është më e mirë tek All-llahu se aroma e miskut. Agjëruesi i ka dy gëzime: njëri gëzim kur të hajë iftar dhe tjetri kur ta takojë Zotin e vet”.

(964)

· “Në xhennet ekziston një derë që quhet rejjan nga e cila hyjnë agjëruarit në Ditën e kijametit dhe askush tjetër nuk hyn nga ajo derë . E kur të hyjnë ata, ajo mbyllet e askush tjetër nuk hyn.”

(965)

· I Dërguari i All-llahut e kishte dërguar Ebu Musain me një grup në një betejë nëpër det. Në një natë të errët, duke qenë ata në anije, i ngritën velat, kur papritmas një zë u dëgjua nga lart: “O udhëtarë të anijes, ndaluni t’ju lajmëroj lidhur me një caktim që All-llahu ia ka caktuar vetvetes!”

Ebu Musa tha: “Na trego nëse e din!”

Zëri tha: “Vërtetë Zoti i Madhëruar ia ka caktuar vetvetes ta ngopë me ujë Ditën e etjes atë që është etur në një ditë të nxehtë.”

(970)

· “Kush thotë: Nuk meriton të adhurohet askush përveç All-llahut (La ilahe il-lallah) dhe jeta e tij mbaron me këtë, hyn në xhennet. Kush agjëron një ditë duke pasur për qëllim fytyrën e All-llahut dhe jeta e tij mbaron me këtë, hyn në xhennet. Kush jep një sadaka (lëmoshë) duke pasur për qëllim fytyrën e All-llahut dhe jeta e tij mbaron me këtë, hyn në xhennet.”

(972)

· Tregon Ebu Umame: “Shkova te i Dërguari i All-llahut, paqja e All-llahut qoftë mbi të, dhe i thashë: “Më urdhëro me një vepër që të kem dobi tek All-llahu me të!”

(Ai) më tha: “Të urdhëroj të agjërosh, ngase nuk ka diç të njejtë me të!”

(973 Transmetimi i dytë)
· “Çdo rob (njeri a xhinn) që agjëron një ditë në rrugë të All-llahut, All-llahu e largon fytyrën e tij nga zjarri (i xhehennemit) në një distancë sa ec njeriu shtatëdhjetë vjet.”

(974)

· “Kush e agjëron Ramazanin me besim në All-llahun dhe me shpresë në shpërblimin e Tij, i falen mëkatet e kaluara dhe kush falet në natën e Kadrit me besim në All-llahun dhe me shpresë në shpërbëlimin e Tij, i falen mëkatet e kaluara.”

(978 Transmetimi i dytë)

· “Pesë namazet, namazi i xhumasë deri në namazin tjetër të xhumasë dhe agjërimi i Ramazanit deri në agjërimin e Ramazanit tjetër, i fshijnë mëkatet që janë ndërmjet tyre, nëse njeriu largohet nga mëkatet e mëdha.”

(980)

· Në një rast i Dërguari i All-llahut iu tha shokëve të tij:

Ejani te minberi! Thotë Ka'b ibën Uxhra:

“Dhe iu afruam, e kur hipi një shkallë tha:

“Amin!” , dhe u ngrit edhe një shkallë e tha:

“Amin!”, e kur u ngrit në shkallën e tretë tha përsëri:

“Amin!” Pasiqë zbriti, i thamë:

“O i dërguar i All-llahut, sot dëgjuam nga ti diçka që s'kemi dëgjuar më parë?”

Ai tha:

“Mu paraqit Xhibrili dhe tha:

“U largoftë (nga mëshira e All-llahut-shprehje mallkimi) ai që e zë Ramazani dhe nuk i falen mëkatet!”, e unë thashë: “Amin!” Kur u ngrita në të dytën, ai tha: “U largoftë ai që kur përmendesh ti në prezencë të tij, nuk të përshëndetë (me selam e salavatë)!”, (e unë) thashë: Amin! E kur hipa në të tretën, ai tha:

“U largoftë ai që prindërit e tij, apo njërin prej tyre e ze pleqëria tek ai, e pleqëria e

prindërve të tij nuk e futë në xhennet!”, (e unë) thashë: “Amin!”

(981)

· “Kur të vie Ramazani hapen dyert e mëshirës, mbyllen dyert e xhehennemit dhe lidhen shejtanët.”

(984 Transmetimi i dytë)

· “Ju erdhi muaji ramazan, muaji i bekuar. Zoti ua ka obliguar agjërimin në të. Gjatë tij hapen dyert e qiellit dhe mbyllen dyert e xhehennemit.”

(985)

· “Syfyri është përplot bereqet. Pra mos e leni, po edhe në qoftë një gëllënjë ujë, sepse All-llahu i Lartë i mëshiron ata që hajné syfyri dhe engjujt e Tij luten për ta.”

(1058)

· “Sa i mirë është syfyri i besimtarit me hurmë.”

(1059)

· Pejgamberit, paqja e All-llahut qoftë mbi të, i pëlqente të bëjë iftar me tri hurma, apo me ushqim që nuk është përgatitur në zjarr.”

(1063)

· “Kush i jep iftar një agjëruesi atij i takon shpërblim sikur i agjëruesit, pa iu mangësuar agjëruesit shpërblimi.”

(1065)

· “Kush nuk e le fjalën e rrejshme dhe punën me të (shpifjen), All-llahu nuk ka nevojë që i tilli ta lë ushqimin dhe pijen e tij.”

Në transmetimin tjetër, hadithi fillon me fjalët: “Kush nuk e le fjalën e rrejshme dhe ashpërsinë në shprehje dhe sjellje...”

(1066)

· “Nuk është agjërimi (vetëm) prej të ngrënurit dhe të pimurit, por agjërimi është zmbropsje nga e kota (fjalë dhe punë) dhe e ndyera. E nëse dikush të ngacmon apo sillet ashpër me ty, thuaj: Unë po agjëroj, unë po agjëroj!”

(1068)

· “Shumë agjërues nuk kanë dobi nga agjërimi i tyre pos urisë dhe shumë namaz-xhinj nuk kanë dobi nga namazi i tyre pos yerë (gdirje e natës) të kotë.”

(1069)


· I dërguari i All-llahut e ka obliguar sadekatul-fitrin që ta pastrojë agjëruesin nga të kotat dhe të ndyerat (fjalë e vepra) si dhe të

ushqehen të varfërit. Kush e jep atë para namazit (të sabahut), i llogaritet pastrim (zekat) i pranuar, e kush e jep pas namazit, i llogaritet si një sadaka e zakonshme.

(1071)

Vërejtje: Numrat në kllapa, poshtë secilit hadith në anën e majtë, i referohen numrave të haditheve në referencën përkatëse.

Muhammed Nasirud-din Albani,
Marrë nga: Sahihut-targibi vet-tarhibi
Përktheu: Gëzim Selaci
19.10.2001



3. Përvetësimi i moralit nga Kur'ani

Sa'd ibën Hisham ibën Amiri i tha Aishes, radijall-llahu anha: "Oj nëna e besimtarëve! Më trego për moralin e Pejgamberit a.s.! Ajo tha: a nuk e lexon Kur'anin?! Thash: si jo, e ajo shtoi: morali i të Dërguarit të All-llahut ishte Kur'ani., (Transmeton Muslimi)

All-llahu, subhanehu ve teala thotë: "Juve ju erdhi nga All-llahu dritë dhe libër i qartë., (Maide - 15)

Neveviu, rahimehull-llah, rreth kuptimit të hadithit thotë: "veprimi sipas tij (Kur'anit), të ndaluarit në kufijtë e tij, përvetësimi i vlerave edukative të tij, marrja mësim nga rrastet dhe tregimet e tij, meditimi rreth thellësisë së kuptimeve të tij dhe drejtëleximi i tij., (Sherh Sahihul Muslim)

Përmendëm në temën paraprake "Burimi i moralit të lartë., se megjithëatë se njohja e të mirës dhe të keqes bëhet nëpërmjet natyrës së pastër të njeriut prapsepër kjo dritë është e mangët dhe devijohet nga zakonet shoqërore, për këtë shkak All-llahu me urtësinë e Tij e plotësoi këtë dritë me dritë hyjnore "Dritë përmbi dritë" (Nur - 35), poashtu All-llahu, subhanehu ve teala, tha: "Juve ju erdhi nga All-llahu dritë dhe libër i qartë., (Maide - 15)

Filozofët tentuan që ta plotësojnë këtë mangësi të (fitres) natyrës të pastër të njeriut duke themeluar rregulla dhe parime mbi moralin, mirëpo doli në shesh jokonsekuenca e tyre ngaqë është absurde përkufizimi i etikës së njeriut në bazë të një parimi apo rregulli, për këtë shkak në Islam gjejmë të bukurën në urdhërat e Kur'anit dhe udhëzimin e Pejgamberit a.s., All-llahu, subhanehu ve teala, thotë: "Juve ju erdhi nga All-llahu dritë dhe libër i qartë., (Maide - 15)

Në Islam ka rregulla të veçanta që kanë të bëjnë drejtpërdrejtë me disa zakone apo marrdhënie të ndryshme:

1- Maturia në ushqim dhe në shpenzim, larg të qenurit shpërdorues apo dorështrënguar, All-llahu [subhanehu ve teala] thotë: "Edhe ata të cilët, kur shpenzojnë nuk janë as shpërdorues, as dorështrënguar, por mbajnë një të mesme të drejtë mes dy anëve." (Furkan - 67)

2- Garimi në punë të mira, All-llahu [subhanehu ve teala] thotë: "Secili (popull) ka një anë, drejt të cilit ai kthehet (në falje). Kësisoj vraponi pra, drejt gjithçkaje që është mirësi. Kudo që të jeni, All-llahu do t'ju grumbullojë të gjithëve." (Bekare - 148)

3- Ndhimja e ndërsjelltë për mirësi dhe pengimi nga e keqja, All-llahu [subhanehu ve teala] thotë: "Ndhimni njëri tjetrin në mirësi e devotshmëri dhe mos ndihmoni njëri tjetrin në gjynah e armiqësi. Dhe kini frikë All-llahun se padyshim All-llahu është i Ashpër në ndëshkim." (Maide - 2)

4- Sjellja e butë me tjerët. Pejgamberi, sal-All-llahu alejhi ve sel-lem, i tha Aishes r.a.: "çdo gjë që bëhet me butësi është e bukur, e nëse bëhet pa të, ajo vepër shëmtohet." (Transmeton Muslimi)

5- Të duash për vëllain tënd atë që e don për veten prej gjërave të mira: Pejgamberi, sal-All-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Asnjëri nuk e ka plotësuar besimin (imanin) përderisa të dëshiron për vëllain e tij atë që e dëshiron për vete." (Transmeton Buhariu)

6- Mosvënia nishan ndonjë gjë të gjallë, për ta qëlluar, sikur vihen sende të ndryshme. Pejgamberi, sal-All-llahu alejhi ve sel-lem, thotë: "Mos vini nishan për ta qëlluar ndonjë gjë që ka shpirt." (Transmeton Muslimi)

Ahmed Muadh Hakkij